

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI

Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA

Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7381 E martë 12 Dhjetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje

në "Reporter.al"

Nga SEBIALLA

Një punonjës i Gardës, i vendosur pranë derës prej hekuri të ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve - sot institucioni i Komisionit të Pavarur të ...
Vijon në faqen 18

Konfuzioni me vetingun cenon besimin e publikut



Opinion

Ditës

Nga SALI BERISHA

Si sot 27 vite më parë, studentët e universiteteve të Tiranës, të udhëhequr nga tribuni i lirisë së shqiptarëve, Azem Hajdari së bashku me intelektualë ...
Vijon në faqen 19

PD gaboi me piramidat, mision përmbyjsja e diktaturës hoxhiste



Sot mbyllet afati për aplikantët, debatet

Dy kandidatë për kryeprokuror të përkohshëm. Rama: PD, merrni përgjegjësinë

Meta: Jo njëanshmëri, dialog për kryeprokurorin. S'ngutem për dekretimin e kreut të SHISH

Nga VALENTINA MADANI & DARINA TANUSHI

Kryeministri Edi Rama i bëri sërish dje thirrje opozitës të zgjedhin bashkë kryeprokurorin e përkohshëm. Gjatë fjalës që mbajti në mbledhjen e grupit parlamentar të PS-së, kryeministri Rama u shpreh se ...
Ne faqet 4-5

MINISTRIA E FINANCAVE FIRMOS VENDIMIN KUSH PERFITON, GATI LISTA EMERORE

SHPERBLIMET, JA SA MARRIN 2900 POLICE E USHTARAKE

Përmbytja në Fushë-Krujë, rreshteri Blendi Zaimi: Ja si u shpëtova jetën 11 personave. Qëndrova afro 1 orë në ujë duke nxjerrë banorët



EKSKLUZIVE



(Në foto) Ushtarake gjatë një parade. Rreshteri Blendi Zaimi gjatë një operacioni shpëtimi
Ne faqet 2-3

DETAJET E CEREMONISË

PD feston 27-vjetorin, të ftuarit dhe kush mungoi në festë. Basha, thirrje për bashkim
Ne faqen 7

SKEMA E RE

Subvencionet për bujqësinë, si të fitoni nga fondi 20 milionë euro
Ne faqen 9

DEBATI PER LIBRAT

MAS: Tekste falas për nxënësit e fillores, Vokshi: Fusni edhe 9-vjeçaren
Ne faqen 15

BASKETBOLL

Ndërprenë derbin e kryeqytetit, policia gjobit 14 tifoze bardheblu
Ne faqen 20

VRASJA NE LEZHE



Varrimi i Ndokës, I biri u shoqërua nga 22 policë. Ja pistat e hetimit
Ne faqen 12

Ish-themeluesi: Kryeministri më i ashpri, çfarë tha në shesh në vitin '91

"Mitingu i intelektualëve, Berisha refuzoi fjalën e Ramës"

Mevlan Shanaj: Biseda me policët që të mos godisnin mbi studentët

Nga VALENTINA MADANI

Mevlan Shanaj u përfshi familjarisht në lëvizjen demokratike për rrëzimin e diktaturës në dhjetor të '90-ës, bashkë me bashkëshorten dhe dy fëmijët. I rrethuar nga rreziku për jetën nga të gjitha anët, regjisori i njohur nuk



INTERVISTA

hezitoi, por bashkë me djalin e vogël iu drejtua Qytetit Studenti, aty ku kishte nisur rebelimi i studentëve më 8 dhjetor të 90-ës. Mes tyre gjendej edhe vajza e tij studente. Përplasja me policinë dhe shkopinjët e gomës mbi trupat e të rinjve bindi ...
Ne faqen 6

PERMBYTJET SHPERBLIMET

Intervista/ Blendi Zaimi: 13 vite në FA, momentet e veçanta e të vështira

Përmbytja në Fushë-Krujë, rreshteri: Ja si u shpëtova jetën 11 personave

"Qëndrova afro 1 orë në ujë duke nxjerrë banorët"

Ina Allkanjari

Rreshter Blendi Zaimi do të mbahet mend për një kohë të gjatë nga dy familje në Fushë-Krujë. Efektivit të Forcave Ajrore i është dashur të qëndrojë në ujë për afro një orë për t'u shpëtuar jetën 11 pjesëtarëve të këtyre dy familjeve, banesat e të cilëve rrezikonin të përmbyeshin plotësisht nga vërshimi i ujërave. Mund të thuhet me plot gojë se 40-vjeçari është hero, pasi ka rrezikuar edhe jetën e tij në këto misione. "Ky është profesioni që unë kam zgjedhur, por është e rëndësishme që gjatë këtyre operacioneve të kemi mjete shtesë për të rritur sigurinë. Më herët jam trajnuar në Angli dhe çdo aerospëtuës kishte mbrojtje për trupin, sidomos për pjesën e shtyllës kurrizore, në mënyrë që të ishe i sigurt në një moment që mund të hasje vështirësi gjatë një misioni dhe të rrezohesh. Pra, siguria është maksimale për ata që e vlerësojnë jetën e njeriut. Në nuk i kemi të gjitha mjetet e duhura, realisht. I kam bërë kërkesën komandës sime dhe institucioneve që janë në lart se komanda", tha në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", rreshter Blendi Zaimi, me detyrë aerospëtuës për shërbimin SAR. Rreshteri na tregoi për misionin e fundit të ndërmarrë këtë fundvjetorë dhe fillimdhjetorin, për shpëtimin e qytetarëve nga përmbytjet. Për faktin se sa e rrezikuar është jeta e tij gjatë këtyre operacioneve, ai u shpreh se Zoti krijoi zogjtë për të fluturuar, jo njerëzit, por në situata të tilla rreziku nuk shihet aspak përballë ndjesisë që ofron shpëtimi i jetës së një njeriu.

Zoti Zaimi, cili është pozicioni juaj pranë Bazës Ajrore Farkë?

Jam në detyrë operator bordi aerospëtuës për shërbimin SAR (kërkim-shpëtim), pjesë e strukturës së Ministrisë Mbrojtjes. Momentalisht në Bazën Ajrore Farkë kam dy detyra kryesore, që është kërkim-shpëtimi dhe emergjencat-civile. Shërbej prej 13 vitesh në këtë bazë. Jam veshur në vitin 2004. Kam bërë specializime të shumta, në vitin 2006-2007 kam qenë në Itali për specialist helikopterësh, gjithashtu kam qenë pjesë e disa kurseve mbijetese me forca speciale italiane, mbijetesa në det, në mal etj. Kam marrë pjesë në kursin e shtabit të

luftës me Gardën e Nju Xherisi. Më pas në vitin 2014-2015 isha pjesë e një kursi 5muor në Royal Air Force, RAF (Forcat Ajrore Mbretërore Angleze). Ishte një kurs që ia vlejti, me vështirësi si nga ana teorike, edhe nga ana praktike.

Gjatë një misioni shpëtim, si reagoni ndaj personave që janë në rrezik për jetën?

Në këtë profesion në çdo moment je në rrezik për jetën tënde dhe të personit që do shpëtohet. Shikohet në radhë të parë siguria jonë, sepse në qoftë se aerospëtuës dëmtohet, nuk shpëton dot personin që është në rrezik. Gjatë operacionit të shpëtimin në fillim janë të moshuarit, gratë dhe fëmijët, pastaj më të fuqishmit. Përpara se t'i evakuosh, është e këshillueshme që personave t'i flasësh, pasi mund të jenë të rëndur psikologjikisht dhe në trajnim në Angli, na e kanë theksuar gjithmonë që është shumë e rëndësishme dhe mënyra si e kap një person për ta shpëtuar, duhet të tregohemi sa më xhentilë, që të ndihet i sigurt. Kryesore është t'i mbash të qetë, pasi në momentin e shpëtimin, nuk jemi të informuar për fobitë dhe frikërat që mund të ketë që individ.

Çfarë vështirësihasni në profesionin që keni zgjedhur?

Faktori kohë është pika kyçe si për mjetin fluturues, për pilotët, për operatorin e vënit dhe të SAR-it. Moti i pastër, pa shi, pa mjegull dhe pa erë është në favorin tonë. Zakonisht zonat që kanë flukse ajri shumë të mëdha, janë shumë të rrezikshme për profesionin tonë. Për pilotët është shumë e problem drejtimi i erës, sepse mjete fluturues gjithmonë erën duhet ta këtë përballë dhe piloti i përdorë pjesëtarët e tjerë të ekuipazhit si faktorë ndihmës, ose si sensor për natyrën përjashta. Në vend të ku do operosh nuk duhet harruar që ka edhe mjete fluturuese. Pra, në shërbejmë si faktorë ndihmës në punën e pilotit, pa kryer akoma punën tonë. I



Rreshter Blendi Zaimi

japim drejtimin e erës duke u bazuar te pemët, te liqenet. Në këtë mënyrë, piloti bën pozicionimin e helikopterit në drejtimin e duhur. Gjithmonë duke pasur parasysh edhe krahun nga ka vënin për të zbritur operatori i SAR-it. Bën verifikimin e vendit në momentin kur është në një mision shpëtim, shikon zonën e uljes në rast emergjence. Më pas vazhdon operacionin. Duhet theksuar që profesioni që kam zgjedhur është më risqje, pasi Zoti krijoi zogjtë për të fluturuar, jo njerëzit.

Gjatë përmbytjeve të ndodhura afro dy javë më parë, ku ju caktuan me shërbim?

Ishte ditë e premte, kam qenë pushim shërbimi, por duke qenë se moti ishte i keq, u nisa për në repart, pasi kisha një parandjenjë që gjendja do përkeqësohej. Jepet detyra rreth orës 11:30, më thërret komandanti i grupit "Cougar", më tha të kontrolloja pajimet, kontroll të cilin e bëj përditë për t'i verifikuar. Gjithashtu, u bë kontrolli i helikopterit në rrymë dhe hipë në bord. Që në momentin që u nisëm kishte shumë shi dhe mjegull, kur arritëm në Fushë-Krujë, një zonë e rrezikuar nga përmbytjet, era ishte shumë e fortë. Pilotët verifikuan banesat të cilat ishin të izoluar nga reshjet e shiut.

Gjatë operacionit në Fushë-Krujë sa persona shpëtuan?

Në operacionin e shpëtimin në Fushë-Krujë u nxorën nga banesat e përmbytura 11 persona, 8 pjesëtarë të shtëpia e parë dhe 3 tek e dyta (dy çuna të rinj dhe një burrë). Vihej re që të gjithë ishin zbatuar, "na i ka marrë uji këpucët dhe ato që kanë ngelur janë të lagura", thanë banorët. Pas evakuimit të 8 personave në banesën e parë, u drejtuan për të shtëpia e dytë, në të

PROFESIONI

Kur u hap kursi i "kërkim shpëtimin" në 2012, i kërkova komandantit të më vendoste emrin në listën për operator SAR-i. Përzgjedhja ishte me testim. Më pas erdhi në përfaqësues nga pala angleze dhe bëri përzgjedhjen. Pasi mbarova kursin, erdha në Bazën Ajrore në Shqipëri me rezultate shumë të mira dhe kalova operator bordi aerospëtuës.

m'u desh të qëndroja për afro 1 orë në ujë, duke hipur çdo banor në helikopter. Më pas në kthim u ulëm afër Fushë-Krujës, për shkak të gjendjes së keqe të motit, fluksi ishte shumë i madh dhe për të qenë më të sigurt vendosëm të spostoheshim në aeroportin e Rinasit. Pritëm sa u largua mjegulla dhe u kthëm për në bazën tonë ajrore.

Ku i dërgonin banorët, të cilët i evakuonit nga banesat e përmbytura?

Banorët pasi i merrnim

PËRMBYTJET

Një nga zonat që hasëm rezistencë gjatë përmbytjeve të këtij viti ishte në Levan. Shkuam në çdo banesë, por banorët nuk pranin të evakuoheshin. Arsyja nuk dihet. Ndaj u detyruam të largoheshim.

cilën në një moment rrezikova. Kati i dytë i banesës ishte i rrethuar me hekura dhe duke u përpjekur të shmangem, dëmtova gjurin dhe u rrezova sipër terracës. Pasi bëmë evakuimin e 3 persona që gjendeshin në këtë banesë, verifikuam zonën në qoftë se kishte të tjerë që kishin nevojë për ndihmë dhe më pas u nisëm drejt bazës tonë ajrore. Gjatë evakuimit të 11 personave,

në helikopter, i spostonim në një fushë rreth 500-600 metra larg zonës së rrezikuar. Aty ndodheshin mjetet e FNSH të ushtrisë dhe të policisë.

Gjatë emergjencave të fundit, ka pasur raste që banorët nuk pranin të evakuoheshin?

Po, rezistencë hasëm në Levan. Shkuam në çdo banesë, por banorët nuk pranin të evakuoheshin.



Forcat e Armatosura

Arsyeja nuk dihet. Ndaj u detyruam të largoheshim.

Cilat janë zonat më me risk që keni operuar këtë vit?

Kushtet klimatike janë më të vështira në zonën e veriut, duke qenë më në lartësi ka më shumë erë, çka sjellë rritjen e rrezikshme. Terreni dhe fushë-pamja është më e kufizuar prej mjegullës.

Sa të sigurt jeni gjatë një misioni, a i dispononi mjetet e duhura?

Ky është profesioni që unë kam zgjedhur, por është e rëndësishme që gjatë këtyre operacioneve të kemi mjete shtesë për të rritur sigurinë. Më herët jam trajnuar në Angli dhe çdo aerospëtuës kishte mbrojtje për trupin, sidomos për pjesën e shtyllës kurrizore, në mënyrë që të ishe i sigurt në një moment që mund të hasje vështirësi gjatë një misioni dhe të rrezohesh. Pra, siguria është maksimale për ata që e vlerësojnë jetën e njeriut. Në nuk i kemi të gjitha mjetet e duhura, realisht. I kam bërë kërkesën komandës sime dhe institucioneve që janë më lart se komanda.

Mund të na tregoni një operacion që keni rrezikuar edhe jetën tuaj?

Situata që kam rrezikuar më shumë jetën ka qenë shpëtimi i njerëzve në Burrel. Në nëntor të vitit 2016 shpëtuan një familje, një nënë e cila ishte shtatzënë dhe një fëmijë 5 muajsh. Kam zbritur në terracën e banesës së tyre, e cila ishte përmbytur. Kemi qenë me helikopterin "Cougar" dhe sa jam shkëputur nga kavo, duke qenë se çatia ishte me myshk, rrëshqita, por fatmirësisht nuk rashë brenda në banesë, pasi do ishte shumë e rrezikshme, sepse kati i parë ishte mbushur me ujë dhe



Ministria e Financave firmos vendimin për 2917 punonjës të FA-ve dhe 330 të Policisë së Shtetit

Përmbytjet, 10-50 mijë lekë të reja shpërblim për ushtarakët e policët

Ministria e Mbrojtjes dhe ajo e Brendshme, gati listat e emrave

Darina Tanushi

2917 punonjës të Forcave të Armatosura si dhe 330 punonjës të Policisë së Shtetit, reparti special RENEa dhe të repartëve të FNSH-së do të marrin shpërblim për angazhimin në situatën emergjente të krijuar në disa zona të vendit nga përmbytjet. Ministria e Financave ka bërë gati vendimin për të akorduar fondin prej 63 290 000 lekë për këto kategori punonjësish. Lajmi u konfirmua pak ditë më parë gjatë ceremonive festive me rastin e 105-vjetorit të krijimit të ushtrisë shqiptare nga vetë kryeministri Rama. Ndërsa pritet që vendimi të botohet në Fletoren Zyrtare dhe të jepet për punonjësit. Masa e shpërblimit llogaritet të jetë nga 20 mijë lekë të reja deri në 50 mijë lekë. Kështu, sipas ndarjes së bërë në këtë vendim, 298 punonjësve nga Forcat e Armatosura do t'u ndahet shuma 14 900 000 lekë, që do të thotë se për çdo punonjës do të ketë nga 50 mijë lekë të reja shpërblim. Rreth 1560 punonjës nga Forcat e Armatosura do të ndajnë shumën 31 200 000 lekë, përcaktuar nga Ministria e Financave dhe ajo e Mbrojtjes, që do të thotë se do të marrin nga 20 mijë lekë të reja secili. Ndërsa pjesa prej 1059 punonjës nga Forcat e Armatosura ndajnë shumën 10 590 000 lekë e secili do të marrë nga 10 mijë lekë shpërblim. Ndërkohë, po sipas këtij vendimi, shpërblimi i punonjësve të angazhuar në strukturat e Policisë së Shtetit të bëhet do të jetë për rreth 330 veta, në masën 20 000 lekë/punonjës. Për repartin special RENEa dhe repartet e FNSH-ve Tiranë, Fier dhe Shkodër do të shpërblehen 70 punonjës, 60 punonjës të Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit Fier, po ashtu do të marrin këtë masë shpërblimi. Po 20 mijë lekë të reja do të marrin edhe 30 punonjës të Policisë Durrës, 30 punonjës të Policisë Tiranë, 70 punonjës të Policisë Vlorë, si dhe 70 punonjës të Drejtorisë Vendore të Kufirit, Migracionit Vlorë dhe repartit "Delta Force". Listat përkatëse me emrat e punonjësve të strukturave të Forcave të Armatosura e të Policisë së Shtetit dhe të miratohet përkatësisht nga ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Brendshme.



Përmbytjet e fundit në vend

PREMTIMI
"Dua të angazhohem sot që viti 2018 do jetë viti i fundit për të cilin buxheti i shtetit do të ketë rrogat ekzistuese për ju. Ne jemi shumë të vendosur të rrisim buxhetin e ushtrisë dhe në kuadrin e angazhimeve si anëtarë të NATO-s, gjë që e kemi bërë në buxhetin e viti 2018. Por, rritja do të vazhdojë dhe e para rritje prioritare për vitin 2019 do të jetë rritja e konsiderueshme për të gjitha pagat e ushtarakëve", tha Rama pak ditë më parë.

kishte bagëti të ngordhura. Eca në çatinë e katit të dytë me shumë kujdes për t'iu afruar banorëve që ndodheshin në banesë. Afrohem te dritarja dhe vë re se në shtëpi ndodhej një grua e moshuar bashkë me bashkëshortin, djali i tyre, nusja dhe një foshnjë Adora, 5 muajshe. Fola me zotërinë në fillim, sepse nuk dëshironin të vinin, arrita t'i mbush mendjen të paktën të merrja nënën, nusen dhe foshnjën. Nëna ishte e moshuar dhe nuk pranonte. Mesa vura re arsyeja e rezistencës ishte sepse nuk dëshironin të braktisnin shtëpinë, por në këtë rast duhet theksuar se largimi nga banesa ishte në favorin e tyre, pasi u rrezikojë jeta.

konit drejt këtij profesioni?

Unë kam marrë pjesë në disa emergjenca, kam marrë pjesë edhe në përmbytjet e Shkodrës në vitin 2010-2011, por jo në pozicionin e aerospëtuesit. Ishte një pasion i hershëm. Kur u hap kursi i "kërkim shpëtim" në 2012, i kërkova komandantit të më vendoste emrin në listën për operator SAR-i. Përzgjedhja ishte me testim. Më pas erdhi në përfaqësues nga pala angleze dhe bëri përzgjedhjen. Pasi mbarova kursin, erdha në bazën ajrore në Shqipëri me rezultate shumë të mira dhe kalova operator bordi aerospëtues.

Në momentin që bëheni pjesë e këtyre misioneve, si ndihen familjarët tuaj, çfarë mendojnë për punën që keni zgjedhur?

Këtë profesion e kam zgjedhur vetë, pasi që të bësh këtë punë, duhet të kesh kurajë dhe guxim, pasi është tej mase e vështirë. Është e rëndësishme që familjarët t'i parapërgatisim psikologjikisht. Nuk ke kohë që këto bisada t'i kryesh me familjarët ditën që të caktohet misioni, pasi shpeshherë janë misione papërcaktuara më përpara, për këtë arsye është e rëndësishme që vazhdimisht t'ua shpjegosh të afërmeve që mund të jesh pjesë e misioneve të ndryshme. Në qoftë se je i shqetësuar në familje, detyrimisht do ndikojë edhe në punën tënde, ndaj është e rëndësishme mbështetja e tyre në misionet të tilla.

Merrni shpërblime për operacionet ajrore?

Deri tani na kanë shpërblyer për misionet në të cilat shpëtohen njerëz. Shpërblimi është një stimul dhe për misionin e Burrellit na kanë dhënë gjysmë page. Për këtë mision është thënë që kush ka qenë pjesë e emergjencave, ka vendosur qeveria një shpërblim të veçantë.

Çfarë ndodhi më tej?

Mora nusen, e ngjita në helikopter dhe në ato momente lajmërova kolegët që në banesë është edhe një fëmijë i vogël. Në momentin që po ngjisa nënën e fëmijes në bord, u përplasa me një depozi, në ato momente ishte nëna me kuriz dhe për ta evituar, u përplasa unë. Fati im i mirë ishte që në qoftë se nuk do ishte depozi, do ishim përplasur me shtyllën e korrentit, gjë e cila do ishte fatale. Më pas gjatë shpëtimit të fëmijes, për të shtuar sigurinë e evakuimit mora edhe kolegun tim, i cili ndodhej në helikopter. Pasi evakuam foshnjën, e ngjitem në bord, doli me shumë sukses, as vetë s'e besojta, e putha foshnjën dhe u ndjeva shumë i lumtur. Në këtë mision kam qenë i vetmi operator bordi aerospëtues.

Ndonjë mision që keni dështuar?

Jo, asnjë. Çdo mision ka dalë me sukses dhe uroj që të vazhdojmë të japim rezultate të tilla. Stërviçja e vazhdueshme të çon në siguri të plotë dhe në përfundim të çdo misioni me sukses.

Çfarë ju shtyu të sh-

VENDIMI I QEVERISË PËR SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE TË FA-VE DHE POLICISË

Në buxhetin e miratuar për vitin 2017 të bëhet një shtesë fondi prej 63 290 000 lekësh për shpërblimin e punonjësve të disa strukturave në Forcat e Armatosura dhe Policinë e Shtetit, të angazhuar gjatë situatës emergjente të krijuar në disa zona të vendit si rezultat i përmblyetjeve natyrore, si më poshtë vijon:

- a) Ministrisë së Mbrojtjes, në programin buxhetor "Forca e luftimit", t'i shtohet fondi prej 56690 000 lekësh për shpërblimin e disa punonjësve të strukturave në Forcat e Armatosura.
- b) Ministrisë së Brendshme, në programin buxhetor "Policia e Shtetit", t'i shtohet fondi prej 600 000 për shpërblimin e disa punonjësve të Policisë së Shtetit.

2. Personeli i angazhuar në Ministrinë e Mbrojtjes të shpërblehet, si më poshtë vijon:

- 298 punonjës nga Forcat e Armatosura, në shumën 14 900 000 lekë.
- 1560 punonjës nga Forcat e Armatosura, në shumën 31 200 000 lekë.
- 1059 punonjës nga Forcat e Armatosura, në shumën 10 590 000 lekë.

3. Shpërblimi i punonjësve të angazhuar në strukturat e Policisë së Shtetit të bëhet në masën 20 000 lekë/punonjës, për 330 punonjës dhe konkretisht:

- Për repartin special RENEa dhe repartet e FNSH-ve Tiranë, Fier dhe Shkodër, 70 punonjës.
- Për Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, 60 punonjës.
- Për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, 30 punonjës.
- Për Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, 30 punonjës.
- Për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, 70 punonjës.
- Për Drejtorinë Vendore të Kufirit, Migracionit Vlorë dhe repartin "Delta Force", 70 punonjës.

Listat përkatëse me emrat e punonjësve të strukturave të Forcave të Armatosura e të Policisë së Shtetit dhe masa e shpërblimit të miratohen përkatësisht nga ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Brendshme.

LLOGARIA E MASËSË SHPËRBLIMIT PËR PUNONJËS

- 298 punonjës të FA marrin nga 50 mijë lekë të reja.
- 1560 punonjës të FA marrin nga 20 mijë lekë të reja.
- 1059 punonjës të FA marrin nga 10 mijë lekë të reja.
- 330 punonjës të Policisë së Shtetit dhe RENEa e FNSH në Tiranë, Fier e Shkodër marrin nga 20 mijë lekë të reja.

tohen përkatësisht nga ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Brendshme. Shtesa e fondit prej 63 290 000 lekësh të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe ngarkohen me vendim ministri i Mbrojtjes, ministri i Brendshme dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi. Pak ditë më parë, kryeministri Edi Rama lajmëroi edhe rritje të konsiderueshme pa-

gash për ushtarakët në vitin 2019. Gjatë fjalës së mbajtur në aktivitetin "Faleminderit Forca të Armatosura", organizuar në garnizonin "Skënderbej", në Ministrinë e Mbrojtjes, kryeministri u drejtua ushtarakëve me fjalët: "Krahasuar me kolegët e tjerë, pagat tuaja janë të ulëta dhe pavarësisht nivelit të lartë profesional dhe dijës patriotike që ju mishëroni, ne nuk kemi ar-

ritur dot t'ju shpërblejmë ashtu siç e meritoni. Dhe ne nuk kemi arritur të mbylhim hendekun mes jush dhe Policisë së Shtetit, i cili kurë nuk mund të arrijë ata që u shpreh se, "qeveria do të vendosë në radhë të parë një shpërblim si shprehje mirënjohjeje për të gjithë ata që u përfshinë në operacionin fantastik, që shteti përballoi si shprehje e rëndësishme".

KRYEPROKURORI ZGJEDHJA

Presidenti nuk dekreton ligjin për tarifën gjyqësore, zbardhen arsyet

Meta: Jo njëanshmëri, dialog për kryeprokurorin e përkohshëm

"Nuk ngutem për dekretimin e kreut të SHISH"

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta kërkon që emri i ri i kryeprokurorit të përkohshëm të kalojë përmes dialogut mes mazhorancës dhe opozitës. Në të parin prononcim për këtë çështje, kreu i shtetit deklaroi dje se zgjedhja duhet të bëhet në respekt të Kushtetues dhe se çdo hap i njëanshëm do të ketë ndikim në pavarësinë e Prokurorisë, si institucion i drejtësisë. "Kjo është një përgjegjësi ekskluzive e Kuvendit të Shqipërisë. Si president, dua të nënvizoj se përdërisa kemi të bëjmë me një çështje të rëndësishme të një institucioni kyç të drejtësisë, duhet respektuar Kushtetuta dhe fryma e saj. Është e rëndësishme që të ketë mes aktorëve kryesorë dialog të shpejtë, të përgjeshëm dhe të bazuar mbi standardet transparente për zgjidhjen e kësaj çështjeje, pasi çdo hap i njëanshëm nuk do e ndihmonte pavarësisë së institucioneve dhe rritjes së besimit të institucioneve të drejtësisë", deklaroi z.Meta. Në konferencën e përbashkët për shtyp me Presidentin e Malit të Zi, Filip Vujanović, kreu i shtetit u pyet edhe për vonesën në mosdekretimin e propozimit të sjellë nga kryeministri për emrin e Helidon Bendos, që pason Visho Ajazi Likën në krye të Shërbimit Informativ. "Duhet të kemi në konsideratë që një vendimarrje e tillë është e rëndësishme dhe presidenti duhet të jetë i bindur se një vendimarrje përfundimtare forcon pavarësinë dhe efikasitetin e një institucioni kaq të rëndësishëm", të sigurisë kombëtare", u shpreh kreu i shtetit. Përsa i përket takimit me Vujanović, presidentët shprehën angazhimin për forcimin e marrëdhënieve të mëtejshme mes dy vendeve.

KTHIMI

Presidenti Ilir Meta nuk dekreton ligjin për tarifën gjyqësore dhe ia kthen atë për rishqyrtim Kuvendit. Ndonëse ishte njoftuar kthi-

mi i ligjit në Kuvend, është zbardhur dokumenti i plotë i datës 22 nëntor, ku sqarohen arsyet e këtij veprimi. "Së pari, niveli i tarifave, i parashikuara në këtë ligj është në mungesë të një stu-

dimi të thelluar dhe në krahasim me tarifën e sotme, ka një rritje drastike dhe të menjëhershme të tarifave, gjë e cila paraqet rrezik të lartë për vështirësimin e aksesit në drejtësi për shtre-

sat në nevojë. Së dyti, mekanizmat e parashikuara në këtë ligj për mbrojtjen e shtresave të pamundura të shoqërisë për të përballuar tarifën e reje gjyqësore nuk janë të përshtatshme. Mungojnë dispozitat e qarta, që garantojnë mbrojtjen e nevojshme. Dispozitat e miratuara në këtë drejtim nuk garantojnë sigurinë ligjore", - theksohet ndër të tjera në sqarimin e presidentit. Një tjetër arsye pse e ktheu për rishqyrtim ishte se "parashikimet e këtij ligji nuk ndihmojnë në mënyrën e duhur për zgjidhjen e problematikes së financimit të pamjaftueshëm të sistemit gjyqësor, megjithëse ky ligj parashikon rritjen e tarifave në shërbim".



Presidenti Ilir Meta

Kreu i PD: Shkelja e Kushtetutës shkatërron reformën

Basha: Jo prokuror të përkohshëm, nëse Rama e bën, përballje politike

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, paralajmëroi dje kryeministrin Edi Rama se nëse zgjedh prokurorin e ri në shkelje të Kushtetutës, atëherë do të ketë përballjen e opozitës. "Shkelja e Kushtetutës për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm shkatërron reformën në drejtësi dhe e vë atë nën kontrollin e plotë të Edi Ramës. Zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm pa bërë më parë vettingun është jo vetëm antikushtetuese, por edhe tallje me shqiptarët, hipokrizi me vettingun. Edi Rama të zbatojë Kushtetutën dhe të mos lejojë zgjedhjen e tij prej Saimir Tahirit!", tha z.Basha pas mbledhjes së grupit parlamentar të PD-së. Sipas kreut të PD-së, "përgjigja është shumë e qartë për të mbrojtur paratë e pista të drogës, dosjen e krimin, të Tahirjave, Habbalajve, Vangjush



Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha

Dakos. Një prokuror do të ketë fuqi të transferojë prokurorët dhe të bëjë vlerësimin e tyre. Pra, është e qartë se Edi Rama e sabotoi ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe tani po kërkon një prokuror. Kërkesa e vetme ndaj Edi Ramës është të zbatojë Kushtetutën. Nëse Edi Rama shkel Kushtetutën për të shtënë në dorë postin e Prokurorit të Përgjithshëm, ai do të përballet me opozitën". Në kushte të

tilla, z.Basha paralajmëroi: "Nuk do ketë prokuror të përkohshëm, nëse Rama e bën do përballet politikisht me opozitën". Ai përmendi se: "Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet me 3/5 dhe nuk mund të zgjidhet pa vetting. Pse i vit e gjysmë pas reformës në drejtësi Rama do të emërojë një prokuror vetëm me votat e mazhorancës? Për të mbrojtur paratë e pista të drogës".



Gjatë një seance parlamentare

Takimi Ruçi-Vujanović: Bashkëveprim mes dy vendeve

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi priti dje Presidentin e Malit të Zi, Filip Vujanović, në kuadër të vizitës së tij zyrtare në vendin tonë. Ata shprehën vullnetin e përbashkët pozitiv për të zhvilluar më tej bashkëpunimin në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë, sidomos në spektrin ekonomik dhe për të thelluar më tej angazhimin për të bashkëvepruar në rrafshin rajonal, si dy vende anëtare të NATO-s, por edhe si dy shtete e popuj, që aspirojnë integrimin në Bashkimin Europian.



Alibeaj: Rama do të zgjedhë kryeprokurorin pa vetting

Deputeti i PD, Enkelejd Alibeaj, akuzoi dje në "Studio e Hapur" në "News 24" se mazhoranca kërkon të zgjedhë kryeprokurorin pa vetting, pasi do të mbrojë zyrat e inkriminuar. "Prokurori i Përgjithshëm duhet të jetë produkt i paanësisë politike sipas Kushtetutës. Askush nuk e mendonte se do vinte një ditë ku Prokurori i Përgjithshëm jo vetëm të zgjidhej nga politika, por vetëm nga mazhoranca. Ata duan të zgjedhin kryeprokurorin pa vetting. Kjo nuk është çështje politike dhe pazari. Sfondi politik është i përshkruar nga dosja 'Tahiri', nga dosja e '3 policëve', nga dosja e 'Xibrakës', nga dosja 'Dako' apo dosje të tjera. Motivi duhet analizuar. Çfarë e shtyn Ramën pra të ndërmarrë këtë iniciativë", - u shpreh Enkelejd Alibeaj.



Kryeministri, në grupin e PS: E kemi mundësinë ta zgjedhim me shumicë të thjeshtë

Kryeprokurori, sot mbyllet afati, Rama: Basha të marrë përgjegjësi

"Jemi më afër se kurrë për çeljen e negociatave me BE"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama i bëri sërish dje thirrje opozitës të zgjedhin bashkë kryeprokurorin e përkohshëm. Gjatë fjalës që mbajti në mbledhjen e grupit parlamentar të PS-së, kryeministri Rama u shpreh se, "kjo ka krijuar një situatë moskuptimi nga ana e opozitës, të cilës - tha ai - unë përfitoj nga rasti t'i drejtohem përsëri, me thirrjen që ne ta shfrytëzojmë këtë moment, për të eksploruar çdo mundësi mirëkuptimi dhe për të dalë me një zgjedhje të mirëkuptuar mes palëve të prokurorit të përkohshëm".

"Ne e kemi qartësisht mundësinë dhe të drejtën që ta zgjedhim prokurorin e përkohshëm me shumicën që kemi në dispozicion, por ashtu siç kishim mundësinë dhe të drejtën të hynim në zgjedhje pa i shtrirë dorën në mënyrë të vazhdueshme opozitës dhe nuk e shfrytëzuam atë mundësi dhe atë të drejtë në emër të djakaje më të madhe, që është interesi kombëtar dhe interesi publik, sot, përsëri ne jemi shumica që e shikon këtë çështje jo me syrin e momentit, jo me qëllime të tjera, përpos qëllimit strategjik të vendit tonë, që është në radhë të parë i realizuar në çeljen e negociatave me Bashkimin Europian", u shpreh Rama. "Ky është një moment ku, nëse ka vullnet e mbi të gjitha nëse ka largpamësi, jo vetëm nga ana jonë, por edhe nga ana e opozitës, ne mund ta shfrytëzojmë si pikënisjen e një procesi ndërveprimi dhe bashkëpunimi për të garantuar se përfaqësuesit e popullit shqiptar në shumicë dhe në opozitë do të bëjnë për Shqipërinë gjithçka që kanë në dorë, në funksion të çeljes së negociatave me Bashkimin Europian", theksoi kryeministri. Ai vuri në dukje se vendi është shumë pranë çeljes së negociatave për anëtarësim, por deri në sekondën e fundit, Shqipëria duhet të bëjë progres. "Pra, është një moment ku ne natyrisht mund të zgjedhim dhe në rast se opozita nuk do të tregojë interes për të kontribuar për vendin në këtë moment do të zgjedhim me shumicë të thjeshtë Prokurorin e përkohshëm të Përgjithshëm, por s'ka diskutim se dëshira dhe predispozita jonë është që të kërkojmë deri në fund mirëkuptim me opozitën, sepse besojmë shumë që kjo mund të



Mbledhje grupit parlamentar të PS-së

themelore që në anglisht, në të jemi bashkë për të treguar se jo vetëm njëra palë, por të gjitha palët këtu duan çeljen e negociatave për anëtarësim, sepse e duan shqiptarët", theksoi kreu i qeverisë. "Nuk ka asnjë qytetar të zakonshëm që nuk na ka votuar, që nuk do çeljen e negociatave për anëtarësim. Ata që i përfaqësojnë këta qytetarë kanë përgjegjësinë që të jenë në lartësinë e dëshirës, aspiratës dhe të nevojës e të drejtës të të gjithë njerëzve të këtij vendi, për të parë më në fund Shqipërinë të hyjë në një kapitull të ri marrëdhëniesh me Bashkimin Europian", sipas Ramës. "Kështu që i lutem shumë Lulzim Bashës ta dëgjojë mirë këtë mesazh dhe të marrë të gjithë përgjegjësinë e udhëheqjes së opozitës në drejtimin e duhur, që është drejtimi i çeljes së negociatave për anëtarësim. Negociatat nuk çelen me Partinë Socialiste. Negociatat çelen me Shqipërinë. Negociatat nuk janë një proces që zgjat sa një mandat. Negociatat janë një proces më i gjatë. Sa më shpejt të çelen negociatat, aq më mirë është për Shqipërinë dhe patjetër, aq më mirë është për çdo forcë politike që aspiron të qeverisë këtë vend, duke qenë sot në opozitë", u shpreh Rama.

ULSI MANJA

Kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja sqaroi deputetët e PS-së dje në grupin parlamentar se sipas ligjit, emri i kryeprokurorit duhet zgjedhur me shumicë të thjeshtë. "Prezimet se kryeprokurori duhet zgjedhur me shumicë të thjeshtë apo të cilësuar i zgjidh Kushtetuta. Kryeprokurori i përkohshëm zgjidhet me shumicë të thjeshtë", tha deputeti Ulsi Manja.

jetë pikënisja e një pakti për Europën, që nuk do të thotë se duhet të rrafshojmë cepat e debatit politik të ditës, debatit politik i ditës mund të vazhdojë pa asnjë problem,

opozita mund të vazhdojë betejat e saj, siç i sheh të arsyeshme, lumenjtë e baltës kundër shumicës mund të vazhdojnë të rrjedhin të pandalur në shqip, por është

LUAN RAMA

"Mosngritja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka çuar edhe në krijimin e problemit të Prokurorit të Përgjithshëm. Sepse në bazë të Kushtetutës, ndryshuar me konsensusin e plotë të 140 deputetëve në kapërcyell të 22-23 korrikut 2016 dhe nën duartrokitjet e përfaqimvet diplomatike nga lozhat e sallës së Kuvendit, vetëm KLP ka tagrin kushtetues të shprehet e të vendosë për Prokurorin e Përgjithshëm!", tha deputeti i LSI-së.



Petrit Vasili

Kreu i grupit të LSI-së: Zgjidhet me 84 vota

Vasili: Kryeministri do që të vjedhë kryeprokurorin, shteti ligjor në rrezik

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se do të vjedhë kryeprokurorin dhe se shteti ligjor është në rrezik. Duke iu referuar deklaratës së kryeministrin në mbledhjen e grupit parlamentar socialist, Vasili tha se nëse Rama e zgjedh vetë kryeprokurorin, ky kryeministër shndërrohet përfundimisht në bandit politik dhe mazhoranca e tij në një shumicë kriminale antiligjore dhe antishtet. "Kryeministri do që të vjedhë kryeprokurorin, shteti ligjor në rrezik. Ky kryeministri flet dhe thotë s'e paska qartësisht të drejtën ta zgjedhë prokurorin e përkohshëm. Kush ia dha këtë të drejtë narkotrafikantëve? Ky nuk ka asnjë të drejtë as kushtetuese dhe as ligjore. Kuvendi i Shqipërisë, shërbimi i tij juridik shpjegon qartë dhe me shkrim se duhen 84 vota. Ku i ka kryeministri 84 vota? Apo shpjegimet që nuk i pëlqejnë nuk i mban mend, i mohon, i refuzon?", u shpreh Vasili. "Ka konsensus të plotë me opozitën dhe që nga sot le të kthehemi në Kuvendin e Shqipërisë dhe të rregullojmë ligjet e bëra copë-copë nga ai dhe suferet e tij, që nuk flasin shqip. Ndryshe, nëse e zgjedh vetë kryeprokurorin, ky kryeministër shndërrohet përfundimisht në bandit politik dhe mazhoranca e tij në një shumicë kriminale antiligjore dhe antishtet. Ndaj këtij banditizmi ka vetëm një përgjigje: përmbyseje pa asnjë hezitim me çdo mjet e mënyrë. Shteti ligjor në rrezik, kjo është emergjencë kombëtare!", deklaroi kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili.

Në garë edhe prokurorja e Shkodrës, Arta Marku

Ferdinand Elezi, kandidati i parë zyrtar për kryeprokurorin e përkohshëm

Pavarësisht thirrjeve të opozitës ndaj prokurorëve me eksperiencë mbi 15-vjeçare në këtë fushë për të mos u regjistruar për postin e kryeprokurorit të përkohshëm, u zyrtarizuan dje disa prej emrave. I pari që u regjistrua ishte drejtuesi i Prokurorisë së Apelit të Durrësit, Ferdinand Elezi, i cili dorëzoi në Kuvend kandidaturën për postin e Prokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm. Gjithashtu, jo zyrtarisht theksohet se listës emërore i është shtuar edhe Arta Marku, me detyrë prokurorë e shkallës së parë në Shkodër dhe Xhemal Saliq, cili vijon punën si prokuror në shkallën e parë në qytetin e Vlorës prej 5 vitesh. Më



herët janë përfolur disa emra si kandidat potencial për të zëvendësuar përkohësisht postin e Adriatik Lllasas, pas mbarimit të mandatit të këtij të fundit më 7 dhjetor të 2017. Emri i Henrik Ligorit u laka pak kohë më parë për t'u pozicionuar në krye të organit të akuzës. Vetë Ligori nuk e ka konfirmuar një gjë të tillë, duke e lënë të hapur çdo mundësi të mundshme.

Ndërkohë së fundmi ka dalë në skenë edhe prokurori tjetër i Krimeve të Rënda, Besnik Muçi. I kontaktuar nga "ABC News", Muçi ka theksuar se do ta zyrtarizojë ose jo kandidaturën e tij ditën martë. Pavarësisht emrave të përmendur më sipër, duket se aplikanti më me shumë mundësi që të zërë përkohësisht postin e Lllasës është Olsion Çela. Ky i fundit duket se ka edhe përkrahjen e kolegëve të tij, duke e mbështetur kandidaturën më potenciale që vjen nga radhët e prokurorisë së Krimeve të Rënda. Edhe Dritan Rreshka pritet t'i shtohet listës shume-emërore për kryeprokuror. Të martën në orën 18:00 është edhe mundësia e fundit për aplikim.

THEMELIMI I PD PERVJETORI

Ish-themeluesi: Kryeministri më i ashpri, çfarë tha në shesh në vitin '91

Shanaj: Mitingu i intelektualëve, Berisha refuzoi fjalën e Ramës

"Biseda me policët që të mos godisnin mbi studentët"

Valentina Madani

Mevlan Shanaj u përfshi familjarisht në lëvizjen demokratike për rrëzimin e diktaturës në dhjetor të '90-ës, bashkë me bashkëshorten dhe dy fëmijët. I rrethuar nga rreziku për jetën nga të gjitha anët, regjisorin i njohur nuk hezitoi, por bashkë me djalin e vogël u drejtua Qytetit Studenti, aty ku kishte nisur rebelimi i studentëve më 8 dhjetor të '90-ës. Mes tyre gjendej edhe vajza e tij studente. Përplasja me policinë dhe shkopinjët e gomës mbi trupat e të rinjve bindi Mevlan Shanajn se tashmë nuk kishte kthim pas. Ai rrëfen për "Gazeta Shqiptare" për ato ditë që bënë historinë e shqiptarëve, si u bë një ndër firmëtarët e parë të krijimit të PD-së, njohjet me Sali Berishën dhe Edi Ramën, angazhimin në politikë dhe si u distancau prej saj vite më pas...

Z. Shanaj, si e kujtoni 8 dhjetorin e vitit 1990?

Nuk ishte ditë e zakonshme dhjetori, ajo e diel. Universiteti i kishte ditë mësimi. Studentët pasi kishin bërë një protestë mbremënjë e së shtunës në Qytetin Studenti, kishin vendosur ta vazhdonin të dielën drejt qytetit. Më thonë që kishte plasur protestën në Rrugën e Elbasanit. Mora djalin 14-vjeçar me vete për të parë se çfarë po ndodhte, pasi kisha vajzën mes studentëve që vinin drejt Tiranës. Policia i kishte bllokuar te Liceu Artistik. Aty pati konfrontime me policisë dhe studentëve, të cilët u shpërndanë pas ndërhyrjes së policisë nëpër shtëpitë dhe rrugicat drejt konvikteve. Ajo ngjarje të çonte në kujtimet e njëjësive guerrilase të para në sa e na filma të luftës, që nuk ishin të paktë deri atëherë. Më kujtohet që me drejtuesin e policisë të asaj kohe kam shkëmbyer disa fjalë, duke i rikujtuar se janë fëmijët tanë aty dhe të kihet kujdes. Shefit të policisë, i cili dikur kishte qenë polic në RTSH dhe njiheshim i thashë të mos përdornin dhunë. Ky ka qenë çasti që mora vendim të jem në mbështetje të studentëve.

Si rrodhën ngjarjet më pas?

Çdo ditë do të gjendeshim në dekorin magjik në kodrat e qytetit të studentëve. Mes shumë të njohurve, ato ditë kishte një emocion dhe lidhje me njëri-tjetrin, si diçka më shumë se sa dashuria. Kishte brenda nesh ëndrra, guxim, droje, pasiguri, por mbi të gjitha shpresë dhe bindje për ndryshim. Frika ishte vërtet brenda meje dhe familjes sime. Më pas ngjarjet e vullshme nuk kishin kohë për të marrë frymë. Di që përfaqësues në takimin me ish-Prezidentin Aliu u kam thënë: "Më e mira do të ishte të vinte ai këtu në Qytetin Studenti, ose ju të kërkonin heqjen e emrit të Enver Hoxhës nga universiteti, ky do jetë testi nëse është për ndryshim apo jo". Këto i kam kujtuar më vonë me shumë nga ata të rinj që ishin larguar të zhgënjyer nga Shqipëria. Kam shumë kuj-




time të atyre ngjarjeve, me pjesëmarrje direkte.

Cili ishte angazhimi juaj në atë periudhë?

Ishte Azem Hajdari kryetar i Partisë Demokratike, me firmën e të cilit më japin një dokument dhe nisem për në Patos. Aty kisha shumë miq e të njohur, por më organi-

MITINGU

Berisha na tha se emrat e atyre që do flasin janë paraqitur në polici, ku është dhënë leja, ndërsa emrat e këtyre që po kërkojnë të flasin nuk janë paraqitur. Me gjysmë miratimi apo me një kthim shpine të Berishës, duke qenë në mikrofon i kam dhënë fjalën pasuesit Edi Rama, i cili foli më ashpërsisht nga të gjithë ne.



NJOHJA

"Me z. Berisha njihem që nga 1959 në Politeknikumin Mjekësor. Kurse z. Edi Rama e njoh që 6 vjeç në studion e 'Pavarësisë', ku unë punoja për model te filmi 'I teti në bronz' dhe ky vinte pas të atit", tha regjisorin Mevlan Shanaj.

zuan një protestë dhe për të shmangur çdo ngatërresë, e mbyllëm. Më vonë u ribë aty një miting, por tashmë Liri Demokraci kishte mposhtur çdo dyshues. Në mitingun e Fierit në kor bërtisnin: "Na fal Mevlan!" për incidentin e Patosit. Po fitonte liria, njerëzit nga fshatrat përfaqësonin grupe-grupe me entuziazmin e paprovuar. Një kontribut kam dhënë në krijimin e sindikatës së vete (RTSH), prej atëherë nuk ka më sindikata në Shqipëri, pasi partitë kur vijnë në pushtet, gjëja e parë që bëjnë është të shfaqin e atavizmat të pushtetit në futje nënshqetull të militantëve të stilit bolshevik apo feudit, jam distancuar nga lojërat politike, duke pritur ëndrrën e votimeve demokratike. Ndoshta ndonjë ditë, kjo çudi me imponim mund të ndodhë në këtë copë vend të bukur e të varfër pafundësisht.

Si jeni njohur me Sali Berishën dhe Edi Ramën?

Me z. Berishën njihem që nga 1959 në Politeknikumin Mjekësor. Kurse z. Edi Rama e njoh që 6 vjeç në studion e "Pavarësisë", ku unë punoja për model te filmi "I teti në bronz" dhe ky vinte pas të atit.

Si e kujtoni ardhjen e Edi Ramës në mitingun që u zhvillua në janar të '91-it?

Në mitingje të tjera si ai i intelektualëve para stadiumit "Qemal Stafa", u paraqit Edi Rama me

Ardian Klosin, të cilët kërkonin të flasin në kohën që po fillonte mitingu. Berisha, i cili na tha se emrat e atyre që do flasin janë paraqitur në polici ku është dhënë leja, ndërsa emrat e këtyre që po kërkojnë të flasin nuk janë paraqitur. Me gjysmë miratimi apo me një kthim shpine të Berishës duke qenë në mikrofon i kam dhënë fjalën pasuesit Edi Rama, i cili foli më ashpërsisht nga të gjithëve ne. Po ashtu, në mitingje apo takime të tjera të hapura apo të mbyllura si në Korçë, Maliq, apo të ras-



Një nga mitingjet e PD-së në vitin 1991

tësishe në Delvinë e Sarandë, minierën e Valiasit, ku kam marrë pjesë, kam theksuar se tashmë jemi për ardhjen e një mendësie tjetër, atë të shprehjes së lirisë së mendimit.

Kur ju i dhatë fjalën, çfarë tha konkretisht z. Rama në miting?

Edi Rama në mitingun e intelektualëve që u zhvillua në janar të vitit '91 tha: "Na skuqi si rusë, na zverdhni si kinezë, na nxu si shqiptarë, Enver Hitler".

Si reagon protestuesit ndaj Edi Ramës?

Fjalimet në ato vite priteshin me entuziazëm nga njerëzit. Më shumë nga të gjithë, sukses kishte Azem Hajdari. Në atë listën e famshme të kërkuar nga instancat e asaj kohe, si firmëtarët themelues është edhe emri im, por deri më sot jam ftuar vetëm një herë. Ftesa do të ketë qenë e rastësishme, ndoshta në vitin 2007.

Për cilat arsye nuk jeni ftuar?

Sepse kam mbetur me idealet e atyre ditëve të para të vërteta të dhjetorit 1990.

Ju po nënkuptoni se PD-ja u është larguar idealeve të dhjetorit '90?

Partia Demokratike jo vetëm që është larguar nga idealet e dhjetorit, por nuk ka asnjë lidhje me ato ideale të pastra. Pastrimet me njerëzit e ndershëm dhe vendosja e të ardhurave në shtet me të gatshme fitimi dhe mohimi kanë sjellë rezultate dramatikë për PD-në.

Nuk shihni asnjë rrugëdalje për ringritjen e PD-së?

Kështu si e kanë, pa bërë analiza të thella, duken larg ardhjes në pushtet. Kur shteti është në rrokullim nuk arrijnë të kuptojnë të vërtetën. PD vazhdon erozionin e saj nga viti në vit, duke mbajtur të fshehur gërryerjet e përvitshme, aq sa arriti të vrasë ëndrrat e atyre që jetonin me ëndrrën dhe shpresën për më mirë.

FJALIMI

"Edi Rama në mitingun e intelektualëve që u zhvillua në janar të vitit '91 tha: Na skuqi si rusë, na zverdhni si kinezë, na nxu si shqiptarë, Enver Hitler", tregon ish-themeluesi i PD-së.



PD feston 27-vjetorin e themelimit, të ftuarit dhe kush mungoi në festë

Basha, thirrje për bashkim: Reflektim për t'u ringritur

"18 maji, për të evituar përplasjen civile, Rama i pabesë"

Valentina Madani

Demokratët u mbledhën mbrëmë në Pallatin e Kongreseve për të festuar 27-vjetorin e themelimit. Në këtë përvjetor, kryetari Lulzim Basha bëri thirrje për bashkimin e të gjithëve, sepse sipas tij, "vetëm reflektimi, vizioni, bashkimi dhe beteja do të na çojë në fitore". Por, disa ish-themelues e figura të rëndësishme të PD-së munguan në festën e mbrëmshme të demokratëve. Mësohet se festa u bojkotua nga Majlinda Bregu, Jozefina Topalli, Astrit Patozi, Eduard Selami, Genc Ruli, Arben Imami, Besnik Mustafaj dhe Rdivan Bode. Megjithatë munguan, kryedemokrati Basha nuk nguroi t'i falënderonte disa prej tyre për kontributin e dhënë për Partinë Demokratike, në nisje të fjalës së tij. "Reflektimi, vizioni, bashkimi dhe beteja na kanë mbajtur dhe na kanë vënë në krye. Kjo është historia, këtë e dimë të gjithë. Reflektimi, vizioni, bashkimi dhe beteja do të na çojnë në fitore. Kjo është e sotmja, kjo është e nesërmeja jonë e sigurt dhe e afërt. Dua që ky lajm të ushtojë fort në zemrat tuaja të çdo demokrati dhe të çdo qytetar shqiptar. Ne do të fitojmë, duke qëndruar fort në truallin e vlerave që janë provuar si fitimtarë në jetën e kombeve të lira dhe në historinë tonë gjithashtu. Ndaj, sot dua të ftoj çdo demokratë dhe demokrat, krenarë për vlerat që na bashkojnë, i vetëdijshëm për përgjegjësitë që më takojnë, që të punojmë të gjithë bashkë për Partinë Demokratike, bijën dhe luftëtaren e paeur të lirisë dhe demokracisë", deklaroi z.Basha. Kreu i opozitës përmendi se ky vit që po lëmnë pas ka qenë një nga më të vështirët për opozitën. "Viti që po mbaron ka qenë një nga vitet tona më të vështira, ku Shqipëria rrezikonte të robërohej nga krimi. Por, ne u ngritëm, ne zgjodhëm të përballlemi me të dhe ju të gjithë e dimë se kjo nuk ishte një përballje e lehtë. Në fillim nuk na besuan, shumë e mbyllën gojën, të tjerë nuk guxuan të na bashkohen. Rrezikuam dhe sakrificuam politikisht, morëm kosto si parti dhe si individë dhe



Kreu i PD-së dje në Pallatin e Kongreseve në 27-vjetorin e themelimit të partisë

NDERIMI
Z.Basha nderoi themeluesit dhe drejtuesit që nuk janë më Hajdarin, Pashkon, Arbnorin, Brocin, Spahian, Olldashin, Ponen si dhe shprehu mirënjohje për themeluesit Selami, Ruli, Zogaj, Mustafaj, Shehu, Pollo, Meksi etj. "Nderimi më i madh për liderin Berisha, pa të cilin PD s'do kishte shpirtin dhe forcën që ka pasur përherë", tha z.Basha.

KRYETARJA E LSI
Monika Kryemadhi: "Uroj 27-vjetorin e Partisë Demokratike. I uroj suksese edhe liderit të saj, Lulëzim Basha. PD lindi si një nevojë për ndryshim dhe kjo është ditë reflektimi për rrugën e Shqipërisë që nga ai dhjetor e deri tani. PD ka luajtur një rol të spikatur në mazhorancë dhe në opozitë. Opozita shqiptare sot përballlet me sfida të ngjashme me ato të dhjetorit të viteve 1990, i cili ishte një mësim si rrezohen diktaturat.



Astrit Patozi

Patozi: PD drejtim i gabuar, pasojat dramatike

Ish-deputeti demokrat, Astrit Patozi komentoi dje 27-vjetorin e themelimit të PD-së. Përmes një statusi në "Facebook", z.Patozi shprehet se Partia Demokratike po vuan sot pasojat dramatike të drejtimit të gabuar që e ka larguar atë shumë prej misionit dhe traditës së vet, duke e shndërruar me shpejtësi në një forcë politike të pafuqishme, të vjetruar dhe që nuk frymëzon më askënd. Sipas tij: "27 vjet pas themelimit të saj, Partia Demokratike e sheh veten në kuotën më të ulët të peshës së saj politike dhe të ndikimit të vet në zhvillimin e Shqipërisë. Është një rënie në pikat, e rëndë dhe e pamerituar për dhjetëra e mijëra demokratë të përkushtuar, të cilët iu bashkuan asaj në kohë të ndryshme, që nga dhjetori i '90-ës e deri më sot. Arsyeya nuk ka të bëjë aspak me fundin e një cikli të natyrshëm për një parti dhe aq më pak është konspirative apo gjeopolitike. Partia Demokratike po vuan sot pasojat dramatike të drejtimit të gabuar, që e ka larguar atë shumë prej misionit dhe traditës së vet, duke e shndërruar me shpejtësi në një forcë politike të pafuqishme, të vjetruar dhe që nuk frymëzon më askënd", shprehet ish-studenti i dhjetorit, Astrit Patozi. Ai vëren se: "Për shkak të keqmenaxhimit të saj, sidomos në 4 vitet e fundit, demokratët në mbarë vendin gjenden sot në një pozitë të vështirë, që nuk ka të bëjë tjetër me shifrat dëshpëruese të humbjeve në zgjedhjet e fundit. Përtej tyre, lidhshipi i Lulzim Bashës i ka shkatërruar gati plotësisht të gjitha kolonat kryesore, që mbajnë në këmbë dhe të karikuar një parti politike moderne".

Urimi, Meta: Suksese në përmbushjen e përgjegjësisë

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta ka uruar Partinë Demokratike me rastin e 27-vjetorit të themelimit të kësaj force politike. Në mesazhin e Metës citohet se Partia Demokratike është forca e parë opozitare në vend dhe i uron suksese në përmbushjen e përgjegjësisë për të ardhmen europiane të vendit. "Në këtë përvjetor të themelimit të Partisë Demokratike, si forca e parë opozitare në vend, kam kënaqësinë t'i uroj kësaj partie, lidhshipit, anëtarëve dhe simpatizantëve të saj, suksese në përmbushjen e përgjegjësisë tepër të rëndësishme për të ardhmen europiane të vendit", - thuhet në mesazhin e Metës.



Mungoi në festë, Bregu: Nuk bëj 'qokë' në shtëpinë time

Ish-ministria Majlinda Bregu shpjegoi dje mungesën në ceremoninë e 27-vjetorit të PD-së. Ajo thotë se ftesa ishte një formalitet për 'qokë' ndaj Lulzim Bashës, ndaj nuk mund të bëjë 'qokë' në shtëpinë e saj. Sipas Bregut, kjo e sotmja nuk mund të jetë dita e bashkimit, sepse premtimi i sotëm për bashkim, garë e reflektim s'është asgjë tjetër veçse farsa e radhës. Bregu shprehet në një reagim për "Balkanweb" se bashkimi nuk ka sesi të vijë pa reflektuar më parë për ndarjen e pa marrë më parë përgjegjësinë për fyerjen që u është bërë demokratëve, apo edhe për katandisjen që iu bë Shqipërisë pas 27 viteve demokraci, duke e lënë në pikë të hallit, siç nuk ka qenë kurrë më parë, pa opozitë. "Dhe meqë unë s'jam as tek themeluesit, as tek përmbartuesit, zgjidha të mos shkoj", - shprehet ish-deputetja Majlinda Bregu.

prapë qëndruam. Sot, pak muaj pas zgjedhjeve, përpjekjet tona po japin rezultat dhe shqiptarët po u kuptojnë drejtësinë dhe vetëmohimin e betejës që ne bëjmë dhe po na japin vlerësimin

dhe mbështetjen që meritojmë. Ky është fillimi i shpërbërjes së strukturës kriminale, të shpërbërjes së gënjeshtërsë së madhe mbi të cilën qëndron narko-qeveria në pushtet", tha z.Basha.

Kreu i PD-së foli edhe për marrëveshjen me Ramën, për të cilën tha se qëllimi dhe thelbi ishte të evitohet përplasia civile, destabilizimi i vendit dhe angazhimi i grupeve kriminale në shtetblerjen e votës. "Sigurisht që ne do të kishim dashur që kriminalizimi dhe kanabizimi të luftoheshin e të ndaleshin në kohë, pa u bërë kopicë, siç u bëhë. Kemi luftuar dhe kemi dëshiruar për një gjë tjetër, si droga, krimi dhe paratë e pista të mos prishnin një festë të popullit të lirë, siç janë zgjedhjet. Për këtë, arsye ne pranuan draft-marrëveshjen për zgjedhjet, që partneri ynë strategjik, SHBA, u propozoi shumicës dhe opozitës shqiptare. Qëllimi dhe thelbi i marrëveshjes ishte të evitohet përplasia civile, destabilizimi i vendit dhe angazhimi i grupeve kriminale në shtetblerjen e votës. Edi Rama u ul në bisedime, por bëri krejtësisht të kundërtën e asaj për të cilin u bë marrëveshja. Tani zullumi dhe pabesia po u ngecin në fyt. Politika nuk është e pistë apo hileqare në vetvete, por është e fillë për ata që duan ta bëjnë pis e të paskrupullat atë", thoshte Vasllav Havel. Politika hakmerret një ditë ndaj tyre. Kjo është një ligjësi e hekurit", u shpreh kreu i PD-së. Nga organizatorët, ashtu siç e kërkon 'zakoni', ishte dërguar një ftesë edhe në selinë e PS-së, që ka zgjedhur për t'u përfaqësuar me deputetën dhe nënkryetaren e parlamentit, Vasilika Hysin. Ajo është fotografuar mes dhjetëra demokratëve, teksa dëgjonte edhe fjalën e kreut të PD-së, Lulzim Basha.

Ambasadori i Austrisë: Keni avantazh, nuk keni probleme etnike

Johan Sattler: Shqipëria, gati për hapjen e negociatave në 2018

KLIMA E BIZNESIT

"Panorama e paraqitur, për të qenë të ndershëm, nuk është aq e mirë. Ajo tregon se është e vështirë, sidomos për bizneset e vogla apo mesatare, për të futur këmbët në tregun shqiptar, është problemi i korrupsionit, por ky problem nuk është vetëm në Shqipëri, por në të gjithë rajonin", tha dje ambasadori austriak.

qenë se kam pasur kënaqësinë të punoj për një periudhë kohe edhe në shtete të tjera të rajonit, avantazhi i Shqipërisë në krahasim me shtete të tjera të rajonit është se nuk ka probleme me strukturën shtetërore, nuk ka probleme mes etnive të ndryshme dhe më e rëndësishmja, Shqipëria nuk ka problem e dilemës Lindje-Perëndim. Shqipëria ka një orientim të qartë drejt Perëndimit", u shpreh ai.



Ambasadori i Austrisë në Shqipëri, Johan Sattler

"Mendoj se ky është një avantazh i madh, i cili unë mendoj se gjithashtu do ta ndihmojë Shqipërinë. Dhe e fundit, por jo për nga rëndësia, mendoj se keni mjaft njerëz energjikë, të cilët dëshirojnë

ndryshimin, që dëshirojnë që vendi të zhvillohet për hir të fëmijëve të tyre dhe ky është një vend që ka potencialin të zhvillohet", u shpreh ambasadori i Austrisë në Tiranë.

Socialistët e opozita debatojnë për përmbytjet në Komisionin e Sigurisë

PS braktis mbledhjen, Noka: U keni 'futur gishtin' qytetarëve

Braimllari: Mazhoranca e çorientuar, fshehu situatën

Deputetët e Partisë Socialiste në Komisionin e Sigurisë Kombëtare braktisën dje mbledhjen e komisionit pas debateve të ashpra mes kryetares Ermonela Felaj dhe nënkryetarit demokrat, Flamur Noka. Në rendin e ditës së mbledhjes ishte raportimi i zv.ministrit të Mbrojtjes, Petro Koçi, për përbalimin e situatës së përmbytjeve në vend, por mosdhënia e fjalës demokratit Flamur Noka nga kryetarja e Komisionit parlamentar të Sigurisë, Ermonela Felaj ka ngjallur debate të ashpra mes tyre gjatë mbledhjes. Deputeti i PD-së, Noka u shpreh me fjalë fyese për kryetaren e komisionit, madje ia hoqi mikrofonin Felajt në një moment, duke e detyruar atë të deklarojë mbylljen e mbledhjes. "Dëmshtëpërbllim do të thotë gjendje emergjence, kur nuk shpallet gjendje emergjence, ju u 'keni futur' gishtin qytetarëve dhe nuk i dëmshtëpërbllim. Ajo që po shohim është e turpshme dhe e neveritshme. Fjalën nuk ma ndalon dot mua jo Salmonela", por askush, se e kemi fituar dikur: Shqiptarët duhet të kuptojnë një gjë, e gjithë e ajo situatë që u duk sikur po tentohej të përballohej ishte një maskaradë fyese dhe ofenduese për ta. Të gjithë të përmbyturit duhet të kenë parasysh se sa kohë nuk është ngritur shtabi i emergjencës, nuk është shpallur gjendja e emergjencës, nuk do të marrin asnjë dëmshtëpërbllim, në kuadrin e qeverisë do të marrin vetëm mashttrim dhe gishtin mbrapa", u



Komisioni parlamentar i Sigurisë Kombëtare

DEBATET NË KOMISIONIN E SIGURISË KOMBËTARE

- FELAJ:** Fjalën e ka kërkuar zoti Murrizi. A mundem ta dëgjoj?
- NOKA:** Dua të flas.
- FELAJ:** Një minutë, të më thotë ai që nuk do të flas. Noka i tërheq me forcë mikrofonin Felajt.
- FELAJ:** Ça është kjo histori?
- NOKA:** Kur të them unë, do të flas. Kur të kërkoj unë fjalën, nuk bëhet fjalë më thënë nuk ka fjalë.
- FELAJ:** Lëri këto sjellje se nuk të pinë ujë.
- NOKA:** A ka mundësi, pusho!
- FELAJ:** Turp për ty!
- NOKA:** Turp për ty që mundohesh me u bë burrë! Nuk merrem me ty unë, merrem me fjalën time. Oj vajzë, shko mëso rregullat ti.
- FELAJ:** Unë kam respekt për kolegjin tim, e kërkoj fjalën.
- NOKA:** Lëri, lëri ato, nuk të kërkoj kush respekt ty, nuk ka nevojë njëri për respektin tënd askush. Dëgjo të flas unë këtu. Nuk ka nevojë me të dhënë llogari ty ai. Këta nuk janë asnjëri me të dhënë llogari ty, sa kanë parë si puna jote këtu para teje dhe sa do të shohin pas teje. Dëgjo këtu Pjeterin.
- FELAJ:** Ju falënderit për prezencën tuaj, mbledhjen e deklaroj të mbyllur (Ngrihet dhe ikën).
- NOKA:** Dëmshtëpërbllim do të thotë gjendje emergjence, kur nuk shpallet gjendje emergjence, ju u 'keni futur' gishtin qytetarëve dhe nuk i dëmshtëpërbllim. Në qeverinë e PD, 30 milionë euro vendime qeverie janë dhënë se janë shpallur gjendje e emergjencës. Ajo që po shohim është e turpshme dhe e neveritshme. Fjalën nuk ma ndalon dot mua jo Salmonela", por askush se e kemi fituar dikur. Shqiptarët duhet të kuptojnë një gjë, e gjithë e ajo situatë që u duk sikur po tentohej të përballohej ishte një maskaradë fyese dhe ofenduese për ta. Të gjithë të përmbyturit duhet të kenë parasysh se sa kohë nuk është ngritur shtabi i emergjencës, nuk është shpallur gjendja e emergjencës, nuk do të marrin asnjë dëmshtëpërbllim, në kuadrin e qeverisë do të marrin vetëm mashttrim dhe gishtin mbrapa.
- (Ngrihen edhe deputetët e mazhorancës dhe largohen nga mbledhja).
- BRAIMLLARI:** E turpshme që të ikë mazhoranca nga komisioni. Jeni totalisht të çorientuar dhe nuk ju u interesojnë situatat e qytetarëve. Nuk është e vërtetë që përmbytjet kanë qenë më të pakta, por nuk i raportoni dhe i fshihni. Kjo tregon papërgjegjshmërinë tuaj.
- SALIANJ:** S'ka ndodhur ndonjëherë në historinë e parlamentarizmit më mazhoranca të braktisë detyrën se i kërkohet llogari nga opozita, nëse do dëmshtëpërbllim qytetarët. Asnjëherë nuk jemi bashkë dhe as nuk do të jemi, sepse këta mendojnë se e kanë qeverinë për të vjedhur vota. Ministria të vijë e përgatitur.

Presidenti

MESAZHI

Presidenti i Republikës, Ilir Meta i dërgoi dje një mesazh Atit të Shenjtë Papa Françesku, për meshën e së dielës, e cila u kushtua Shqipërisë për përmbytjet që prekën vendin 10 ditë më parë. Meta e falënderon Papën për mbështetjen dhe solidaritetin me popullin shqiptar.

NOKA
"Shqiptarët duhet të kuptojnë një gjë, e gjithë ajo situatë që u duk sikur po tentohej të përballohej ishte një maskaradë fyese dhe ofenduese për ta. Të gjithë të përmbyturit duhet të kenë parasysh se sa kohë nuk është ngritur shtabi i emergjencës, nuk është shpallur gjendja e emergjencës, nuk do të marrin asnjë dëmshtëpërbllim, në kuadrin e qeverisë do të marrin vetëm mashttrim dhe 'gishtin mbrapa'".

shpreh Noka. Pas largimit të mazhorancës, deputeti i LSI-së, Endrit Braimllari tha se, "është e turpshme që të ikë mazhoranca nga komisioni. Jeni totalisht të çorientuar dhe nuk ju u interesojnë situatat e qytetarëve. Nuk është e vërtetë që përmbytjet kanë qenë më të pakta, por nuk i raportoni dhe i fshihni. Kjo tregon papërgjegjshmërinë tuaj", u drejtua Braimllari deputetëve të PS-së. Zëvendësiministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, më herët deklaroi se fondi i kompensimit do të dalë pasi të përlogariten dëmet në terren. Koçi tha se Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura ia kanë dalë me sukses në këtë situatë emergjence. Koçi vuri theksin se

MM ka ngritur grupin menaxhues për mbledhjen, shoqërimin dhe ndarjen e ndihmave të ardhura nga jashtë dhe brenda vendit. Gjithashtu, sipas tij, dalja e lumenjve dhe përrënjeve solli përmbytje të mëdha, prishje argjaturash, përmbytje shpëtim, etj. "Rikthimi në gjendje normale të zonave të prekuara nga fatkeqësia mbetet detyrë e FA. Faza e rikthimit në gjendje normale kërkon kohë. Batalioni i mbështetjes rajonale dhe xhenio janë aktivizuar në largimin e ujit nga banesat, ndërtime dhe forcimin e urave, mbledhjen e ndihmave", - tha z. Koçi. Zëvendësiministri i Mbrojtjes deklaroi se janë angazhuar mbi 2 mijë forca gjatë përmbytjeve dhe rreth 544 mjete. "Është ndërhyrë në Gjirokastrë me 26 forca, në Tiranë me mbi 200 forca, në Kamëz u angazhuan 130 forca, në Krujë është ndërhyrë me helikopter, në Fier u përfshin 608 forca. Ministria e Mbrojtjes i ka bërë kërkesë NATO-s për ndihma, priten ndihma nga vendet anëtare të kësaj organizate. Mali i Zi i dha ndihmat e para në Qarkun e Vlorës, forca mbështetëse ka pasur edhe nga Kosova, e cila ka ofruar ura 'bailey', gjithashtu edhe ushqime. Janë shpërndarë ndihma edhe nga Kryqi i Kuq dhe rezervat e shtetit", - sqaroi zëvendësiministri, Koçi. Duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve për dëmshtëpërbllim e të dëmtuarve, Koçi tha se ende nuk është përlogaritur fondi që do të lëvrohet për të kompensuar familjet e dëmtuara.

Prezantohet skema e re mbështetëse për fermerët dhe mënyra e aplikimit

Subvencionet për bujqësinë, si të përfitoni nga fondi 20 mln euro

Nga drurët frutorë te bimët medicinale, projektet që do të financohen

Ornela Manjani

Prezantohet skema e re mbështetëse për bujqësinë, e cila përbëhet nga një fond prej 20 milionë eurosh dhe synon që t'i japë zgjidhje tri çështjeve. Së pari, ndjekja e modelit ekonomik të rritjes së eksporteve, duke mbështetur të gjithë ato produkte bujqësore që kanë peshë në shportën totale të eksporteve, së dyti, afrimi i sa më shumë fermerëve në organizma të përbashkët, çka siguron qëndrueshmëri dhe prodhim më të lartë dhe së treti, politikë që mund të ndërmerren për të zhvilluar ato sektorë të ndërmjetëm, si: agroturizmi, agriturizëm, agropëpunim, peshkim dhe akuakulturë. Strategjia e re u prezantua dje në Konferencën Kombëtare të Bujqësisë nga ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Niko Peleshi

FERMERËT

Janë 2,6 miliardë lekë, të cilët do të shkojnë për materializimin e prioritetëve që qeveria shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka vënë në shërbim të bujqësisë, blegtorisë, peshkimit dhe agropëpunimit gjatë këtij mandati. Gjatë fjalës së tij, në këtë konferencë, ku u bë prezantimi publik i politikave për sektorin dhe skema e re mbështetëse prej 20 milionë euro, ministri i Bujqësisë, Niko Peleshi tha se tashmë janë jetësuar fer-



Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Niko Peleshi

ma të mëdha, dhe se trend janë fermerët e rinj të shkolluar jashtë që kanë investuar kursimet e tyre në bujqësi. Ministri u ka kërkuar fermerëve të ndryshëm të grupohen në Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB), sepse në këtë mënyrë mund të përfitojnë më shumë nga Skema e Mbështetjes. "Ne kemi mundësi që përmes ARZHR të mund të zbusin kostot. Mbështetjen me 25% më

shumë nëse aplikojnë si grup fermerësh", tha ministri. Në këtë kontekst ai solli shembullin e fermerëve të zonës së Xarrës me mandarinat. Për ministrin rolin më të madh do ta luajë Agjencitë Rajonale të Zhvillimit Rajonal nëpërmjet skemë mbështetëse. **PROJEKTET**
Qeveria do të mbështesë projekte nga drurët frutorë të bimët medicinale, çfarë do mbështetet. Ministria e

Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bëri me dije se konceptimi i skemës mbështetëse është kryer në bashkëpunim me shumë aktorë vendas dhe të huaj. Nga ky bashkëpunim u krye identifikimi i sektorëve prioritarë në bujqësi, agroturizëm, agropëpunim, peshkim dhe akuakulturë, po kështu u përcaktuan 15 produkte të shportës bazë ku përfshihen që nga drurët frutorë, prodhimet të serave, bimë medicinale

FONDI

Janë 2,6 miliardë lekë, të cilët do të shkojnë për materializimin e prioritetëve që qeveria shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka vënë në shërbim të bujqësisë, blegtorisë, peshkimit dhe agropëpunimit gjatë këtij mandati.

inale. Kjo shportë u kompozua në bazë të kriterëve që kanë të bëjnë me matjen e fluksit të eksportit të produktit, me potencialet e tyre në të ardhmen me masën e punësimit. **PËRFITUESIT**
Fermerët që kooperojnë në Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor do të përfitojnë më shumë sesa një fermer i vetëm. Përpunuesit e qumështit, blegtorët, prodhuesit dhe grumbulluesit e bimëve medicinale do të kenë kriteret e tyre që kanë të bëjnë me arrijten e standardeve. Një mbështetje do t'u jepet grumbulluesve, të cilët kërkojnë të bëjnë qendra të reja grumbullimi në sektorin e peshkimit. Një nga përfituesit e Skemës Kombëtare të Mbështetjes do të jenë dhe fermerët dhe sipërmarrësit e rinj të moshës 22-35 vjeçare, të cilët do të përfitojnë një trajtim tjetër. Gjithashtu, nga kjo skemë do të përfitojnë dhe prodhuesit e produkteve artizanale. "Një risi që Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural do të sjellë është kryerja e aplikimit në Skemën e Mbështetjes do të bëhet online me zero shpenzime. Regjistrimi do të bëhet në portalin e-Albania vetëm me anën e kartës së identifikimit dhe Nipt-it të fermerit. Ngritja e sporteleve Agropika do t'u vijë në ndihmë fermerëve për plotësimin e formularit të aplikimit dhe do të ketë informacion të plotë rreth fushave që mbulon dhe çfarë ofron kjo skemë"- njoftoi ministria.

Ligji i faljes, afati për të përfituar deri më 31 dhjetor

Aksioni antiinformalitet, mbyllet 541 biznese, falen 17 mln lekë detyrime

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka njoftuar përfundimin e javës së nëntë të aksionit antiinformalitet. Tatimet kanë bërë të ditur edhe disa nga rezultatet kryesore të aksionit si dhe ecurinë e procesit të faljes fiskale, i cili do të vazhdojë deri në fund të këtij viti. Sipas tatimeve, ka vijuar procesi i fshirjes automatike të detyrimeve për periudhën përpara viteve 2010 dhe kompensimi me kredi si për periudhën përpara vitit 2010 dhe atë 2011-2014. Bizneset e reja, të regjistruara, kanë arritur 4602, ndërsa janë mbyllur me shkelje 541 biznese. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve bën të ditur se shërbimi i Tatimpaguesve ka asistuar ballë për ballë 61,170 tatimpagues dhe 10,086 është numri i tatimpaguesve të kontaktuar për ligjin e faljeve. Ndërkohë mbi 26,447 tatimpagues janë kontaktuar për të nxitur vetëkorrigjimin; 10,862 është numri i vizitave këshilluese të përfunduara.



Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve

HETIMI TATIMOR DHE ZBATIMI

"Strukturat e zbatimit kanë vijuar me verifikim në territor, janë verifikuar 23,644 subjekte ku 20.5% e tyre kanë rezultuar me shkelje dhe janë penalizuar. Janë futur në skemën e sigurimeve shoqërorë gjatë nëntë javëve të para të aksionit 935 punonjës, që janë konstatuar të padeklaruar dhe janë mbyllur 541 subjekte të paregjistruara në organet tatimore si dhe për shkelje të tjera si: moslëshim kuponit për herë të dytë; " Janë regjistruar 4,602 subjekte të reja.

Tatimet kanë organizuar 83 takime me komunitetin e biznesit në territor; qendra e thirrjeve ka vijuar të ofrojë

shërbimet në numrin e vënë në dispozicion për çdo problematikë dhe suport ndaj çdo tatimpaguesi duke asis-

tuar rreth 14,117 telefonues, si dhe përdorues të live chat. Mësohet se ka vijuar sensibilizimi për të mundësuar mbledhjen e detyrimeve të prapambetura, ku gjatë kësaj periudhe, numri i subjekteve që kanë reaguar pozitivisht është 2,756 dhe vlera është 2 miliardë e 190 milionë lekë. Ndërkohë që ka vijuar procesi i fshirjes automatike të detyrimeve për periudhën përpara vitit 2010 dhe kompensimi me kredi, si për periudhën përpara vitit 2010 dhe atë 2011-2014, gjithashtu, dhe fshirja e detyrimeve me kusht për periudhën 2011-2014 për ata tatimpagues që kanë paguar principalin, më shumë se 28,535 tatimpagues kanë përfituar dhe ky proces vijon ende. Si rezultat i këtij procesi shuma e detyrimit të futur është 17.184 miliardë lekë dhe përdorimi i kredisë për shlyerje të detyrimeve në nivel principal, është në vlerën 1.697 miliardë lekë.

Dërgimi i parave, Sejko: Kostot janë më të lartat në rajon

Kostot e dërgimit të remitancave në Shqipëri janë më të larta në raport me rajonin. Sipas një vërtetimi të Bankës Botërore, kosto e dërgimit të parave në rrugë formale në Shqipëri është 9.4% e shumës së dërguar, ndërsa për rajonin tonë mesatarja është 7.2%. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, tha të hënën se duhet punuar për të ulur kostot e transferave, më nënërrë që të ulet edhe niveli i lartë i dërgesave cash. "Duke vlerësuar përfitimet që rrjedhin nga depërtimi formal i remitancave në ekonomi dhe kontributin e deritanishëm të sektorit bankar dhe financiar, Banka e Shqipërisë sugjeron një vëmendje më të shtuar në drejtim të reduktimit të kostovet të transferave, dhe përmirësimit ose dizenjimit nga e para të produkteve dhe shërbimeve të dedikuara për këtë segment të popullatës. Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë angazhohet në modernizimin e mëtejshëm të infrastrukturave të sistemeve të pagesave, apo përshtatjen e legjislacionit me direktivat e Bashkimit Evropian, në funksion të një tregu të hapur, pa barrierat dhe konkurrencës"-u shpreh Sejko. Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Shtetit për Diasporën, organuan një takim të nivelit të lartë për remitancat, me pjesëmarrjen e drejtuesve të bankave tregtare dhe subjekteve financiare jo banka në angazhuara në aktivitetin e transferave të parave. Guvernatori Sejko dhe ministri Majko vlerësuan kontributin e madh të emigrantëve në ekonominë shqiptare përmes dërgesave të parave, duke vënë njëkohësisht theksin në rëndësia e një përdorimi sa më efektiv të këtyre parave. "Ekonomia dhe paratë e dërguara nga emigrantët gjatë viteve të tranzicionit kanë ndihmuar nivelin e jetës familjare shqiptare, por nuk ka ndikuar në zhvillimin strukturor të vendit. Ato kanë mbuluar mungesën e politikave efektive zhvillimore nën ndikimin e rregullave konservative të familjes tradicionale shqiptare. Shqipëria, pavarësisht nivelit të lartë të remitancave, nuk i ka përdorur ato për të siguruar rritje të strukturave ekonomike",- shtoi ministri për Diasporën, Pandeli Majko.

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjicknuri, ka shfuqizuar licencat për 80 linja autobusësh, duke rrëzuar kështu urdhrin e titullarit të mëparshëm të këtij institucioni. Me këtë vendim, ministri Gjicknuri ka shfuqizuar urdhrin e paraardhësit të tij në këtë detyrë, Sokol Dervishaj, i cili në korrik dha mbi 80 licenca për linja ndërqytetëse. Pas këtij vendimi për shfuqizimin



Linjat ndërqytetëse, Ministria e Infrastrukturës do të nxjerrë udhëzim të ri

Gjicknuri shfuqizon licencat për 80 linja autobusësh

e licencave, ministri Gjicknuri do të nxjerrë një udhëzim të ri për linjat ndërqytetëse. Shkak për këtë situatë është bërë qëndrimi i shqatave të autobusëve, të cilët janë shprehur kundër dublim-it të linjave. Ministri i Transportit, Damian Gjicknuri ka shfuqizuar urdhrin nr 3917 të paraardhësit të tij, Sokol Der-

vishaj për rregullimin e linjave ndërqytetëse. **VENDIMI** Vendimi është marrë për shkak se operatorët që kryejnë linjat ndërqytetëse kanë ngritur shqetësimet të vazhdueshme deri në protesta, pasi, sipas tyre, ka pasur mbivendosje licencash. Shqetësimi ky i ngritur vazh-

dimisht sidomos nga operatorët e linjës Tiranë-Elbasan. Ministri Gjicknuri do të nisë edhe një auditim për mes grupit të punës për të parë mënyrën se si janë miratuar 80 linja dhe 60 licenca nga ish-ministri Dervishaj. Pasi të përfundojë ky proces, ministria do të udhëzojë mënyrën e re për miratimin e linjave

ndërqytetëse dhe kriteret ligjore që duhet të plotësojnë. Ministria e Transporteve garanton se gjithçka do të bazohen në studimet përkatëse dhe nuk do krijojnë problematikë mbivendosjesh. Ministri Gjicknuri arriti në këtë konkluzion pasi më herët urdhëroi ngritjen e një grupi pune që u kryesua nga sekretari i Përgjithshëm i MIE, Gentian Keri. Grupi i punës analizoi problematikat dhe raportoi mbi situatën e këtij sektori.

Policat e sigurimit, AMF miraton modelin e ri dhe afatet që do zbatohen nga byroja

Ornela Manjani

Ndryshon procedura për sigurimin e detyrueshëm të automjeteve

Rregulloja e re hyn në fuqi në 1 janar të vitit 2018

Policat e sigurimit për automjetet do të emetojnë nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, e cila do të dorëzojë modelin pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Polica e sigurimit të mjetit motorik, për dëme shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, do të përbëjë 9 shifra dhe dy të fundit duhet të korrespondojnë në vitin korrent kur kryhet sigurimi i detyrueshëm. Ndryshimet janë miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe hyjnë në fuqi në 1 janar të vitit 2018.

VENDIMI

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka vendosur të miratojë modelin për policat e sigurimit që do të emetohen nga Byroja Shqiptare e Sigurimit. Ndryshimet i referohen rregullores së vitit 2010 "Për standardet e raportimit të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit" ku përcaktohen detajet lidhur me numrin serial, procedurën e miratimit në AMF si dhe afatet për të kaluar të gjitha hallkat e nevojshme. "Byroja depoziton në Autoritet, përpara emetimit, specimetet e policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit. Të gjithë policat e sigurimit duhet të përbëjnë numrin serial 9 (nëntë) shifror, ku 2 numrat e parë të korrespondojnë me 2 numrat e fundit të vitit korrent për të cilin emetohen policat e sigurimit të përgjegjësishë së pronarit ose përdoruesit të mjetit motorik për dëme shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti. Byroja fillon procedurën për emetimin dhe prodhimin e policave të sigurimit të detyrueshëm pas dhënies së pëlqimit nga Autoriteti, në përputhje me rregulloret përkatëse të hartuara nga Byroja lidhur me emetimin, prodhimin, administrimin dhe shpërndarjen e tyre", thuhet në nenin 14 të ndryshuar në rregullore.

AFATET

Afatet për emetimin e policave të reja dhe asgjësimin e atyre ekzistuese. Autoriteti i Mbikëqyrjes



Foto ilustruese

BYROJA E SIGURIMIT

Byrotë dhe shoqëritë e sigurimit, të cilat janë anëtare të tyre dhe që janë të licencuara, të lëshojnë një policë sigurimi që mbulon përgjegjësinë ndaj palës së tretë, përbëjnë bazat e Sistemit të Kartonit Jeshil. Byrotë furnizojnë anëtarët e tyre me Karton Jeshil dhe garantojnë dëmshpërbimin e drejtë të palëve të treta të dëmtuara. Byrotë ndahen në byro paguese dhe byro trajtuese.


pavlefshme. Policat e sigurimit të detyrueshëm të pakonsumuara në vitet pararendëse të asgjësohen sipas procedurës së përcaktuar në nenin 14/a të kësaj Rregulloreje, brenda datës 31.01.2018" thuhet në rregullore.

POLICAT E SIGURIMIT

Sipas ligjit në fuqi shoqëritë e sigurimeve raportojnë çdo policë sigurimi të detyrueshëm nëpërmjet këtij sistemi ku dhe këto të fundit identifikohen me anë të numrit të rastësishëm. Të dhënat e kërkesës për shitje nga terminalet e shoqërive vijjnë në kohë reale në serverët e AMF-së. Për çdo kërkesë programi emeton automatikisht një numër unik të rastësishëm, i cili shpërndahet në momentin e lëshimit nga rrjeti i shitjes. Ky numër i rastësishëm është unik dhe i trajtës alfamerike dhe shërben për të vërtetuar raportimin e policës në bazën e të dhënave qendrore në Autoritet. Menjëherë pas lëshimit të policës të dhënat e policës dërgohen për efekt raportimi në regjistrin e sigurimeve të detyrueshme motorike të instaluar në serverët e AMF-së. Anulimet e policave do të kryhen vetëm nga personeli i autorizuar i shoqërisë dhe më të drejta ekskluzive të atribuara në sistemin nga njëjta e administrimit të Regjistrimit Online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik. Numri unik i gjenuar nga Regjistrimi Online duhet të printohet në policën e sigurimit të detyrueshëm motorik. Raportimi i të dhënave duhet të kryhet në kohë reale dhe pa ndryshime të të dhënave të raportuara në krahasim me ato të printuara në policën e sigurimit të detyrueshëm motorik.

Dëmet në aksidente dhe pagesat

Për 10 vjet janë paguar 10 milionë euro



cila, në fund të fundit, është përgjegjësi e shkaktarëve të dëmeve. Gjykatat kanë shpallur vendime për Byronë e Sigurimit, duke mos

thërritur shkaktarët e dëmeve në gjykatë, për të cilat ato janë përgjegjës që në fund të fundit do paguajnë dëmin dhe byroja është

garantuese e pagesës së dëmit e, ndonjëherë edhe Policia e Qarkullimit Rrugor, segmente të prokurorisë dhe instrumente të tjera kanë krijuar precedentin negativ, duke rënduar shumë ashpër personat e pasiguar, shkaktarët të dëmeve me vlera dëmshme shumë të mëdha, duke i rritur ato artificialisht, duke menduar se do paguajë Byroja e Sigurimeve dhe duke hartuar se paguesi i fundit do jetë shkaktori i dëmit të pasiguaruar" -thuhet në sqarimin e byrosë për tregun e sigurimeve dhe fondin e kompensimit.

Financiare ka miratuar në të njëjtat ndryshime edhe disa dispozita kalimtare që lidhen me afatet për emetimin e policave të reja si dhe asgjësimin e atyre

ekzistuese. "Emetimi, prodhimi dhe furnizimi me policat e sigurimit të detyrueshëm për vitin 2018, sipas formatit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 14, të kësaj

Rregulloreje duhet të përfundojë brenda datës 31.12.2017. Policat e sigurimit të detyrueshëm, sipas formatit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 14, të kësaj

Rregulloreje, do të hidhen në treg duke filluar nga data 01.01.2018. Çdo policë e sigurimit e shitur në kundërshtim me formatin e përcaktuar do të konsiderohet

Kara: Prokurorja mori 10 ditë kohë për të lexuar dosjen me mbi 5000 faqe

Skandali i CEZ, Balla e Kara në gjykatë: Të mos pushohet hetimi

Balla: Po mbyllet dosje me akuza të rënda

Ish-juristi i OSHEE, Romeo Kara dhe ish-kreu i komisionit hetimor për skandalin e CEZ, Taulant Balla janë paraqitur në Gjykatën e Tiranës. Romeo Kara kërkon që prokuroria të mos pushojë hetimin për privatizimin e OSHEE te kompania çeke CEZ. Ndërkohë, Taulant Balla është paraqitur si palë e interesuar, pasi edhe komisioni parlamentar i vendit ka kërkuar hetim. Kërkesa është depozituar dje përpara gjyqarit Lazër Sallaku, ndërsa mbetet për t'u parë nëse gjykata do pranojë këtë kërkesë, apo do lërë në fuqi vendimin e prokurorisë për mbylljen e dosjes. Ish-juristi Kara jashtë dverve të gjykatës tha se prokurorja që mbylli hetimin ndaj skandalit CEZ nuk e ka lexuar dosjen prej më shumë se 5 mijë faqesh. Romeo Kara theksoi se Prokuroria nuk ka dashur të konstatojë dëmet e mëdha të shkaktuara nga ky skandal, ndaj dhe ka mbyllur çështjen. "Email-et e Nuel Kalajt kompromentojnë tërësisht çështjen. Prokuroria nuk ka dashur të konstatojë se ka dëme. Komisionet e trans-

■ MBYLLJA E HETIMIT

Ish-juristi Kara tha se prokurorja që mbylli hetimin ndaj skandalit CEZ nuk e ka lexuar dosjen prej më shumë se 5 mijë faqesh. Romeo Kara theksoi se prokuroria nuk ka dashur të konstatojë dëmet e mëdha të shkaktuara nga ky skandal, ndaj dhe ka mbyllur çështjen.

parencës janë ngritur në kundërshtim me ligjin. Nuk ka pasur dëshirë as të komunikojë me mua. Konstatoj se një dosje mbi 5 mijë faqe nuk mund të studiohet për dhjetë ditë, më 29 nëntor prokurorja kërkoj pushimin e çështjes. Për mua



Romeo Kara


prokurorja nuk e ka lexuar dosjen, ka marrë një porosi politike nga zyrtarët dhe skutat e errëta të prokurorisë. Nuk mban kush përgjegjësi, populli të marrë përgjegjësitë e veta, unë do jap argumente", tha Kara. Nga ana tjetër, edhe ish-kreu i komisionit


hetimor të skandalit të CEZ, Balla, hodhi akuza të forta ndaj prokurorisë, duke theksuar faktin se si ka mundësi që dosje me akuza të rënda të mbyllet. "Shqiptarët dhe shteti shqiptar kanë humbur rreth 414 mln euro. 5401 faqe, prokurorja që ka mar-

rë përsipër të administrojë çështjen ka marrë vetëm 10 ditë kohë. Rreth 540 faqe në ditë do duhej të lexonte ajo. Kush janë këta prokurorë që guxojnë të mos e marrin fare në konsideratë, por për 10 ditë merr vendime që këtë hetim ta mbyllë? Në dhjetë ditë vendosin të mos bëjnë asnjë hetim. Kush janë këta prokurorë që nuk thirrën njëherë të vetme Nue Kalajn? Si ka mundësi që mbyllet dosje pa fund me akuza të rënda? Këtu na vijnë prokurorë që janë ende një shqetësim, edhe për pak kohë, për mënyrën si duhet të funksionojë sistemi i hetimit dhe ai i drejtësisë. Apo një prokurori e fortë, unë do ju ftoja të gjithëve të njiheni me materialin e sotëm në gjykatë. Bëhet diferencë e madhe se çfarë ka bërë prokuroria", tha Balla.

Bie në pranga 21-vjeçari, kërcënoi fqinjën

KAMEZ - Një 21-vjeçar ka kërcënuar komshien e tij me inicialet S.D., ndërkohë që djali i saj e ka rrahur. Ngjarja ka ndodhur ditën e diel në Babrru të Kamzës. M.G.J. i ka shkuar në shtëpi fqinjës së tij, 42 vjeçe dhe duke e kërcënuar me thikë, i ka kërkuar lekë. Sipas Policisë së Tiranës, i riu dyshohet se është përdorues droge dhe i kërkonte lekët komshies së tij, pa i dhënë ndonjë shkak. Ai mësohet t'i jetë drejtuar asaj, "më jep lekë ose do të të vras". 42-vjeçarja, pasi ka parë thikën, menjëherë ka lajmëruar djalin e saj, M.D., 21 vjeç. Ky i fundit ka marrë edhe dy shokë të tij dhe ka shkuar pranë banesës. Pak metra larg shtëpisë, ai ka parë personin që i kërcënoi nënën me thikë. Të tre e kanë rrahur 21-vjeçarin dhe e kanë futur në bagazhin e një makine "Ford-Focus". Oficerët e Policisë të komisariatit nr.5 i kanë arrestuar të 4 personat.

 bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEITUNG

Implemented by  giz

GIZ-Office Tirana

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development.

GIZ - Office Tirana seeks the following staff: Office Manager

A. Tasks
The Office Manager performs the following tasks:

1. Secretarial Work and Services

- manages incoming and outgoing correspondence
- answers, screens, forwards and/or returns phone calls and messages
- sets up and regularly updates all relevant contacts of the programmes
- maintains the calendar of office deadlines and events
- supports organising administrative and logistical aspects of the Country Office
- prepares and organises internal and working meetings and takes minutes
- provides information for experts and visitors, informs them about the status of their agreements e.g. changes in schedules and other plans, transport services etc.
- arranges accommodation for arriving visitors, short-term and long-term experts
- evaluates hotel prices and negotiates better room rates
- assists short-term experts with logistical problems (e.g. transport services) during their assignment
- ensures guests and experts comfort
- organizes translations of documents

2. Travel costs calculation

- preparation of travel cost claims
- calculation of AMA travel days

B. Required qualifications, competences and experience


- University degree
- At least 3 (three) years of working experience in similar position
- Good working knowledge of ITC technologies (related software, phone, fax, email, the internet) and computer applications (e.g. MS Office)
- Very good knowledge of English and of German
- In-depth understanding of financial planning and accounting
- Customer and service-oriented attitude
- Excellent communication and organisational skills
- Willingness to work in a team
- Willingness to upskill as required by the tasks to be performed

Contract conditions:

- Full-time employment
- Programme office in Tirana
- Assignment period: unlimited contract

Please forward your application until **20th of December 2017**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de, including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references. Only short-listed candidates will be contacted for interviews. They will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

 albpetrol


Aplikim për të përfituar Statusin e Naftëtarit

Njoftohen të gjithë punonjësit dhe ish-punonjësit e shoqërisë Albpetrol sh.a se, bazuar në Ligjin Nr.8/2017 "Për Statusin e Punonjësve të Industrisë së Naftës dhe Gazit" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.425 datë 10.05.2017, se ka filluar shpërndarja e dokumenteve për Statusin e Naftëtarit. Personat e interesuar që të pajisen me dokumentet përkatëse duhet të paraqiten pranë njërit prej qendrave të punës ku kanë punuar dhe të fillojnë procedurën.

Shoqëria Albpetrol sh.a sqaron të gjithë personat e interesuar se disponon dokumentacion për periudhën që kanë punuar në shoqërinë Albpetrol sh.a nga viti 1994 e në vazhdim. Për periudhën përpara vitit 1994, dokumentet mund të merren pranë Sigurimeve Shoqërore ose arkivave të tjera.

Personat që duan të pajisen me vërtetim të posaçëm zyrtar për periudhën përkatëse duhet të plotësojnë formularin përkatës, i cili mund të shkarkohet në adresën www.albpetrol.al/status-i-naftetarit/ ose mund të tërhiqet fizikisht pranë qendrave ku kanë punuar.

Formulari i plotësuar duhet të dorëzohet në qendrat ku keni punuar së bashku me një kopje të librezës të punës ose mund të dërgohet me postë në qendrën përkatëse.

 Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Sella: Rruga Fier-Patos Km. 7 Patos /Tiranë, Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit" Pallati Sky Tower
T +3553813662 F +35534704415 W www.albpetrol.al

Atentati ndaj Aleksandër Ndokës, policia kalon në "sitë" edhe dosjet e vjetra

LEZHË

Vrasja në atentat me breshëri kallashnik ovi e ish-këshilltarit bashkiak të Lezhës, Aleksandër Ndoka ka tronditur familjarët e tij. Djali i viktimës, Samuel Ndoka, i cili dy ditë më parë u lejua të marrë pjesë në varrimin e të atit ka shpërthyer në lot, ndërsa ka përsëritur shpeshherë fjalët: "Çfarë na bëre mor babë!". Ceremonia mortore e vëllait të ish-deputetit socialist, që u ekzekutua në mënyrë mafioze pranë banesës së tij (brenda në makinë) mbrëmjen e së premtes ka qenë jo shumë e zakonit. Sipas "Balkanweb", ndryshe nga sa u përfol në media, në ceremoni kanë qenë të dy djemtë e 48-vjeçarit Aleksandër Ndoka, Samuelli që të dielën mori 4 orë leje dhe Klajdi, ndonëse i shpallur në kërkim nga policia. Mësohet se Samuelli ka mbërritur në shtëpinë e prindërve në lagjen "Nënë Tereza" të Lezhës i shoqëruar nga dy furgonë policie, me 22 efektive të FNSH-së. Policët kanë qenë të armatosur dhe kanë ruajtur në çdo moment të riun, madje ata nuk i janë larguar edhe kur është hedhur mbi trupin e të atit. Ai është parë të qajë me të madhe. Ndërkaq, pohohet se ish-deputeti Arben Ndoka i ka siguruar policët që gjatë ceremonisë s'do ndodhte asgjë me nipin. Pavarësisht kësaj, efektivet kanë bërë detyrën, duke blinduar gjithë ceremoninë dhe duke ndjekur këmba-këmbës Samuelin. "Konsiderojeni veten sikur jeni në shtëpinë tuje. Nuk do ju ndodhë asgjë", - mësohet të këtë thënë deputeti. E pranishme në ceremoni ishte edhe vajza e madhe e Aleksandër Ndokës, Jorida Ndoka. Në varrimin Ndokës morën pjesë qindra persona, mes tyre edhe politikanë të njohur. Pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në qytetin e Lezhës, policia ka shoqëruar dhe ka marrë në pyetje 30 persona.

Varrimi, Samuel Ndoka përcolli të atin i shoqëruar nga 22 efektive të FNSH-së

19-vjeçari shpërtheu në lot: Çfarë na bëre mor babë!



48-vjeçari i vrarë, Aleksandër Ndoka



Samuel Ndoka në ceremoninë e varrimit të të atit

HAKI ÇAKO

Tri ditë pas ekzekutimit të Aleksandër Ndokës, drejtori i Policisë së Shtetit, Haki Çako ka zhvilluar një takim me drejtuesit e policisë së Lezhës. Në fokus të këtij takimi që u zhvillua në orët e mbrëmjes të së hënës ka qenë vrasja e 48-vjeçarit. Mësohet se kreu i Policisë së Shtetit ka kërkuar informacion mbi hetimet që po kryhen për këtë ngjarje, ndërsa ka kërkuar angazhim maksimal për zbardhjen sa më parë të saj.

letë me 7 fishekë, pasi është një emër i njohur për policinë. Samuel Ndoka së bashku me Klajdi Ndokën dhunuan edhe nënkryetarin e qarkut të Lezhës, Agustin Marku, duke e goditur disa herë me grushte dhe shqel-

ma në një lokal në 20.02.2017. Ndërkaq, mësohet se për zbardhjen e vrasjes së Aleksandër Ndokës, policia ka hapur dosjet e vjetra të përplasjeve në qytetin e Lezhës. Mes pistave që po hetohen për ekzekutimin e Ndokës është

edhe një ngjarje e vitit 2007. Bëhet fjalë për ngjarjen e ndodhur më 29 dhjetor të atij viti, ku Gjergj Ndoka është përballur me një makinë tjetër ku udhëtonin Sokol Nikolli dhe Hektor Kola. Personat që ndodheshin në dy automjetet kanë qëlluar me armë dhe shkak të sherrit të asaj kohe dyshohet të ketë qenë një femër. Nga përplasja mes palëve ka mbetur i vrarë Hektor Kola. Në atë kohë policia arrestoi Gjergji Ndokën dhe Xhevahir Ndokën, vëllain e Aleksandër Ndokës. Pavarësisht se u arrestua, Xhevahir Ndoka i shpëtoi drejtësisë. Pista e dytë e hetimit lidhet me detyrat që ka pasur Ale-

ksandër Ndoka në administratën shtetërore. Ndoka ishte këshilltar në Këshillin Bashkiak të Lezhës, ndërsa në vitin 2016 ka punuar si jurist në Këshillin e Qarkut. Nga viti 2013 deri në vitin 2015 ka punuar si jurist në Hipotekën e Lezhës. Së fundmi, rreth dy muaj më parë mësohet se Aleksandër Ndoka ishte emëruar si kryeinspektor i IKMT-së për veriun. Dyshimet janë për një konflikt të ndodhur në periudhën kur ai ka punuar në Hipotekë. 48-vjeçari nuk kishte asnjë problem me ligjin. Ai nuk ka precedentë dhe në formularin e dekriminalizimit rezultoi i pastër.



I shpëton atentatit 29-vjeçari Tërnova, policia: I riu, me rekorde kriminale

BULQIZË - Një 39-vjeçar nga Bulqiza i ka shpëtuar mbrëmë një atentatit me armë zjarri. Sipas burimeve nga policia lokale, ngjarja ndodhi rreth orës 18:30, në fshatin Peladhi. Mësohet se persona të pidentifikuar kanë qëlluar në drejtim të të riut Fadil Tërnova, gjatë kohës që ai ishte në timonin e makinës tip "Land Rover" me targa AA 489 RA. Sulmi në fjalë ndodhi në rrugën që lidh fshatin Godvi me fshatin Peladhi, ndërkohë 29-vjeçari ka arritur që të largohet pa pësuar dëmtime. Ai i ka dhënë gaz automatit dhe është larguar, rreth 500 m nga vendi i ngjarjes. Më pas Tërnova ka lënë automjetin në anë të rrugës dhe ka telefonuar policinë. Po të njëjtat burime thanë se i riu udhëtoi në vetëm në makinë. Të pakten 2 plumba kanë prekur makinën e tij, ndërsa në vendngjarje policia gjeti disa gëzhoja.

Porca të shumta polico-re të mbështetura dhe nga forcat e policisë së Dibërës kanë ngritur pika të shumta kontrolli, me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve. Policia sqaron se ngjarja po hetohet intensivisht, pasi Tërnova është person me rekorde të theksuara kriminale dhe penale.

TIRANË - Historia e një çift bashkëshortësh që po hasen me peripecitë për të regjistruar dy fëmijët e tyre adoleshentë, pasi prej kohësh kanë jetuar në emigrim, është bërë dje pjesë e emisionit "Me zemër të hapur" në "News 24". Nëna e fëmijëve u bëri thirrje autoriteteve shqiptare që t'i regjistrojnë fëmijët, vajzën 15-vjeçare dhe djalin 17-vjeçar. Xhevahirja, e pranishme bashkë me djalin dhe vajzën në studion e emisionit tregoi me detaje se si kishte rrjedhur ngjarja dhe rrugëtimi i tyre në emigrim. "Në Belgjikë ikëm në '99. Por, pas vitit 2002 ikëm prej aty. Ikëm nga Belgjika, pasi neve na humbi jetën vajza në një aksident. Isha me djalë të vogël dhe 7-muajshë shtatzënë, kur mora rrugën për Angli. Rruga ishte shumë e vështirë. Hipa me burrin në maune, paguam 1 mijë marka për person. Burri im e gjeti personin që na çoi, por se di se kush ishte. Rrjetet kanë qenë shqiptare. Ishim

Nga Belgjika me maune në Angli, peripecitë e çiftit shqiptar: Nuk na regjistrojnë fëmijët

vetëm ne në maune, ishim fshehur pas. Udhëtuam rreth 3 orë e gjysmë. Kur arritëm në Birmingham, u dorëzuan në polici. Na çuan në një kamp. Kemi ndenjur dy muaj aty, deri sa lindi vajza. Më pas jemi transferuar në një qytet tjetër dhe pas 2 vitesh e gjysmë na rikthyen dhe na çuan në Prishtinë. Meduam të paraqiteshim si kosovarë, sepse kishte më shumë lehtësira. Ato vite ishim shumë mirë në Angli. Kur u rikthyem, djali ishte 5 vjeç dhe vajza 2 vjeçe e gjysmë. E regjistrua djalin se vendi ku jetonim ishte fshat i vogël dhe njëheshim të gjithë, ndërsa problemi nisi kur ndërruam shkollën e tij sërish", tha Xhevahirja.

Po ashtu, ajo rrëfëu edhe një ngjarje të rëndë gjatë kohës që jetonte në Belgjikë se i kishte humbur jetën vajza 1



vjeçe gjatë një aksidenti. "Një aksident ma mori vajzën. Më ra nga dritarja. Ishte duke luajtur dhe krejt papritur vajza ra, sepse dritaret në Belgjikë janë ndryshe. Ajo po luante me fëmijët e kumatës sime. Trupin e saj e kemi sjellë këtu. Na e ka sjellë shteti belg. Tashmë jemi në këtë situatë. Kemi vuajtur shumë në jetë", pohoi ajo.

HISTORIA E ÇIFTIT
Xhevahirja dhe Agimi u martuan me mblesëri në '97-

ën dhe bënë celebrimin në '99. Xhevahirja jetonte në Laç, ndërsa Agimi në Malësi të Madhe. Në 6 dhjetor të '99-ës të dy u larguan në Belgjikë, pasi edhe bashkëshortarët të tyre ishin larguar drejt atij shteti dhe ua sugjerimin si një vend më të mirë. Deri në qershor të vitit 2002, ata qëndruan atje, ku lindi edhe djali i tyre Doriani. Duke qenë se kishin ikur ilegalisht, ata ishin regjistruar si kosovarë dhe jo me identitetin e tyre dhe tashmë nuk kanë dokumente për djalin. Pasi jetuan prej disa kohësh me asistencë sociale në Belgjikë, ata ikën për në Angli në vitin 2002 dhe u vendosën në Birmingham. Ndonëse dhanë identitet të ndryshëm nga ai i Belgjikës, sërish në Angli u paraqitën si shtetas kosovarë. Ata qëndruan deri në

2005-ën. Vajza e tyre, Elidona lindi në gusht të 2002-it. Aty qëndruan 2 vite e gjysmë, mbaroi procedura e azilit dhe më pas ju refuzua qëndrimi, u kthyen mbrapsht. Nga viti 2005 e deri tani, ata banojnë e jetojnë në fshatin Drogovojë të Koplikut. Çifti është i interesuar në gjendjen civile të Koplikut, por fëmijët nuk janë regjistruar për shkak të mungesës së dokumentacionit. Familja ka shkuar në gjykatën e Shkodrës të hapte gjyq, por aty u thanë që duhet të shkosh të gjeshe dokumentacionin, kap një avokat jashtë që të plotësoh dokumentet e domosdoshme. Fëmijët janë pranuar në shkollë me miqësi në fshat, por tani që janë në gjimnaz nuk marrin dot certifikatat as dëftesa e as diploma.

Policia arrestoi në flagrancë drejtuesin e mjetit, Hajri Cako

Sherr për pagesën e porosisë, shoferi i autobusit i këput veshin beratasit

53-vjeçari i kërkoi 2000 lekë të vjetra të dëmtuarit

ARBËR SULO

SARANDË

Një ngjarje e paza kontë ka ndodhur mbrëmjen e së dielës në qytetin e Sarandës. Shoferi i autobusit, Hajri Cako i ka kafshuar dhe këputur veshin një shtetasi nga Berati. Ngjarja e rëndë me protagonist 53-vjeçarin që ka përfunduar në pranga ka marrë shkas pas një konflikti të çastit me beratasin, i cili priste një porosi. Burime nga policia lokale bënë me dije se rreth orës 19:00, autobusi që drejtohej nga Cako ka mbërritur në qytetin bregdetar, ndërsa pranë tij është afruar shtetasi Apostol Sinani nga Berati. Ky i fundit priste një porosi, të cilën e kishte marrë drejtuesi i autobusit, Hajri Cako. Teksa 53-vjeçari i ka dhënë porosinë, ka kërkuar gjithashtu edhe shpërblimin prej 200 lekësh të reja, të cilat Sinani ka refuzuar t'ia japë. Kaq ka mjaftuar që të plasë sherri.



Policia e Sarandës

KONFLIKTI

Rreth orës 19:00, autobusi që drejtohej nga Cako ka mbërritur në qytetin bregdetar, ndërsa pranë tij është afruar shtetasi Apostol Sinani nga Berati. Ky i fundit priste një porosi, të cilën e kishte marrë drejtuesi i autobusit, Hajri Cako. Teksa 53-vjeçari i ka dhënë porosinë, ka kërkuar gjithashtu edhe shpërblimin prej 200 lekësh të reja, të cilat Sinani ka refuzuar t'ia japë. Kaq ka mjaftuar që të plasë sherri.

si i autobusit, Hajri Cako. Teksa 53-vjeçari i ka dhënë porosinë, ka kërkuar gjithashtu edhe shpërblimin prej 200 lekësh të reja, të cilat Sinani ka refuzuar t'ia japë.

Kaq ka mjaftuar që të plasë sherri tek agjencia e autobusëve të qytetit të Sarandës (në lagjen nr.1). Mësohet se në grindje e sipër shoferi Cako ka kafshuar në vesh Apostol Sinanin, duke i këputur pjesën e sipërme. Dëshmitarë në vendin e ngjarjes e kanë transportuar Apostol Sinanin drejt spitalit të Sarandës, ku ka marrë ndihmën e parë mjekësore. Bluzat e bardha të këtij spitali pohuan se i plagosuri është në gjendje të rëndë. Ndërkaq, policia ka shkuar menjëherë në vendngjarje dhe ka arrestuar në flagrancë shoferin 53-vjeçar Hajri Cako. Materialet në ngarkim të agresorit i janë përcjellë për hetime të mëtejshme prokurorisë së këtij rrethi për veprën penale: "Plagosje e rëndë me dashje". Pritet që gjykata e Sarandës të vendosë masën e sigurisë ndaj 53-vjeçarit.



26-vjeçari Ilija Dhimitri

Ra 200 metra në humnerë

Adhuronte lartësitë, vdes në Olimp shqiptari 26-vjeçar

GREQI - Ilija Dhimitri nga Korça, i cili ishte i apasionuar pas alpinizmit ka humbur jetën tragjikisht teksa ngjiste malin e Olimp të Greqi. Udhëtimi që 26-vjeçari kishte organizuar me mikun e tij ka qenë fatal. Mësohet se i riu gjeti vdekjen, pasi u rrëzua nga një lartësi prej 200 metrash në greminë, ndërsa miku i tij mbeti i lënduar. Mediat e vendit fqinj bënë me dije se shqiptari Ilija Dhimitri, 26 vjeç, ishte bashkë me një shok të tij grek, kur këtij të fundit i kishte rrëshqitur këmba dhe kishte humbur kontrollin duke rënë në greminë. Duke dashur t'i vijë në ndihmë shokut të tij në atë situatë të vështirë, ata kanë rrëshqitur të dy në dëborën e ngrirë. Nga kjo rrëshqitje fatale shqiptari ka rënë 200 metra më poshtë, duke gjetur edhe vdekjen. Bashkudhëtari i tij arriti të mbahet në një pemë, ndërsa fatkeqësisht Ilija u rrëzua. Babai i djalit që arriti të mbijetojë ka thënë për gazetën greke "Protothema", se me gjithë përpjekjet e të birit për ta shpëtuar, nuk mundi. "Djali im zbriti, shkoj tek miku i tij, i lidhi kokën dhe e mbajtë atë në duar derisa arritën shpëtuesit. Por për fat të keq, ai kishte ndërruar jetë". Gjithashtu, gazeta greke shkruan se 26-vjeçari kishte ëndërr të udhëtonte në botë dhe të pushtonte sa më shumë maja të larta, por ëndërra u pre në mes pikërisht në malin ku sipas gojëdhënave jetojnë perënditë.

Bëjini të gjithë të lumtur

Kredi Personale

Këto festa dhuroni pa fund me kredinë personale

Raiffeisen BANK

www.raiffeisen.al



SABRI LAÇI

U BËNË PËRPEKJE PËR MANIPULIM TË PROCESIT

"Mund të them se procesi i votimit për dekanin e Fakultetit të Histori-Filologjisë ishte një proces i vështirë e me probleme të panevojshme. U bënë përpjekje për manipulim, për trynisi ndaj stafit dhe vetë studentëve. Gjatë këtij procesi pati shkelje të herëpashershme të rregullores. Vlen të theksojmë një tjetër shkelje të rëndë, që ishte mosdhënia në mënyrë të qëllimshme e fletës së saktë të votimit njërit prej zgjedhësve, me synim deformimin e rezultati përfundimtar të votimeve. Dhe u insistua fort që kjo fletë votimi të konsiderohej e pavlefshme", - u shpreh Sabri Laçi për "GSH".



ALJULA JUBANI

"PRESION NDAJ STUDENTËVE E PEDAGOGËVE"

"Komisioni Zgjedhor i Fakultetit nuk shpall fitues, por shpall rezultate. Sipas rregullores, fituesi shpallet me një votë më shumë, por 0.14% nuk përbën një votë. Këto parregullsi kanë filluar që në fushatën zgjedhore e janë pasuar edhe në ditën e votimit. Ka pasur një imponim ndaj studentëve dhe presion nga pedagogët. Këtë shkelje unë i kam përcjellë në Komisionin Zgjedhor Institucional dhe të presim që gjërat do të sqarohen. Unë mendoj që duhet të respektojmë procesin, të përfundojë dhe pastaj të mund të themi se si janë të gjitha detajet", - tha Jubani për "GSH".

Rezultati i ngushtë, KIZ e dërgon në MASR për interpretim, pritet përgjigja zyrtare

Zgjedhjet te Histori-Filologjia në "gryq", ende pa dekan fitues

Majlinda Keta: Konstatuam parregullsi gjatë procesit

Voltiza Duro

Ende nuk ka një fitues zyrtar për pozicionin e dekanit në Fakultetin e Histori-Filologjisë, pas zgjedhjeve të zhvilluara 5 ditë më parë. Rezultati mes kandidatëve ka qenë i ngushtë dhe nxirrte para prof. Sabri Laçin kundrejt Aljula Jubanit me vetëm 0.14% më shumë vota. Pas kësaj, Komisioni Institucional Zgjedhor vendosi që të dërgojë për verifikim drejt Ministrisë së Arsimit këtë rezultat, duke mos shpallur një fitues zyrtar. Ndërkaq, MASR do të interpretojë nëse 0.14% mund të konsiderohet si një votë më shumë, duke e vendosur Laçin zyrtarisht në krye të FHF, apo mund të vendosë që rezultati i këtyre zgjedhjeve është një balotazh pa fitues. Procesi zgjedhor për postin e dekanit në këtë fakultet është shoqëruar me parregullsi e kontestime të shumta nga të dy kandidatët. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", kryetarja e Komisionit Institucional Zgjedhor, Majlinda Keta, bën me dije se zgjedhjet nuk janë realizuar në kushte normale dhe janë shoqëruar me parregullsi. Më tej, ajo bën me dije se administrata dhe autoriteti i këtij fakulteti nuk kanë përbushur detyrimet e përcaktuara gjatë këtij procesi. Keta thekson se ka ardhur koha që zgjedhjet në universitete të paraprihen nga një kodifikim maksimal ligjor dhe etik.

Pas zhvillimit të zgjedhjeve për dekanin e Histori-Filologjisë ka pasur kontestime nga të dy kandidatët për tentativa për manipulim. A kanë ardhur ankesa drejt KIZ?

Ka një KIZ që brenda afateve ligjore të rregullores së ministres ka prituri ankësat dhe i ka dhënë përgjigje. Në asnjërin prej tyre nuk ka pretendime për manipulime, por për parregullsi.

Ku janë konstatuar



Kryetarja e Komisionit Institucional Zgjedhor, Majlinda Keta

Shkeljet janë kryesisht mospërbushje e detyrimeve që administrata dhe autoriteti i FHF nuk ka përbushur për dokumentacionin zgjedhor apo kushte normale të ditës së zgjedhjeve.

këto parregullsi?

Edhe si kryetare e KIZ, por edhe nga raporti i dalë nga KZF e fakultetit (kërkuar nga ne për shqetësimet e deklaruara nga konkurrentët) vërtetohen parregullsi në proces-

in zgjedhor. Shkeljet janë kryesisht mospërbushje e detyrimeve që administrata dhe autoriteti i FHF nuk ka përbushur për dokumentacionin zgjedhor apo kushte normale të ditës së zgjedhjeve. Një tjetër shkelje është konstatuar edhe në zbatimin e detyrimeve që vendimi i KIZ i jepte kur ndërpremi në orën 2.30 të mëngjesit daljen e rezultati si pasojë e një situatë të tensionuar mes individëve që nuk ishin të akredituar nga KIZ me anëtarët e KZF që po punonin për rezultatin.

A u ofruan kushte sigurie për Komisionin Zgjedhor të Fakultetit gjatë procesit të zgjedhjeve?

Administrata dhe autoriteti drejtues në Fakultetin e Histori-Filologjisë nuk i krijuan kushte sigurie dhe normaliteti punës së KZF. Këtë e kanë raportuar edhe anëtarët e KIZ të stazhuar në ditën e zgjedhjeve në atë fakultet.

Kur do të shpallet rezultati final mbi fituesin e zgjedhjeve për postin e

dhe nga një proces model i siguruar nga KZF, dekanit dhe administrata atje. Gjithashtu, kemi edhe një përgjegjës departamenti të Gjuhës Shqipe tek Fakulteti i Histori-Filologjisë, të ardhur me një proces me standarde.

Çfarë duhet të përmirësohet në procesin zgjedhor në universitete?

Ka ardhur koha që zgjedhjet në universitete të paraprihen nga një kodifikim maksimal ligjor dhe etik. Së pari, të respektohet maksimalisht parimi i konfliktit të interesit për të gjithë ato që vullnetarisht aplikojnë të jenë anëtarë të KZF, QV dhe KIZ. Së dyti, ato që vendosin të kandidojnë të zotërojnë ligjin e Arsimit të Lartë, rregulloren e zgjedhjeve me anë të cilave të vetëkodifikohen ligjërisht për atë që kërkojnë e shprehin ndaj

votuesve dhe strukturave të menaxhimit të zgjedhjeve. Së treti, kandidatët konkurrentë kur janë autoritete drejtuese në periudhën zgjedhore të limitohen nga vendimmarrje pushteti, që bien nënsh me mundësinë e një vote të lirë.

Çfarë do të sillte ky limitim ndaj kandidatëve?

Ky limitim do të përjashtonte korruptimin e votës akademike dhe studentore dhe do të mundësonte që procesi zgjedhor të ishte standarde ligjore dhe etike. Kjo, edhe larg komunikimeve verbale dhe joverbale, institucionale dhe publike, në shkelje të rregullores së zgjedhjeve, pasi janë nën përgjegjësi të integritetit të Universitetit Publik, nën përgjegjësi të të qenurit akademik dhe edukator i demokracisë për brezat e rinj.

dekanit?

Rezultati do të dalë në afatin kohor. Sot, ligjërisht në 4 fakultete të tjera ka përgjegjës departamentesh të dala nga këto zgjedhje



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje dhe implementim i disa pajisjeve servera dhe shasi për nevojat e Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 44,000,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje dhe implementim i disa pajisjeve servera dhe shasi për nevojat e Bankës së Shqipërisë".

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **08 Janar 2018, ora 11.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Deputeti i LSI-së, Shezai Rrokaj: Kjo është një çështje morali shtetëror, të mendojmë për fëmijët tanë

MASR: Tekste falas për 240 mijë nxënës të fillores

Albana Vokshi: Projekti të shtrihet deri në klasat e IX

Voltiza Duro

Bazuar në vendimin e Ministrisë së Arsimit, plot 240 mijë nxënës të arsimit fillor në vend do të përfitojnë tekste shkollore falas për vitin e ardhshëm mësimor 2018-2019. Për ta vënë në jetë këtë nismë, qeverisë do i duhen rreth 5 mil-

ionë euro, në një kohë që MASR parashikon disa ndryshime në ligjin parauniversitar në lidhje me këtë. Por nuk kanë munguar kontestimet nga radhët e PD që kërkojnë teste falas për të gjithë nxënësit nga klasa e parë deri në të nëntën, ashtu siç e kishin parashikuar në amendamentin e tyre të dorëzuar në Kuvend disa kohë më parë. "Llogarimisht 180 mijë familje, ku secila familje shqiptare ka 2-3 fëmijë. Mendoj se më



shumë se 500 mijë fëmijë në vend të mund të sigurojnë librat dhe tekstet shkollore. Mundëson pra, një produkt pozitiv në arsimin parauniversitar, duke i ardhur në ndihmë familjeve shqiptare në një moment shumë të vështirë ekonomik në të cilin ndodhet vendi", - u shpreh Albana Vokshi, deputete e PD. Më tej, edhe Shezai Rrokaj, deputet i Lëvizjes Socialiste për Integrim theksoi se dhënia e librave falas është një detyrim moral ndaj fëmijëve. "Ne duhet të dalim kryelartë si grup, të gjithë bashkë, pa dallim PS, PD

apo LSI. Këta janë fëmijët tanë dhe kjo është një çështje morali dhe detyrimi. Është një çështje ligjore, pra ose do jemi me ligjin që e ka përcaktuar vetë PS dhe kemi qenë dhe ne bashkë me strategjinë, ose ne të themi që do bëjmë "sikur". Unë nuk kam marrë mandatin për të bërë "sikur" këtu,"-u shpreh Rrokaj. Gjithashtu, LSI kërkoj nga Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë, një raport të plotë e të detajuar për gjendjen e shkollave pas përmbytjeve që përfshinë vendin disa ditë më parë, madje kërkuan që të lidheshin nego-

TEKSTET FALAS

ciata me shtëpitë botuese për të siguruar libra falas për nxënësit që humbën tekstet mësimore.

teksteve falas për nxënësit nga klasa e 1 deri në të 4-të si dhe për kategoritë e veçanta. Por klasat e 5-ta janë lënë jashtë këtij projekti pasi sipas MASR po bëhet ndryshimi i kurrikulave. Ky vendim i Ministrisë së Arsimit mbi tekstet falas, shkaktoi debate të shumta nga radhët e PD-së që e konsideruan këtë program të prezantuar nga ministria e MASR si një plagjiaturë.



Albana Vokshi, deputete e PD



Shezai Rrokaj, deputet i Lëvizjes Socialiste për Integrim

PUNËSOHET PRANË OSHEE I BIRI I ELEKTRICISTIT QË HUMBI JETËN NË DETYRË

OSHEE ka punësuar të birin e Sabri Vlingës nga Roskoveci, i cili humbi jetën në krye të detyrës disa ditë më parë. Drejtori i këtij institucioni, Armand Xhuka, i ka dorëzuar Xhelal Vlingës, djalinjtë të ndjerit, një uniformë të vendit të punës dhe i ka uruar punë të mbarë, duke mbajtur premtimin për punësimin e tij pas humbjes së të atit. "Kishe një baba të palodhur dhe i kudondodhur, bëhu si ai", -tha Xhuka, duke theksuar se po ndiqen procedurat ligjore edhe për të ndihmuar familjen për një pension familjar. Tashmë, Xhelal Vlinga, i biri i viktimës u emërua si specialist pranë klientit në OSHEE e Roskovecit, pikërisht aty ku punonte i ati i tij.



FOTOLAJM

Veliaj: Ftoj qytetarët të bashkohen

Mbillen 870 fidanë të tjerë në pyllin orbital

Parkut të liqenit të Farkës i janë shtuar edhe 870 fidanë pisha, si pjesë e projektit të pyllit orbital. Kryebashkiaku, Erion Veliaj, falënderoi të gjithë ata që kontribuan për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në kryeqytet, duke ndihmuar për një jetë të shëndetshme edhe për brezat e ardhshëm. Synimi i Bashkisë së Tiranës është që deri në përfundim të sezonit të mbjelljes së pemëve të reja, kryeqytetit t'i shtohen në total 100 mijë pemë. "Jam 870 herë mirënjohës për secilin prej pemëve që është mbjellë këtu sot. Thirrja që kemi bërë për të mbjellë një numër pemësh për çdo makinë të përdorur; ka marrë përgjigjen e duhur", - u shpreh Veliaj. Më tej, ai ftoi qytetarët që t'i bashkohen këtij koalicioni. "Besoj që në këtë stinë të festave, ku të gjithë duan një dhuratë, edhe Tirana ka personalitet dhe do një dhuratë. Dhuratat më e mirë që mund t'i japim sot Tiranës për festa janë 870 pemë, nesër më shumë të tjera, dhe të vazhdojmë me këtë ritëm. Siç po ecim çdo ditë, do kapim rekordin tonë të 100 mijë pemëve në këtë stinë mbjelljesh", - shtoi kryebashkiaku.



PROFIL

"I kam ndjekur me admirim të shtatë rolet e saj në teatrot e shumta të rrugicave të Athinës e deri në teatrot e mëdha të kryeqytetit dhe kam parë i ngazëllyer që publiku grek e ka duartrokatur"

Nga Miho Gjini

Marsela Lena

Kur artistët shqiptarë shkëlqejnë në skenën greke

Rolet e aktores në Athinë, në Teatrin Kombëtar të shtetit fqinj

Në tablonë e trishtuar të artistëve shqiptarë që sot shkëlqejnë në skenat e botës, është edhe aktorja jonë Marsela Lena, që sjell krenari me talentin dhe performancën e saj përpara një publiku të huaj. U mësuam tashmë me këtë realitet paksa të hidhur, duke u mburrur vetëm me faktin se janë pikërisht artistët tanë që kanë vajtur në Europë më përpara se të vejë shteti i tyre, bile më përtej kontinentit të vjetër, deri në atë më të largët e më të lakmueshmin që ka bota!

Një prej tyre është edhe aktorja Marsela Lena, e cila u përgatit në shkollën e skenës shqiptare, që shkoj në Greqi pas të shumtëve, bashkë me familjen, duke u shkolluar edhe aty e paralelisht, pa e harruar pasionin për skenën, derisa të evidentohet rishtazi. Dhe e rëmben menjëherë Teatri Kombëtar i shtetit fqinj për aftësitë e potencialin e vet artistik, si edhe për tingëllimin e pastër të gjuhës të fqinjëve shekullor, me të cilët e gjejmë dhe nuk e gjejmë dot gjuhën e përbashkët!

I kam ndjekur me admirim të shtatë rolet e saj në teatrot e shumta të rrugicave të Athinës e deri në teatrot e mëdha të kryeqytetit dhe kam parë i ngazëllyer që publiku grek e ka duartrokatur dhe është ngritur në këmbë me veneratione e me brohoritma përpara talentit sugjektiv të Marsela Lenës nga "guri i thatë" i Leskovikut. Dhe ata, e quajnë tani "të tyren" Marselën, studenten e Birçe Hasokos, i cili 40 e ca vite të shkuara që studentit im në shkollën e lartë shqiptare të aktrimit.

Ja që ndodh edhe kështu! Së fundmi, s'ka pak mbremje që ajo më ftoi të shikoj rolin e saj të ri në Teatrin "Diana", që ndodhet në zemrën e Athinës, në afërsi të sheshit të Kushtetutës (Sintagma), ku ngrihet edhe parlamenti grek, i ndërtuar nga Zhapajt e Lunxhërisë, pak më tej parkut të tyre të madhërisëm (Zapjo). Dhe këtu do të shkëlqejë me një rol jo protagonist (!), me personazhin e shërbëtores Luçie, në dramën-satirë të Eduardo de Filipos "Filomena Marturano". Marsela evidentohet këtu midis një trupe aktorësh me përvojë të madhe, e barabartë me ta, por në fundin e spektaklit, kur ajo doli në avanskenë për të përshëndetur publikun, do të fitonte zjarren e duartrokitjeve (!), pa e ditur askush në sallë se aktorja në fjalë ishte shqiptarja Marsela Lena, një vajzë e thjeshtë, me tipare tepër të zakonshme, e cila as që ta mbush syrin e mendjen për aktore e të të tërheq vëmendjen!

Çfarë po ndodh kështu?! Përpos të vërtetës së madhe se, atë që nuk e bëjnë dot menjëherë politikanët e diplomatët, e arrijnë artistët me talentin e tyre të padis-kutueshëm. Krijohet kështu ajo që quhet "ura shpirtërore" dhe që ka të bëjë me logjikën e gjërave e me rëmbimin e zemrave. Si dukur fenomeni Aleksandër Moisi, që i



Në foto: Aktorja, Marsela Lena

bëri italianët ta quajnë "të tyre", gjermanët e rusët po ashtu, kur një mbret si ai i yni, në shkëmbim të shtetësisë që kërkoi shqiptari e aktori më i madh i botës, s'kishte çfarë t'i ofronte veç ceremonialistit e oborrit! Po ja se si vjen edhe paradoksi i radhës: regjisori i famshëm grek Niko Mastoraki, i njohur si i tillë në skenat e Europës, i thotë atit të Marsela Lenës këshut: "Bija juaj, këndej e tutje do të jetë edhe bija ime!". Regjisori tjetër grek Stamatis Fasulis vëren me kënaqësi se si Marsela e krijon rolin e vet me lehtësi, duke ndërtuar një figure artistike që "kërret" mbi ansamblin e aktorëve të tjerë, për nga transparenca e magjishme

e aktrimit. Gjithashtu, interpretesja e rolit të Filomenës, Eleni Randu, e cila sot në Greqi ka pushuar serialin më të gjatë televiziv të vendit të vet, njëherësh edhe pronare e teatrit "Diana", e quan si një privilegj që e ka thirrur në teatrin e vet Marselën tonë dhe që interpreton përbri saj.

Po ku qëndron vlera, forca interpretuese dhe rrezatimi i performancës së aktores Marsela Lena? Mendoj se ajo është një nga ato artiste që di të krijojë edhe nga hiçi, edhe nga një rol i heshtur e pa fjalë, edhe nga një personazh episodik e kalimtar, sikundër di të realizojë edhe rolin e madh. Në spektaklin e mëparshëm "Të huajt",

ajo interpreton dy role në të njëjtën shfaqje, që ishin krejt të kundërt me njëri-tjetrin. Këtu, tek "Filomena Marturano" interpretoi përsëri dy role, që ishin, po ashtu, dy karaktere krejt të kundërt: shërbëtoresh Luçie dhe prostitutën pa emër, që ishte një krijim regjisorial. Realisht, edhe Luçia nuk zë shumë vend në veprën e Eduardo de Filipos dhe shfaqet në sheshin skenik sa herë që e thërresin të zotët e shtëpisë për të kryer ndonjë punë. Po ama është prezente tek një banesë e kamur, tek një zotëri të pasur napolitan si Domenico, hokatar e kurvar i "orës së parë", që mbetet më së shumti nëpër bordelot e vendit të tij të pasluftës, i cili ndërkohë do të dashurohet me putanën kryesore, me Filomenën dhe që më pastaj do të bëhet edhe bashkëshorte e tij!

Po detyra jonë, ajo e kritikut, nuk është që të merremi me subjektin e kësaj vepre tepër të njohur të Eduardo de Filipos, e cila sfidon aq bukur, me mjeshtëri të rrallë, prostitucionin në vendin e tij, po edhe kurvërimin e njerëzve të ligjit e atyre të kishës, po të ndalem i tek aktorja Marsela, që loz një shërbëtoresh të mençur, hokatare e fort të zhdërvjellët, gati të huajtur nga "Comedia del Arte" e teatrit të rrugës, së Rilindjes Italiane. Luçia e Marselës, aq e ngjashme me Pulçinelën, është figura tipike e shërbëtoresh gazmore të kësaj plejade, sikundër ishte Arlekini, Kolumbina dhe të gjithë person-



azhet e vulgut në veprat e Shekspir, me gaztorët e lolot e pafund, apo te Molieri frëng e Goldoni italian, për të ardhur deri tek De Filipos e Dario Fo. Nuk është puna që Luçia-Lena shfaqet këtu e plotë si personazh karakteri, me tiparet e një shërbëtoresh të varfër, që s'ia ha "qeni shkopin", po ajo do t'i veshë asaj edhe tiparet e gruas revolucionare, e cila sjell këtu revoltën e rrugës, të miletit, duke i sfiduar këta njerëz që s'dinë si ta "prishin paranë". Marsela, me një portret komik e plastikë tepër të zhdërvjellët, rrëshqet nëpër skenë, herë duke kënduar "bandjera rosa", herë duke i tallur me radhë bukëshkalurit, herë duke kërcyer tarantelën si një napolitane e thekur.

Ja se si do të dalësh nga një shfaqje, sikundër i themi ne: "i ngopur", në një dramë-satirë, prej një interpretimi fort të pasur, që denoncon artistikisht, ashpër e me lezet, borgjezinë e re, që regia e Fasulis e afron me realitetin bashkëkohës dhe publiku nuk do të ndjente më se është në teatër (fal edhe një skenografie të shkëlqyer, në funksion të veprimit të pandërrerë të aktores interpretues), po në rrugën e madhe të jetës reale, në krijimin e radhës të aktores tonë Marsela Lena, e cila do të na lerë në fytyrë edhe gurmët e lotëve, pas atyre të qeshurave që na dhanë me bollëk përmes skenës së Teatrit "Diana".

E megjithatë se ç'kemi një ndje-si të hidhur që edhe kjo artiste e talentuar, ka ikur nga Shqipëria, për ta zhvilluar me tej ëndërrën e saj krijuese. Në bisedat që bëhen zakonisht pas shfaqjeve nuk kam mundur të mos ia them Marselës tonë se këto performanca dinjitoze në vendin fqinjë, i takojnë së pari përgatitjeve në shkollën e aktrimit e të interpretimeve në skenën shqiptare. Ajo përlohet dhe më thotë, jo pa i dhembur shpirti se, nuk është kaq e lehtë të jetosh, të kërkosh veten tënde e të debutosh në skenën greke, kur nuk njihja askënd. Me teatrin shqiptar kam kujtimet e mia, role të rëndësishme dhe vlerësimet e ngrohta që më janë bërë, çmime të para →

NIS RESTAURIMI I SHKOLLËS KU DHA MËSIM MIGJENI NË PUKË

Në Pukë nis puna për hartimin e projektit të restaurimit të shkollës ku dha mësim poeti revolucionar Millosh Gjergj Nikolla - Migjeni. Specialistët e Institutit të Monumenteve të Kulturës kanë udhëtuar drejt shkollës muze të qytetit të Pukës, në vendin ku Migjeni jeton sot nëpërmjet fotove, kujtimeve dhe veprave të tij, Fatmira Nikolli says: të cilat qëndrojnë të ekspozuara në ambientet e shkollës. Restaurimi i elementëve karakteristikë të objektit si dhe rikonceptimi i ambientit të brendshëm në shërbim të ekspozimit të objekteve, do të mund të rikthejnë vëmendjen e vizitorëve ndaj këtij objekti muzeal, me vlera të veçanta.



FOTOLAJM

QEVERIA SHPALL THETHIN QENDËR HISTORIKE, MBROHEN "KULLA E NGUJIMIT" E MUZEU



← nëpër festivale dhe një çmim të parë nga revista KULT, në një kohë me Robert Ndrenikën e madh. Por më tej, e ndjeva veten si në një cikël të mbyllur. Më duhej të prisja gjatë, pranë një teatri qendror që kishte vetëm 36 vende pune e më duhej të "vrisja kohën" nëpër stolat e kafenetë e pedonale, bashkë me dhjetëra aktorë të pashpresë që prisnin t'u vijë radha të dilnin në skenë në ato dy-tre teatro që ka kryeqyteti ynë i dashur! Apo që të duronim sa të vinte ndonjë regjisor i huaj, të kujtohej ndonjë kompani private që duken fort rrallë, a të behej papritur ndonjë film, që dukeshin sikur binin nga qielli! Dhe ëndrra ime nuk e kalonte cakun e ëndrrës. Nga të përplasat i gjori aktor, kur edhe shkolla e lartë e aktrimit, nxjerr pa reshtur mijëra të tillë, pa asnjë studim në perspektivë! Edhe ato shfaqje të bukura që bëhen i mbyll sipari i një planifikimi po kaq absurd, që s'di se kush e ka vendosur! Nuk mund të pranohet ky realitet tepër i ngushtë, kur edhe në ato pak shfaqje teatrore që bëhen jepen shpesh të njëjtat shfaqje, ku edhe ata dy-tre kritikë profesionist që kemi ne, as që i ftojnë e as i paguajnë, edhe pse e dinë, që pa kritikë nuk mundet të mendohet një teatër serioz, duke bërë vazhdimisht shfaqje e duke i lënduar ato nëpër gazeta po ata administratorë teatros që i realizojnë! A nuk është mjerim?! Prandaj, i dashur profesor, vazhdon të më shohësh ende këtu në Greqi, ku edhe pse kaloi një krizë të thellë, teatrot e saj nuk i mbylli. Ato mbijetuan e gëlojnë më qindra, edhe nëpër rrugicat e pafundme, pranë njerëzve që e duan këtë institucion human, që nga lashësia e njerëzimit. Kështu që më duhej të ikja e të hapja këtu një cikël të ri për krijimtarinë time, për ëndrrat e mia të ndërpreura, po pa ia ndërprerë vetes edhe ëndrrën e rikthimit në vendin tim.

Dhe paskëta, Marselës nuk i duhet më që të presë e as të vrapojë më për të gjetur teatrin e rolin e saj të ri, por u takojnë regjisorëve ta kërkojnë Marselën tonë e t'i luten që ajo të interpretojë në teatrot e tyre e ta quajnë edhe artistin "e tyre"! Kaq...

Në mbledhjen e fundit, të zhvilluar në Shkodër, qeveria ka miratuar shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Theth, vendim ky i marrë pasi Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me IMK-në, pas një pune të gjatë për vlerësimin e pasurive kulturore dhe qendrave të rëndësishme të trashëgimisë në të gjithë Shqipërinë, vendosi në muajin prill 2017 t'i japë Thethit statusin e Qendrës së mbrojtur Historike, fshatit me bukuri të rrallë në mes të Alpeve në veri të Shqipërisë.

Qendra Historike e fshatit Theth që propozohet, është pjesa me vlera urbanistiko-arkitektonike e fshatit dhe hapësira që mbart vlera të rëndësishme historike, që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të fshatit drejt krijimit të një qendre të banuar dhe tiparet urbanistiko-arkitekturore që u formuan gjatë historisë së tij. Pjesa dërrmuese e fshatit ruan ndërtime të vjetra me vlera arkitektonike e konstruktive dhe rrjetin rrugor karakteristik. Këto ndërtime janë të lidhura me mjedisin tradicional, i cili është pjesë e Qendrës Historike. Brenda kësaj Qendre përfshihen objekte monument kulture të kategorisë së parë si Banesa e Lulash Keci (Muzeu



Etnografik i Dukagjinit), Kulla e Nikoll Zef Koçekut (Kulla e Ngujimit), etj.

Krahas këtyre ndërtimeve, në këtë zonë janë ndërtuar banesa që, ndonëse nuk kanë numër të madh ambientesh, dallohen nga përpunimi mjaft më i pasur arkitektonik. Këto ndërtime janë më të vonshme dhe të përhapura në zona të kufizuara, si



në Theth të Dukagjinit e Vermosh të Kelmendit. Ato kanë të përbashkët trajtimin arkitektonik të ngjas-

hëm. Karakteristike për këtë trajtim janë çatitë mjaft të pjerrëta, të mbuluara me funde dërrase, të cilat duke mos mbajtur dëborë, lehtësojnë mjaft punën e konstruktorit. Pasuria dhe përpunimi i elementëve arkitektonikë, futja e elementeve të drurit krahas muraturës së gurtë, e gjallërojnë shumë pamjen e banesës, ndërsa çatitë e pjerrëta harmonizohen me ambientin e thepisur shkëmbor dhe duken sikur përsëritin konturet e majave të maleve, që përbëjnë sfondin natyror të banesave.

Thethi është vendbanim shumë i hershëm, duke u bazuar në të dhënat historike dhe zbulimet arkeologjike. Këtu kanë banuar Oksetët, Bythosët, Berbatit, Vladët, Kelmendas e ndoshta edhe grupe të tjera popullsi të pa njohura. Thethi për herë të parë shfaqet i dokumentuar në Deftërin e regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës, në vitin 1485, me emrin Fusha dhe në atë kohë kishte vetëm 7 shtëpi të mëdha.

Në vitin 1976, Thethi shpallet "Park Kombëtar". Pasuritë natyrore të kësaj zone janë të lidhura së bashku edhe me trashëgiminë kulturore dhe historike të banorëve vendas, duke formuar kështu, bazat më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit.

EKSPOZITA

ARDIAN ISUFI, "LULE" PËR BRISHTËSINË E FORCËN

"Flower Powr", ekspozita e sa poçelur e Ardian Isufit, trajton tema me rëndësi sociale dhe politike nën këndvështrimin pamor mbi globalizmin duke shquar dhe reflektuar simbolika ndërmjet lokale dhe globale. Ekspozita është pjesë e diskutimit pamor mbi artin bashkëkohor që realisht mungon në atmosferën kulturore shqiptare dhe, gjithashtu, është një shembull i mirë forma e analizës pamore për studentët e artit apo artistët e rinj. Gjithashtu, ekspozita realizohet nga Galeria FAB - Universiteti i Arteve që është një hapësirë e rëndësishme kulturore dhe edukative për të rinjtë dhe publikun artdashës. Marrëdhënia me publikun realizohet nëpërmjet medias, takimeve të veçanta me fokus-grupe (përfshirë edhe personave me aftësi të kufizuara) për të përmbledhur të gjitha format e interesit publik mbi çështje që prezantohen nëpërmjet artit pamor, por shkojnë edhe përtej tij në formatet bashkëkohore të social-izimit kulturor!

Projekti individual mbi ekspozitën "Flower Powr" ka përfshirë tre vjet që analizon në studion e tij disa fenomene globale në kontekst shoqëror dhe politik. Veprat e realizuara përgjatë kësaj periudhe kanë në qendër të saj elementin e lules si një simbol sa i brishtë, por edhe i fortë në kuptimin pozitiv të saj. Kompozimet e ndër-

likuara me shumë elemente ambig (të dyfishtë) të krijojnë një kuzozitet ngjarjesh dhe historish



naturale që herë pas here janë nën trysinë e teknologjisë dhe survejimit! Ekspozita udhëhiqet nga diskutimi elitar dhe pikëpyetjet bashkëkohore se: "Njerëzimi e shpiku teknologjinë për të mirën e tij, por sot ndoshta ai është bërë viktime e saj". Gjithashtu, kjo ekspozitë është një pikëtakim me interes publik për të hapur diskutime mbi çështjen që ajo trajton për të kontribuar në reflektimet tona individuale dhe kolektive mbi globalizmin!

Rëndësi në gjithë këtë proces ka edhe informimi nëpërmjet rrjeteve sociale për njohje dhe sugjerime nëpërmjet komenteve dhe analizave mbi fenomenet që trajtohen në këtë event artistik duke shtuar vlerat e komunikimit social-kulturor.

Synimet e ekspozitës janë: analizimi i tendencave më të fundit nëpërmjet artit pamor në ar-

tin bashkëkohor, krijimi i një atmosfere reflektimi mbi simbole globale, ironizimi nëpërmjet elementeve pamore aktualitetin e paqëndrueshëm global, sintezimi i formës kritike për shumë pikëpamje të ekzistencës humane, shfaqja para publikut e vlerave të larta estetike të ndërthurura me koncepte mbi "paqëndrueshmërinë" që vjen pothuajse si motiv qendror i ekspozitës, hapja dimensioneve të reja të mendimit mbi format e ekspozimit të veprave të artit në raport me hapësirën ekspozuese dhe kontributi në vlerat kulturore të publikut artdashës me koncepte të qarta mbi artin bashkëkohor. Si synime dytësore janë: informimi dhe analiza pamore artistike mbi çështje social-shoqërore dhe politike, dialogu dhe komunikimi me publikun nëpërmjet veprës së artit dhe debatit mbi çështjet që janë me rëndësi në shoqëritë globale, takimet e veçanta me studentët dhe artistët të rinj për një rol sa më përfshirës në fenomenet e artit bashkëkohor; trajtimi mediatik dhe rrjeti social mbi çështjet e mësipërme për komunikim gjithëpërfshirës të publikut.



Dje në "Reporter.al"

Nga Sebi Alla

Konfuzioni me vetingun cenon besimin e publikut

(Vijon nga faqja e parë)

... Kualifikimit, na thotë prerë se nuk mund të hyjmë. "Është institucion sekret i rëndësishë së veçantë dhe ne e kemi të ndaluar të fusim mediat pa marrë miratim", thotë gardisti.

Pas këmbënguljes për një komunikim zyrtar, një tjetër punonjës që prezantohet si shefi i Sigurisë së Brendshme, thotë se nëpunësit e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i thanë të përcillte këtë mesazh: "Ende nuk është caktuar punonjësi dhe koordinatori i Marrëdhënieve me Publikun, ndaj e kemi të pamundur për të dhënë informacionin që kërkoni në lidhje me transparencën".

Pas mëse dy vjet debatesh politike dhe një sërë vonesash, institucionet e vetingut u ngritën dhe filluan punën, duke marrë në shqyrtim dosje të gjykatësve dhe prokurorëve. Por, ndërsa rezultatet e këtij procesi priten me interes të lartë nga shumica e qytetarëve shqiptarë, institucionet e reja janë ende konfuzë mbi mënyrën se si ky proces do të mbahet në shini e transparencës.

Pas interesimit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, KPK, Kolegjin e Apelit, KA dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, OMN, BIRN mësoi se nuk ka ende një procedurë të qartë të komunikimit të këtyre institucioneve me median dhe publikun.

Ligji "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve" në nenin 55 sanksionon se seancat dëgjimore duhet të jenë publike, por njëkohësisht krijon hapësirë për t'i mbajtur ato edhe të mbyllura, siç parashikohet në nenin 20 të ligjit për gjykatat administrative.

Ligji po ashtu flet në disa pika për konfidencialitet gjatë procesit të hetimit dhe para vendimit, madje edhe parashikon penalizime për komisionarët, nëse rregullat e komunikimit shkelen. Ndërsa marrëdhëniet me mediat sipas nenit 28 të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar" rregullohen përmes një personi që caktohet ta kryejë këtë detyrë.

Një nga anëtarët e komisioneve të vetingut, që foli me BIRN në kushtet e anonimatis pranoi se ende edhe vetë ata ishin të paqartë mbi mënyrat e komunikimit dhe se po diskutoheshin mbi modalitetet që duhet të ndiqen për një proces të drejtë dhe transparent. Megjithatë, komisioneri tha se transparencja e procesit mund të shërbente si ndihmë për vetingun.

"Mund të ndodhë që për çështje konkrete do ishte në interes që disa të dhëna mbi ecurinë e procesit të vetingut të bëheshin publike. Kjo mund të ndihmonte që qytetarë apo institucione shtetërore të ofronin më shumë të dhëna rreth personave që do kalojnë procesin e vetingut edhe konkluzionet përfundimtare mund të ishin më të drejta", tha i njëjti burim.

Megjithatë, sipas komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Besnik Dervishi, transparencja nuk është në dorë të këtyre insti-

tucioneve dhe se si të gjitha autoritetet publike, ato duhet t'i nënshtrohen procesit të njëjtë të transparencës.

"Organet e vetingut janë të detyruara që të japin informacion në lidhje me ecurinë e procesit dhe konkluzionet që dalin prej tij", tha Dervishi për BIRN.

Transparenca e procesit të vetingut konsiderohet po aq jetike sa edhe vetë reforma nga analistë politikë dhe vëzhgues të sistemit të drejtësisë.

Anjeza Gashi, eksperte ligjore e organizatës "Lex Ferenda" mendon se transparencja ka lidhje të drejtpërdrejtë me besimin e publikut.



"Besimi i publikut te sistemi i drejtësisë nuk mund të ndodhë pa rritur transparencën e veprimtarisë së organeve të vetingut", tha Gashi për BIRN.

Interesi publik për procesin e vetingut është i madh. Reforma në drejtësi dhe vetë vetingun janë kthyer prej dy vitesh në fjalët kyç të debateve politike dhe në slogane kryesore të fushatës së fundit zgjedhore. Radha që qytetarë të prekur drejtpërdrejt nga drejtësia mbajnë çdo ditë pranë hyrjes së institucionit, siç gjeti edhe BIRN, atje ku dikur ka qenë Lidhja e Shkrimtarëve për të denoncuar dosjet e tyre, tregon po ashtu interes të lartë publik mbi procesin.

Pavarësisht kësaj pritshmërie dhe interesi, Arjan Vasjari mendon se duhet të gjendet një ekuilibër, pasi sipas tij, procesi "është një procedurë ligjore dhe jo proces politik".

"Çdo shprehje e këtij ekuilibri do të prodhonte një arbitraritet juridik dhe moral", tha Vasjari për BIRN.

Megjithatë, Vasjari shton se e drejta e publikut që të informohet është e garantuar dhe se vetëm transparencja mund të mundësojë një rikthim të besimit tek institucionet e sistemit të drejtësisë. Për analistin, që të realizohet kjo, më së pari duhet që publiku të kuptojë dhe njohë konkretisht faktet, të dhënat, provat që përligjin humbjen e tij të besimit tek sistemi aktual i drejtësisë.

"Tek e fundit, nuk ka asnjë arsye ligjore apo etike që të na sugjerojë të jemi diskret me publikimin e paligjshmërisë që vetingu mund të zbulojë për shumë nga njerëzit e sistemit të drejtësisë sot", shton Vasjari.

Ligjvënësi ka qenë mjaft lakonik në rastin e marrjes dhe dhënies së informacionit. Neni 28 i ligjit thotë se, "anëtar i institucionit të rivlerësimit dhe personeli i tyre trajtojnë informacionin për procedurën e rivlerësimit, në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale".

Por, Dervishi argumenton se transparencja e procesit të vetingut

e tjera të vetingut, për shkak të interesit të lartë publik", shton komisioneri Dervishi.

Përtej mesazhit të thatë të njërit prej rojeve në hyrje të godinës së KPK, BIRN nuk mundi të merrte për këtë shkrim komente zyrtare nga asnjëri prej institucioneve të vetingut. ONM konfirmoi marrjen e pyetjeve mbi transparencën e procesit, por deri në botimin e këtij shkrimi nuk solli përgjigje.

Afrim Krasniqi, drejtori ekzekutiv i Institutit për Studime Politike bie dakord se suksesi i vetingut të shumëpritur do të varet prej transparencës së procesit.

nuk është dëshirë ose pjesë e interpretimit të anëtarëve të KPK ose KPA, sepse sipas tij, ligji për të drejtën e informimit është më se i qartë.

"Institucionet e vetingut kanë detyrimin që të hartojnë programin e transparencës, pra të japin informacionin pa kërkesë, t'u përgjigjen çdo kërkesë të qytetarit për informacionin që kërkon, natyrisht duhet të ngrenë si të gjitha autoritetet e tjera publike regjistrin e kërkesave dhe të përgjigjeve", thotë ai.

Në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, 'kpk.al', është vendosur rubrika për programin e transparencës. Aty po ashtu njoftohet media se kontaktet me të do të mbahen përmes koordinators. Por, institucionit ende nuk ka vënë në dispozicion kontakt të koordinatorit, ndërsa nuk janë plotësuar as rubrikat e "Programit të Transparencës".

Kolegji i Posaçëm i Apelit, i cili ende nuk ka nisur punën pasi pritet vendimet e para të KPK-së, ka po ashtu një faqe zyrtare 'kpa.al', por ajo është ende në proces ndërtimi.

Komisioneri Dervishi thotë po ashtu se edhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM), sa i përket transparencës duhet të zbatojë ligjet shqiptare.

"Në vlerësimin tim, paçka statusit të veçantë që gëzon veprimtaria e ONM duhet t'i nënshtrohet transparencës, njësoj si tri organet

"Do të duhet që publiku të jetë i mirinformuar dhe i bindur se nuk është lojë politike e radhës, por diçka shumë më e madhe, është fillimi i fazës për konsolidimin e institucioneve të shtetit të së drejtës", tha Krasniqi.

"Për më shumë që transparencja është një detyrim kushtetues, por edhe moral nga vetë aktorët e rinj të reformës në drejtësi, përfshirë Misionin Ndërkombëtar i Monitorimit", shtoi ai.

Ndërkohë, përfaqësuesja e "Lex Ferenda", Anjeza Gashi thotë se transparencja mbi atë që po ndodh duhet të kishte filluar.

"Pavarësisht se ka filluar puna dhe po kryhet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale dhe etike të gjyqtarëve dhe prokurorëve, publiku është pak ose aspak i informuar mbi ecurinë e këtij procesi dhe të reformës në drejtësi në përgjithësi", kritikon Gashi.

Ajo gjykon se mosinformimi në kohë i publikut dhe niveli i ulët i transparencës mbi veprimtarinë e organeve të rivlerësimit kalimtar, mund të ndikojë negativisht në perceptimin e publikut mbi efektshmërinë e procesit të vetingut.

Ajo po ashtu e sheh të rëndësishëm informimin edhe sepse beson se mund të nxitet "një rol më proaktiv i qytetarëve për të denoncuar faktet që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, siç edhe përcaktohet në nenin 53 të ligjit të rivlerësimit".

HOROSKOPI

DASHI

Mosmarrëveshjet në familje në mëngjes do të zgjidhen nga pasdija, falë dashurisë, por edhe Hënës, që zhvendoset. Armëpushim do të nënshkruhet para një akullore e shijsme, me ngjyra të ndezura ashtu si personaliteti i juaj i hareshëm.

DEMI

Gjatë ditës mendoni për dashurinë dhe gjatë natës mendja juaj krijuese përpunon ide të shkëlqyera, të cilat kanë zbatim të vazhdueshëm. Dhe më e bukur është se ndiheni në formë, edhe pse keni sforco të trupit dhe mendjes gjatë veprimtarisë së juaj.

BINJAKET

Gjatë mëngjesit do të jeni tërësisht të zhytur në punë, pastaj gjatë pasdites, me ndryshimin e Hënës, do të jetë partneri që do t'ju thithë të gjithë energjitë tuaja. Mbrëmjen do ta kaloni të qetë, pasi të keni mposhtur lodhjen me dashuri.

GAFORJA

Kini kujdes që të mos nënshkruani kontrata që nuk ju përshtaten. Në lidhje me një çështje delikate kërkoni ndihmë një kolegu me më shumë përvojë, i cili do t'ju mbështesë. Për sa i përket jetës së çiftit, sot partneri do të jetë në qendër të vëmendjes.

LUANI

Do të kaloni një ditë të hareshme me miqtë, dhe do të keni bashkëpunim të ngushtë me kolegët. Do të jeni të sjellshëm dhe të edukuar me të gjithë që takoni sot. Ndërkajë mbrëmje do të ndjeni t'ju mbrërthyer lodhja aq shumë sa do t'ju zërë gjumi ndërsa shikoni një film.

VIRGJERESHA

Do të keni ditë të mrekullueshme përdërisa Hëna është në anën e juaj, dhe më pas gjatë ditës do të bëjë që të jeni më entuziasht dhe më të hareshëm. Shijojni këtë të ditë sa më shumë të mundeni dhe mos e lini t'ju ikë.

PESHORJA

Gjatë gjithë mëngjesit do të jeni të ngarkuar me shumë projekte dhe do të bëni shumë punë, por pa arritur rezultatit e dëshiruar. Por, nga ana tjetër, mbrëmja do të jetë e qetë, ndërsa Hëna nxit një miqësi që të kthehet në diçka më shumë.

AKREPI

Do të ndërmerrni projekte dhe investime të rëndësishme, por me kusht që të kryhen në kohën e duhur, në të kundërt mund të mos arrihi rezultatet e duhura. Veproni gjithmonë me logjikë: asnjë veprim i detyruar nuk të gon drejt suksesit.

SHIGJETARI

Mëngjesin nis i zymtë, po humorit do t'ju rikthehet gjatë pasdites nga Hëna, duke ua bërë pjesën tjetër të ditës më romantike. Me partnerin tuaj do të keni harmoni. Edhe këtë herë do të mbyllni një sy ndaj defekteve të vogla të partnerit.

BRICJAPI

Hëna mike në shenjin tuaj ju mbështet gjatë gjithë mëngjesit, duke bërë që të përqendroheni në komunikimin dhe fitim. Do të keni jetë sociale intensive dhe të përbushur. Me një agjendë kaq të mbushur kontakte dhe takime, nuk mund të humbni asnjë minutë.

UJORI

Mëngjesin do ta keni të zënë më punë, fitime dhe shpenzime, por duke filluar nga orët e pasdites, me ndikimin e Hënës, çdo gjë do të ndryshojë në qiej tuaj të brendshëm. Do të kaloni një mbrëmje të këndshme me miqtë apo vetëm me partnerin.

PESHQIT

Do të jeni në formë shumë të mirë, nën ndikimin e Hënës dhe të Marsit e Uranit në shenjin tuaj! Çfarë është thënë, është bërë! Plot gjallëri dhe të fuqishëm gjatë ditës, por të rrasqapitur në mbrëmje: nuk është vetëm lodhje, ajo është edhe Hëna që ndryshon shenjin.

Opinion i Ditës

Nga Sali Berisha

(Vijon nga faqja e parë)

... të kryeqytetit dhe punëtorë e punonjë të sipërmarrjeve të Tiranës, themeluan në darkë vonë njëherazi pluralizmin politik dhe PDSH-në, si partinë e parë të vërtet opozitare në historinë e vendit, bijë direkte e lëvizjes studentore, revolucionit demokratik të dhjetorit 1990.

PD u themelua në vendin e diktaturës staliniste më të egër të Europës, regjimit të Enver Hoxhës, Hitlerit shqiptar të Pasluftës, vendin e ndalimit me Kushtetutë të lirive dhe të drejtave njerëzore dhe të mbushur në të katër anët me kampe shfarosëse dhe burgje vdekjeje, në vendin e kulteve satanike të Enver Hoxhës, Stalinit dhe Leninit, në vendin më të izoluar të botës, në të cilin vetëm gjatë vitit 1990 u ekzekutuan në kufij qindra të rinj, kufomat e të cilëve të bëra shoshë nga plumbat u zvarriten në dhjetëra raste në sheshet dhe rrugët e Shkodrës, Sarandës, Gjirokastrës, Korçës.

Partia Demokratike u themelua në vendin e hiperkolektivizmit total, skllavërisë shtetërore dhe mjerimit më ekstrem. Vetëm 204\$ ishin të ardhurat vjetore për frymë të shqiptarëve. Ajo u themelua në vendin në të cilin PPSH, partia-shtet që lindi në vitin 1941 si parti dhe lëvizje serbe, jugosllave në Tiranë, kishte tradhtuar çështjen e kombit shqiptar të copëtuar në pesë shtete në aktin e padrejtësisë më të madhe të Europës të shekullit të kaluar.

Misioni i PD, që në ditën e themelimit të saj ishte përmbyjsja e diktaturës hoxhiste në Shqipëri, mbrojtja e vendosur e interesit kombëtar, vokacionit perëndimor të kombit tonë dhe integritetit europian të vendit, ndërtimi i shtetit ligjor dhe garantimi i lirive dhe të drejtave të mohuara dhe ndalura me Kushtetutë, e të ardhmes së shqiptarëve në liri e prosperitet.

PD, në përmbyshje të misionit të saj është partia që përmbysi diktaturën më të egër në Europë. Me përmbyshjen e diktaturës komuniste, PD hapi dyert e lirisë për shqiptarët.

Që në javën e parë të themelimit të saj, PD shpalli para shqiptarëve dhe botës interesin kombëtar dhe çështjen kombëtare, deri atëherë të tradhtuara, si yllin e saj polar. Ajo nxori Shqipërinë nga izolimi më i thellë, e lidhi në miqësi me SHBA dhe vendet e lira.

PD mbështeti fuqishëm dhe ndërkombëtarizoi në samite të OSBE dhe OKB, në bashkëpunim me Lidhjen Demokratike dhe Presidentin Rugovë, çështjen e Kosovës por edhe të shqiptarëve të Maqedonisë, Malit të Zi dhe kudo në botë. Ajo ia doli të konfirmojë në rezoluta të votuara me 2/3 në OKB të drejtën e qytetarëve të Kosovës për vetëvendosje. PD anëtarësoi Shqipërinë në Këshillin e Europës. Ajo hodhi themel e ekonomisë së tregut dhe të demokracisë, shtetit ligjor, liberalizoi dhe privatizoi ekonominë, bëri 220 mijë familje shqiptare pronarë të apartamenteve të tyre dhe mbi 460 mijë familje në fshat, pronarë të fermave të tyre.

Ajo gaboi me lejimin dhe mori të gjitha përgjegjësitë për skemat piramidale dhe doli në vitin 1997 në opozitë. Në vitet 1997-2005, Partia Demokratike ndonëse në opozitë, por ia doli t'i jepte tonin jetës politikë të vendit.

Me fitoren e zgjedhjeve në vitin 2005, në një rast unik në histori përzuri nga pushteti ata që erdhën me dhunë dhe rebelim komunist. Në 8 vite të qeverisjes së saj firmosi dhe ratifikoi Marrëveshjen e Stabilizimit Asociativ, anëtarësoi vendin në NATO. PD dha ndihmesë thelbësore në pavarësinë e Kosovës, lajmin për të cilin e shpalli në Tiranë më të famshmen "time is now", Presidenti George W Bush në vizitën e parë dhe historike të një presidenti të SHBA në Shqipëri. Qeveria e PD dha kontribut thelbë-

PD gaboi me piramidat, mision përmbyjsja e diktaturës hoxhiste



sor në njohjet ndërkombëtare të Kosovës.

Me reforma serioze e të gjithanshme u plotësuan të gjitha kushtet dhe u hoqën vizat me BE, si dhe u mor në tetor të vitit 2012 dhe në tetor të vitit 2013, rekomandimi i Komisionit Europian për statusin e vendit kandidat, të cilin e bllokoi Edi Rama.

PD luftoi me zero tolerancë krimin dhe bandat e tij. Vendosi para ligjit në 18 muaj mbi një mijë bosë dhe anëtarë të bandave kriminale dhe e bëri Shqipërinë një vend të sigurt. Luftoi me vendosmëri korrupsionin duke u bërë vendi i parë në botë me prokurime dixhitale. Ajo ndërmori reforma të thella ekonomike të suksesshme, si ulja e tatimit nga 25 në 10%, ulja e tatimit të ardhurave personale nga 23 në 10, pra vendosje të taksës së sheshtë prej 10%, ulja e sigurimeve shoqërore nga 32% në 15% për punëdhënësin, ulja e tarifave doganore nga 6 në 1%.

Në kuadrin e këtyre reformave u krijua "one stop shop" për regjistrimin e bizneseve dhe u arrit reduktimi i kohës dhe kostos së regjistrimit nga 42 ditë dhe 4 mijë euro, në gjithsej 30 minuta dhe vetëm 1 euro. U krijua Qendra Kombëtare e Licencave dhe Lejeve, pasi u hoqën mbi 2/3 e tyre. Të gjitha këto reforma, siç pohojnë Komisioni Europian, Banka Botërore, FMI, IBRD etj., bënë që ekonomia e vendit, në kulmin e krizës ekonomike dhe financiare të botës, të vazhdojë të rritet dhe të mos njohë recesion. Papunësia njohu ulje progresive, ajo ra në 12.8%, numri i bizneseve u dyfishua. Eksperti dhe investimet e huaja u rritën përkatësisht me 300% dhe 316%. Gjatë viteve 2008-2013 investimet e huaja arritën nga 1 deri në 1.4 miliardë dollarë. Të ardhurat buxhetore u dyfishuan. Kreditet për ekonominë u rritën 6 herë. Sipas Censurit të vitit 2011, 343 mijë familje shqiptare kishin më shumë se një shtëpi. Shqiptarët në bane për 1000 banorë lënë mbrapa 5 kombe të vendeve anëtare të BE.

Qeveria e PD rriti me 120-150% rrogat dhe 100% pensionet e ulëta. Në projektin e saj "Për një Shqipëri të zhvilluar", qeveria e koalicionit të PD arriti të shkëpusë Shqipërinë nga grupi i vendeve me të ardhura të ulëta dhe ta vendosë atë në grupin e vendeve me të ardhura të mesme të larta.

Të ndërtojë dhe rindërtojë në mbarë vendin mbi 11 mijë km rrugë, pra siç thotë Komisioni Europian, më shumë se i gjithë ra-

joni. Ajo ndërtoi Rrugën e Kombit, autostradën Tiranë-Elbasan, në të cilat vetëm tunele janë 16 km dhe dhjetëra kilometra ura në të gjithë vendin. Me këtë infrastrukturë moderne, distanca kohore pothuaj e të gjitha zonave të vendit u shkurtua 2-3 herë.

Të ndërtojë dhe rindërtojë 1300 shkolla e institucione arsimore, 720 sisteme ujësjellëse dhe kanalizimesh, 10 impiante të përpunimit të ujërave të zeza dhe 400 qendra shëndetësore dhe spitale.

U zgjeruan ndjeshëm portet e Sarandës, Vlorës, Shëngjinit. U ndërtua terminali i aeroportit dhe u dyfishua e u ndërtua terminali i portit të Durrësit si dhe u shpall fituese kompania që do thellonte portin për anije të mëdha deri në 50 mijë tonë.

Në vitet 2005-2013 krahas infrastrukturës, energjia ishte një përparësi tjetër madhore e PD. "Shqipëria, superfuqi e vogël e energjisë së rinovueshme në rajon" nga fundi i vitit 2007 e në vazhdim, bëri të mundur marrjen fund të ndërprerjeve të energjisë elektrike, që më parë ishin së paku 6-10 orë në ditë. Për herë të parë pas 30 vitesh ndërprerjeje, nisi në Shqipëri ndërtimi i hidrocentraleve të reja. Në kuadrin e kësaj strategjie qeveria firmosi ndërtimin e 420 hidrocentraleve me koncesion nga kompanitë private, që arrinin një investim total prej mbi 5 miliardë eurosh. Nga këto kontrata të nënshkruara kanë përfunduar se ndërtuar 110 HEC-e të reja, të cilat sot japin mbi 33% të konsumit vjetor të energjisë, 77 të tjera janë në ndërtim e sipër.

Po në fushën e energjisë ujore u arrit kontrata për ndërtimin e Kaskadës së Devollit, një investim prej 800 milionë euro nga kompania "Statkraft", njëshi botëror në këtë fushë. Ky është investimi më i madh në fushën e energjisë në vendin tonë. Heci-i i Banjës ka përfunduar dhe punimet për të tjerat vazhdojnë.

Në kuadrin e strategjisë energjetike, Shqipëria luajti një rol qenësor në realizimin e projektit, aktualisht më të madh energjetik të Europës, gazsjellësit Trans-Adriatik, ndërtimi i të cilit përfundon në dy vitet e ardhshme. Shqipëria merr një vend kyç në fushën e energjisë për rajonin dhe Europën.

Shqipëria dixhitale është një nga realizimet madhore të qeverisë së PD. Në vitin 2006, përdorimi i internetit në Shqipëri ishte vetëm 4.8%, ndërkohë me politikat nxitëse dhe reformat e thella u rrit në 63% në

vitin 2012. Interneti dhe kabinetet e informatikës u shtrinë në çdo shkollë, u garantua internet falas për popullatën në 1250 zyra në mbarë vendin, u ulën 3-5 herë çmimet e bisedave me celular, u licencuan dy kompani dhe u shtri në mbarë vendin teknologjia 3G.

Numri i studentëve u rrit nga 12 në 50 për 1000 banorë, 70% e maturantëve hynin në universitet. Trupa akademike universitare u rrit nga 6 000 në 10.500. Ndjekja e shkollave të mesme u rrit nga 69% në 86%. Në zonat rurale u ndërtuan rreth 8 mijë km rrugë, mbi 1 mijë shkolla e kopshte, 630 ujësjellës dhe kanalizime, qindra km kanale vaditëse dhe kulluese. Qeveria në 5 vitet e fundit subvencionoi 45 mijë projekte në bujqësi e blegtori, gjë që bëri të mundur të mbillen mbi 10 milionë rrënjë ullinj dhe miliona rrënjë mollë, arra, vreshta dhe dru të tjerë frutorë. Prodhimet bujqësore në tërësi u mbrojtën, u ulën ndjeshëm importet, u mbi dyfishua toka e punuar, eksportet bujqësore u rritën 2-3 herë.

Numri i turistëve dhe vizitorëve nga 300 mijë që ishte në vitin 2004, u rrit në 4.7 milionë në vitin 2012.

Shqipëria ende nuk është vend i zhvilluar, por ajo të mbrapa disa vende të zhvilluara në vdekshmërinë amtare, vdekshmërinë në përgjithësi, jetëgjatësinë mesatare të popullatës dhe arriti të ketë vdekshmëri infantile njëshifrore.

Në vitin 2013 shqiptarët me vullnetin e tyre hodhën poshtë kontratën me Sali Berishën dhe votuan për një kontratë tjetër. Respektova plotësisht vendimin e tyre dhe pa ndonjë keqardhje të veçantë mora vendimet e duhura.

Në katër vite Edvin Krista Rama nuk ka mbajtur asnjë premtim elektoral, nuk ka ulur, por ka rritur taksat për 95% të shqiptarëve, ngriu për tri vite rrogat e tyre, jo që nuk krijoi 300 mijë vende pune, por largoi nga Shqipëria mbi 300 mijë shqiptarë, nga vetëm 432 vetë që kërkuan azil politik në Gjermani në vitet 2011-2012 të marra së bashku. Në këto katër vite Edvin Krista Rama, përveç statusit të vendit kandidat, që ishte rekomanduar dy vite me radhë, por që e kishte bllokuar vetë ai, vendi mbeti i bllokuar për hapjen e negociatave. Ai në katër vite në pushtet i ka bërë vendit gjëmën më të madhe pas Enver Hoxhës, duke e kthyer në Kanabistan dhe protektorat krimi. Ai ndërtoi narko-shtetin dhe vendosi krimin në të gjitha nivelet e pushtetit. Në katër vite ka rritur borxhin në 85% me 6.6 miliardë euro investime, nuk ka ndërtuar asnjë km rrugë të re, shkollë apo spital të ri, por vetëm zyra, fasada, pllaka në sheshe dhe palma. Vetëm në tendera, dogana dhe tatime nga qeveritarët janë vjedhur mbi 1.2 miliardë euro.

Në këto vite tejet të renda, Partia Demokratike u angazhua me të gjithë potencialin e saj në denoncimin para shqiptarëve dhe botës të regjimit të narko-shtetit të vendosur në Tiranë. Në garën e fundit elektorale, në kushte tejet të pabarabarta, PD humbi zgjedhjet dhe pësoi një tronditje të thellë dhe të pamerituar. Ajo sot qëndron me të vendosur se kurrë në vazhdimin e misionit të saj të madh: përmbyshjen e narko-shtetit në Shqipëri.

Me këtë rast, dua të shpreh nderimin tim më të madh për të gjithë ata studentë, punëtorë, intelektualë që themeluan me 11 dhjetor të vitit 1990, PD-në, atyre qindra mijëra miliona anëtarëve, drejtuesve, simpatizantëve të saj, që me mbështetjen e tyre shndërruan Partinë Demokratike në lokomotivën e zhvillimit dhe integritetit të Shqipërisë në NATO dhe Bashkimin Europian.

Gëzuar mbarë shqiptareve ditën e themelimit të pluralizmit politik, partisë së parë opozitare në Shqipëri! Gëzuar!



Vlonjatët duan mesfushorin e Kombëtares

"Çmendet" Flamurtari, ofertë Ledian Memushajt

Klubi i Flamurtarit vazhdon të dhurojë surpriza në merkato, ku së fundmi po bën goditje të njëpasnjëshme për të përforcuar një skuadër, e cila edhe kështu ka një përbërje mjaft cilësore. Pavarësisht afimeve dhe zyrtarizimeve të bëra në ditët e fundit, klubi vlonjatë nuk ka ndër mend të ndalet. "VIP SPORT" ka mësuar se vlonjatët i kanë bërë

ofertë një prej futbollistëve aktualë të Kombëtares shqiptare të futbollit. Bëhet fjalë për mesfushorin vlonjat, Ledian Memushaj, i cili nuk po kalon një periudhë të lumtur në radhët e Beneventos në Serinë A italiane, ku është aktivizuar në dy sezonet e fundit. Drejtuesit vlonjatë nuk duan të kursehen këtë sezon, ku kanë bindjen se mund të arrijnë objektiva të

rëndësishëm dhe për këtë arsye i kanë ofruar Memushajt të njëjtin rrogë që përfiton aktualisht te Benevento në Itali. Atje, mesfushori shqiptar përfiton 200 mijë euro neto në vit, një shumë të cilën pritet ta sigurojë edhe në Shqipëri, nëse pranon ofertën nga vendlindja, që do ta bënte atë futbollistin më të paguar në historinë e kampionatit shqiptar.

Serbi është një dëshirë e vjetër e të kuqve, drejtori i ri do udhëtojë personalisht për të

KUPA E SHQIPËRISË



Ze Maria mbyll dyert, Binguila rikthehet në stërvitje

Tirana është duke u përgatitur për ndeshjen e radhës, atë në Kupë ndaj Villaznisë. Ndeshja e parë ka përfunduar me rezultatin 2-0 në favor të kryeqytetasve, por asgjë nuk ka përfunduar, pasi janë për t'u luajtur edhe 45 minuta të tjera. Këtë më së miri e di edhe tekniku i Tiranës, Ze Maria. Në stërvitjen e djeshme trajneri brazilian i ka lejuar mediat vetëm në 15 minutat e para të stërvitjes. Më pas kur bëhe fjalë për taktikat e përdorura përpara ndeshjes me Villazninë, mediat janë larguar nga fusha stërvitore. Serioziteti përpara këtij takimi është maksimal nga ana e Tiranës, ndërsa atmosfera në grup duket pozitive pas rezultateve të arritura në kohë të fundit. Ajo që vlen për t'u përmendur në stërvitjen e ditës së sotme është stërvitja e diferencuar e Binguilës. Mesfushori i Tiranës është bashkuar me ekipin pasi pësoi një lëndim në stërvitje disa kohë më parë. Megjithatë, Ze Maria ende nuk u ka besuar aftësitë të futbollisti nga Kongo.

Jeton Selimi

Khurxhiç rikthehet në skenë, Rama do niset drejt Danimarkës

Ndërkohë, Telushi ka firmosur dje kontratën

Drejtesit e Partizanit kanë një objektiv të fiksuar në merkato që prej një viti tashmë dhe ai është serbi Nikola Khurxhiç. 31-vjeçari, ish-lojtar i Partizanit të Beogradit, që po luan në kampionati danez te Randers, u lakua edhe në janarin e shkuar si një nga përforcimet e mundshme, por asokohe lojtari e snoboi Superligën Shqiptare. Megjithatë, emri i Khurxhiç nuk është fshirë nga lista e drejtuesve të kuq, që këto ditë kanë shfaqur sërish interes për lojtarin, që ndryshe nga eksperiencat e së shkuara, këtë herë në Danimarkë nuk po gjen ritmin e duhur. "Sport News" mëson se do të jetë vetë drejtori Olsi Rama, që këdo ditë do të udhëtojë drejt vendit nordik për ta parë nga afër lojtarin dhe mbase për të kryer bisedimet e para. Hapat e parë të marrëveshjes janë hedhur përpara takimit Skënderbeu-Partizani i Beogradit, kur drejtuesit e lartë të klubit serb janë takuar me presidentin Demi dhe u kanë propozuar të kuqve lojtarin, gjysmën e pagës të së cilit vijojnë ta paguajnë ata. Në këto kushte, Partizani po bën hapat e parë për këtë marrëveshje, e cila gjithsesi do të mbetet e varur në



pjesën më të madhe të saj dhe nga dëshira e lojtarit.

TELUSHI

Ndërkohë, Bruno Telushi mund të konsiderohet praktikisht një lojtar i Partizanit.

Mesfushori potent ka firmosur dje pasdite kontratën me klubin e kuq, ndërsa mbeten për t'u kryer formalitetet e kalimit të dokumentacionit nga Sllaven Belupo te klubi

kryeqytetas. Mesfushori 27-vjeçar është po ashtu një dëshirë e vjetër e presidentit Demi, por ish-kapiteni i Flamurtarit në verë zgjodhi të provonte një aventurë jashtë

Shqipërisë, nga e cila duket se është lodhur shpejt. Telushi njihet si mesfushor potent, agresiv dhe mbi të gjitha për të majtën e tij të hidhur, autor i disa golave shumë të bukur në kampionatin tonë.

TË TJERËT

Por te Partizani do të ketë shumë hyrje-dalje. Deri më tani janë 5 lojtarët e larguar nga të kuqtë, por pritet të ketë edhe të tjerë. Organizimin e ekipit të ri po e bën drejtori Rama, ndërsa nga Moxhi nuk ka më asnjë shenjë. Ish-drejtesit juventin nuk po kalon më shumë kohë në Shqipëri, çka të bën të mendosh se ai është praktikisht i larguar. Dyshja e ëndërruar është Bregu-Abazaj, por për xhevahiret e Luftëtarit ka shumë luftë me Flamurtarin dhe Skënderbeun. Gjithsesi, është ende dhjetor dhe janari premtion zhvillime të mëdha në kampin e kuq.

KUPA E SHQIPËRISË

Akordi, Skënderbeu-Besëlidhja do luhet në Kavajë

Ndeshja e kthimit në Kupën e Shqipërisë mes Skënderbeut dhe Besëlidhjes nuk do të luhet në qytetin e Korçës, por në atë të Kavajës, teksa dy klubet kanë arritur një marrëveshje mes tyre për ta luajtur në stadiumin "Besa" ndeshjen e së mërkurës. Skënderbeu ndodhet në Durrës aktualisht dhe ndeshjen e kampionatit në fundjavë e luan në Lushnjë. Edhe Besëlidhja nuk ka dashur të udhëtojë gjatë dhe të shpenzojë kohë, kështu që të dy klubet vendosën të luajnë në stadiumin e Kavajës, që ishte i vetmi i lirë për të mërkurën. Ndeshja e parë e luajtur në Lezhë u mbyll me fitoren e korçarëve, 0-1, me gol të Kelmendit.



HIDHET POSHTË KËRKESA E RUSISË

Kosova merr pjesë me simbole shtetërore në Shën Pjetërburg

Presidenti i Federatës Botërore të Xhudos (IJF), Marius Vizer, u ka dhënë dritën jeshile xhudisteve kosovare që të marrin pjesën në Masterin e më të mirëve, që do të mbahet javën e ardhshme në Shën Pjetërburg të Rusisë, pas kërkesës së shtetit rus që Kosova të mos përfaqësohet me simbole shtetërore. Ministria e Jashtme e Rusisë i kishin kërkuar Kosovës që garueset e saj, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova të mos përfaqësonin Kosovën me simbolat shtetërore, por me flamurin e federatës së xhudos. Kjo kërkesë ishte hedhur poshtë nga Federata e Xhudos e Kosovës. Edhe trajneri i xhudos, Driton Kukla, ka konfirmuar në llogarinë e tij në "Facebook" se Kosova do të marrë pjesë në këtë event e barabartë me shtetet e tjera.



INCIDENTI I PARKETIT

Ndërprenë derbin e kryeqytetit, policia gjobit 14 tifozë bardheblu

Policia e Tiranës ka ndëshkuar me gjobë 14 tifozë të skuadrës së Tiranës, që shkakuan ndërprerjen e takimit të basketbollit në derbin e kryeqytetit mes Tiranës dhe Partizanit, që u luajt në 27 tetor në sallën "Farie Hoti". Masa administrative ka qenë nga 10 deri në 15 mijë lekë, por nuk është lënë me kaq. Individët që janë skeduar si të dhunshëm, janë përfshirë në listën e zezë të uniformave blu dhe nëse përsërisin këto veprime dhune, do t'u ndalohej deri në 2 vjet hyrja në ambiente sportive. Policia, në këtë mënyrë ka nisur aplikimin e gjobave individuale për shkaktarët e dhunës nëpër ambiente sportive, si një nevojë për të sensibilizuar ultrasit që shkaktojnë këto trazira.



HIJE SKANDALI



Ksabi Alonso manipuloi shortin e Ligës së Kampioneve?

Dje në mesditë në Nion është hedhur shorti i Champions League për fazën e 1/8-ve. Një ndër përballjet më interesante padyshim do të jetë edhe ajo mes Çelsit dhe Barcelonës. Blutë e Londrës kanë qenë skuadra më e pafat në këtë short, sepse

kishin vetëm 3 alternativa për të kapur në gogla. Barcelona, PSG dhe Beshiktashi ishin 3 alternativat që rezervonte shorti, por tifozët e Çelsit kanë shfaqur pakënaqësi, duke shprehur dhe pretendime për manipulim e tij. Ksabi Alonso ishte

përzgjedhur për të bërë tërheqjen e goglave të vazos së parë. Ish-mesfushori i Realit, Liverpuli dhe Bajernit ka parë mjaft mirë momentin kur Xhoxho Marketi merr dy goglat e mbetura të Beshiktashit dhe Barcelonës. Më pas Alonso mban dorën në gogëlën e Barcelonës gjatë "përzjerjes". Një veprim që shihet si i qëllimshëm, teksa pamjet që u servirën, i shtuan më shumë dyshimet.

TRAJNERI I ÇELSIT



Konte injoron Barcelonën: Prioriteti ynë është kampionati

Trajneri i Çelsit, Antonio Conte ka folur pas shortit të Ligës së Kampioneve, duke u bërë thirrje futbollistëve të tij që të harrojnë duelin me blaugranët deri në shkurt. Strategu italian kërkon që lojtarët të përqendrohen te ndeshjet në Champions. "Mendoj se prioriteti ynë duhet të jetë kampionati dhe që të qëndrojmë në garë për një vend në Champions. Ky është prioriteti për momentin. Më pas kur të vijë momenti që do të përballlemi ndaj Barcelonës, do të mendojmë për të. Duhet të jemi realistë dhe të kuptojmë se ky kampionat është shumë i rrezikshëm. Në çdo ndeshje duhet të japim 120 për qind të forcës sonë, pasi rrezikojmë që të jemi një surprizë e pakëndshme në fund të sezonit", tha Conte. Çelsi është përballur në 6 raste në Champions ndaj Barcelonës, teksa nuk ka humbur asnjëherë kur ka qenë me 11 futbollistë në fushë. Blutë e Londrës do të luajnë ndeshjen e parë, teksa Conte është shprehur: "Mendoj se duhet të jemi gati që të luajmë si brenda dhe jashtë fushës sonë. Është e pamundur që të kesh avantazh nga ndeshjet brenda apo jashtë. Kur luani ndaj Barcelonës, duhet që të japësh 120 për qind brenda apo jashtë. Kur je në këtë kompeticion duhet që të jesh i gatshëm që të përballlesh me të gjithë. Në këtë rast duhet të jemi gati për Barcelonën", ka thënë Conte për mediat angleze.

Çelsi-Barcelona do të jetë një tjetër sfidë e ndezur, ndërsa vëmendja është e gjitha në Madrid

Champions League, një short ferri!

Përballje milionere Real Madrid-PSG



Jeton Selimi

Shorti i Champions League ashtu siç pritjet ka rezervuar përballje ferri në fazën e 1/8-ve. Kampionët në fuqi të Realit të Madridit do të përballen me milionerët e PSG në një ndeshje që do të tregojë shumë për limitet e ekipit francez. Finalja tjetër e parakohshme është mes Çelsit dhe Barcelonës, që pritet të dhurojë shumë emocione, duke na kujtuar përballjet e disa viteve më parë. Juventusin ndërkohë do të përballen me Tottenhamin, ndërkohë që dy skuadrat e Mançesterit patën një short të lehtë. Sfidat e para do të zhvillohen më 13-14 dhe 20-21 shkurt, ndërkohë që ato të kthimit në 6-7 dhe 13-14 mars.

ÇMENDURIA REAL-PSG

Dy skuadrat më të çmen-

CHAMPIONS LEAGUE	
FAZA E 1/8-ave	
Bazel - Mançester Siti	Beshiktash - Bajern Mynih
Çelsi - Barcelona	Juventus - Tottenham
Porto - Liverpul	Real Madrid - PSG
Sevija - Mançester Junajtid	Shaktar Donjetsk - Roma



dura' në merkaton e futbollit, Real Madrid dhe PSG do të ndeshen në fazën e parë pas grupeve në Ligën e Kampioneve. Pakkush e priste kaq shpejt! Madje, ka edhe nga ata që e quanin një finale ideale të kompeticionit më të madh në Evropë. Pra, një finale ëndërrash! Mos rrëmoni më kot për të gjetur ndonjë arsye të jashtëzakonshme. Në dy kryeqytetet e kontinentit plak, Madrid dhe Paris, dihet se luajnë disa nga lojtarët më të shtrenjtë në histori. Kaq ishte. Transferimet e tyre kanë qenë abso-

lutisht më të bujshmit dhe krijojnë lajm edhe kur thjesht marrin frymë apo... veshin çorapet. Ky është futboli dhe kemi frikë se kështu do të jetë për dekada të tëra: spektakël, marketing, para, yje, prezantime "bombastike" dhe ja ku u krijua menyja e përkryer, e cila tërheq si magnet qindra miliona tifozë në mbarë globin. E nisim me transferimet e kushtueshme të kampionëve të Evropës, të gjitha në sulum, ashtu si PSG-ja. Kristiano Ronaldo i ka kushtuar 94 milionë euro Real Madridit, i

blerë nga Mançester Junajtid. Mendohej se portugezi do të ishte lojtari më i shtrenjtë në histori, por katër vite pas transferimit të tij në "Santiago Bernabeu", Florentino Perez bleu një më të shtrenjtë, uellsianin Gareth Bejl, për 101 milionë euro (nga Tottenham). Pjesëtari tjetër i treshes "BBC" në Madrid është Karim Benzema, i blerë për 35 milionë euro nga Lion. Shifër modeste, ë? Ndoshta, por jo atëherë kur u ble ai. Shpërngulemi në Paris, aty ku po luan rekordmeni Neymar. Ylli brazilian mund të

largohej vetëm për 222 milionë euro nga Barcelona dhe nënkampionët e Francës "u çmendën" duke e paguar këtë shumë verën e kaluar. Sikur të mos mjaftonte 25-vjeçari, PSG-ja pas këtij sezoni do të kryejë edhe blerjen përfundimtare të adolehentit Kilian Mbape për 180 milionë euro (nga Monaco). As sulumsi pykë nuk është ndonjë blerje mesatare. Edinson Kavani u ka kushtuar 64,5 milionë euro parisienëve, i blerë nga Napoli. I lexuat mirë shifrat e mësipërme? Sulmi i Real Madridit dhe PSG-së ka kushtuar gjithsej 696,5 milionë euro. Me këtë investim, skuadrat e tjera evropiane, me përjashtim të dy rasteve, Çelsi dhe Mançester Siti, do të kishin formuar një 23-she të plotë për disa vite me radhë. A do të shohim në fushë një spektakël në raport me vlerat e yjeve? E vështirë, sepse gjatë njerëz kurrsesi nuk mund ta kenë vlerën rreth 700 milionë euro, por... jemi në vitin 2017.

Trajneri i Bajernit të Mynihut

Hejnkës: Nuk e nënvlerësojmë Beshiktashin



shumë futbollistë të mirë si Pepe, Adriano, Negredo, të cilët kanë shumë eksperiencë pasi kanë luajtur me parë në La Liga. Kuarezma gjithashtu është një futbol-

list i rrezikshëm, Rajan Babel ndërkohë ka luajtur me Ajaks dhe Liverpul. Nuk ka vend për nënvlerësimin", ka thënë strategu i Bajernit.

JUVENTUSI

Nedved "kërcënon" Tottenhamin: Nuk do të jetë si miqësorja e verës

Pas hedhjes së shortit të Champions League, zëv endëpresidenti i Juventusit, Pavel Nedved ka komentuar përballjen e 1/8-ve që rezervoi përballë skuadrën e Tottenhamit. "Është një short normal, në kupat evropiane asnjëherë nuk jemi përballur me Tottenhamin. Në miqësore gjatë verës humbëm ndaj tyre, por do të luajmë pas 2-3 muajsh, por ishim vonë me përgatitjet. Do të shohim se çfarë do të ndodhë. Dibala? Sigurisht që duhet rifituar. Ai e di që gjithmonë ka pranë klubin sa herë që ka nevojë. Sa i përket Tottenhamit kanë një trajner të madh, i cili po shfrytëzon më së miri potencialin e lojtarëve që ka. Duhet të besojmë në vlerat tona, pasi kemi shumë mundësi. Tifozët kanë frikë për të shkruar në finale? Për historinë e finaleve të humbura, unë do të firmosja që të shkoja çdo vit në finale", ka thënë Nedved për mediat italiane. Tottenham fitoi 2-0 në miqësoren e zhvilluar këtë verë.



Opinion i Ditës

Nga Astrit Patozi

Që PD të mos vlejë vetëm për historinë

(Në vend të një urimi klasik për 27-vjetorin e themelimit)

Përvjetorët nuk do të kishin shumë vlerë, nëse do të shërbenin vetëm për ushqimin e nostalgjisë së veteranëve, sado dekorata të mbanin ata në gjoks. Nga kjo ligjësi nuk mund të bëjë përjashtim as ditëlindja e Partisë Demokratike, me gjithë peshën e saj të rëndë në historinë moderne të Shqipërisë.

Ato, mbi të gjitha, janë ftesë për të bërë një bilanc, për atë që ka ndodhur nga dita e themelimit, por edhe nga njëri përvjetor në tjetrin. I kërkoj ndjesë çdo anëtarit të Partisë Demokratike, që mund të ndjehet i lënduar nga të vërtetat që do të them më poshtë, por nuk është aspak qëllimi im të trajtoj emocione të tyre, e aq më pak të prish festën time.

Por jam i detyruar ta bëj nga përgjegjësia që ndjej, për të bërë aq sa mundem, për shpëtimin e saj. Unë nuk e pranoj dot që ne sot duhet të mburremi vetëm me lavdinë tonë të dikurshme, ndërkohë që kemi shumë pak ose aspak për të thënë për të sotmen, le më pastaj për të ardhmen.

Kam bindjen e thellë se hipokrizia dhe sidomos patetizmi nuk na shërbejnë për ta nxjerrë Partinë Demokratike nga boshllëku dhe rrënimin. E vetmja gjë për të cilën kemi nevojë sot është një sens realizmi, i cili do të shërbente për të parë në sy defektet dhe për të ndërtuar me urgjencë një projekt rindërtimi dhe ringritjeje, për ta kthyer atë, jo thjesht në pushtet, por në vendin që i takon, si gjenerator i shoqërisë shqiptare.

Të nderuar demokrate dhe demokratë, 27 vjet pas themelimit të saj Partia Demokratike e sheh veten në kuotën më të ulët të peshës së saj politike dhe të ndikimit të vet në zhvillimin e Shqipërisë. Është një rënie në pikiatë, e rëndë dhe e pamëruar për dhjetëra e mijëra demokratë të përkushtuar, të cilët iu bashkuan asnjë më kohë të ndryshme, që nga dhjetori i 90-ës e deri më sot.

Arsyeja nuk ka të bëjë aspak me fundin e një cikli të natyrsëm për një parti dhe aq më pak është konspirative apo gjeopolitike.

Partia Demokratike po vuan sot pasojat dramatike të drejtimit të gabuar, që e ka larguar atë shumë prej misionit dhe traditës së vet, duke e shndërruar me shpejtësi në një forcë politike të pafuqishme, të vjetëruar dhe që nuk frymëzon më askënd.

Për shkak të keqmenaxhimit të saj, sidomos në 4 vitet e fundit, demokratët në mbarë vendin gjenden sot në një pozitë të vështirë, që nuk ka të bëjë thjesht me shifrat dëshpëruese të humbjeve në zgjedhjet e fundit. Përtej tyre, lidhshipi i Lulzim Bashës i ka shkatërruar gati plotësisht të gjitha kolonat kryesore, që mbajnë në këmbë dhe të karikuar një parti politike moderne.

Ndaj më shumë se çshtjete numrash në parlament apo këshilla bashkiake, kriza e Partisë Demokratike ka të bëjë me deformimet e rënda në përfaqësimin e saj, personalizimin total të vendimmarrjes, shterpësinë e ideve dhe sidomos me hedhjen në erë të çdo instrumenti garantues për karrierën politike brenda saj.

Praktikisht, në vend të një partie politike, ku çdo anëtar dhe votues ka aksionet e tij, kemi mbërritur te një kompani jorentabël biznesi me një pronar të vetëm. Forca politike që përmbysi diktaturën përmes zgjedhjeve, është katandisur gradualisht në një organizatë kaotike, ku nuk ka më asnjë vlerë vota e anëtarëve, e cila as nuk numërohet dhe as nuk respektohet.

Farsa e rizgjedhjes së kryetarit humbës më 22 korrik është shembulli më i shëmtuar i deformimit dhe i manipulimit të votës dhe një karshillëq i hapur, jo vetëm për anëtarësinë e partisë, por për gjithë publikun shqiptar. Pas konsumimit të saj, kauza e drejtë për zgjedhjet e lira në Shqipëri është kompromentuar në mënyrë të pariparueshme, sepse opozita sot, për shkak të



hallit personal të Lulzim Bashës, ka humbur kartën morale që t'i kërkojë kundërshtarit një gjë që nuk e bën vetë.

Partia Demokratike është duke korrur sot frutet e hidhura të një koncepti anakronik dhe tribal për politikën dhe shtetndërtimin, që kulmoi në marrëveshjen e 18 majit, efektet e së cilës sollën jo vetëm humbjen shkatërruese në zgjedhjet e 25 qershorit, por edhe gjendjen e pashpresë të opozitës me nisjen e sezonit të ri politik. Është hera e parë në historinë e Shqipërisë pas rënies së komunizmit, që opozita humbet dhe mbështetja e saj bie dhe kur mazhoranca qeveris keq.

Dhe vijmë sot në këtë përvjetor në një situatë depresive politike, kur, ndonëse reputacioni dhe legjitimiteti i mazhorancës së Edi Ramës kanë pësuar një goditje të fortë, nuk ndjehet fare që kjo të ketë ndikuar për rritjen e optimizmit dhe të besimit të Partia Demokratike.

Për herë të parë në historinë e vet forca politike, që solli demokracinë në Shqipëri, gjendet në një inferioritet të madh, jo thjesht numerik, në raportin me rivalin e vet kryesor. Që prej fushatës elektorale në zgjedhjet e fundit, ku kryetari i Partisë Demokratike u trajtua me humor si një djale i mirë dhe i pafajshëm, e deri më sot, opozita humbet rregullisht çdo ballafaqim me kundërshtarin, dhe kjo ndjehet sidomos në parlament, që është edhe tribuna më e rëndësishme e politikës.

Dhe pyetja e parë që i vjen ndërmend çdo shqiptari është se përse ndodh kështu. Si ka mundësi që pak vite më parë, me rënien e besimit të Partia Demokratike, përfitonte qartazi dhe dukshëm Edi Rama dhe, kur ky i fundit gjendet në vështirësi ekstreme, askush nuk i kthen sytë të Lulzim Basha?

Çfarë "revolucionit", që nuk e kemi parë, ka ndodhur tek e djathta, apo te PD-ja në veçanti, në këto 27 vjet, që i lejojnë një politikani mediokër të ketë pushtet të ngjashëm

me atë sistem që përmbysem në vitet 90?

Si ka mundësi që edhe pas më shumë se 6 muajsh askush nuk e di se si u arrit, çfarë u vendos dhe a vijon ose jo marrëveshja politike me Norvegjen e narkotrafikut, kryehajdutit dhe trafikantit e votave apo shefin e mafias dhe të krimin të Shqipëri? Edhe shoku Enver, kur prishej ose kur lidhej me Bashkimin Sovjetik apo me Kinën, harxhonte shumë kohë dhe energji për ta bindur popullin se po bënte gjënë e duhur.

Dikush duhet t'iu shpjegojë demokrateve, jo vetëm në Skrapar, se çfarë mrekullie ndodh që një parti shqiptare, si LSI-ja, në mars ishte paterica e Edi Ramës, në prill u shndërrua në shpresën e vetme të popullit për të përmbysur qeverinë e drogës, në qershor ishte e keqja më e madhe e kombit, por në shtator u bë aleatja kryesore e Partisë Demokratike.

Si ka mundësi që ëndrra e bukur e 'republikës së re' nuk përmendet më nga askush, ndërkohë që mbajti gati 5 muaj ndezur motorin e popullit opozitar; a thua se ishte objekt njëpërdorimësh dhe jo një projekt politik?

Cili është kufiri që ndan qeverinë dhe opozitën, të majtën dhe të djathtën, të mirën dhe të keqen, përtej faktit që e kemi për detyrë të denoncojmë Edi Ramën dhe çdo socialist tjetër si problem dhe vetëm që ka ky vend? A ka ndonjë arsye apo diferencë thelbësore se përse shqiptarët, kur mërziten me të drejtë nga qeveria, të kthejnë sytë e shpresës nga opozita, apo duhet ta zgjedhin atë thjesht se i vjen radha apo si të keqen më të vogël?

Këto janë vetëm disa nga pyetjet e natyrsme që mund të shtrohen përballë çdo anëtarit dhe votuesit të Partisë Demokratike në këto ditë të vështira për të djathtën dhe përfaqësimin e saj politik në Shqipëri.

Por mbi të gjitha, a ka ndonjë dëshmitar në PD, që të mbajë mend ndonjë fitore që kemi arritur, kur i kemi pasur duart e zëna

me "armikun e brendshëm"? Ndoshta është sot rasti të kujtojmë se në vitin 2005, megjithëse Partia Demokratike hapi dyert katërkantash për të gjithë të larguarit e vet, arriti të fitojë me shumë vështirësi falë aplikimit më të mirë të sistemit, sepse në votë popullore humbi me gati 60 mijë vota, në përballjen kokë për kokë me Partinë Socialiste.

Sigurisht ky shembull mund të mos ketë shumë rëndësi për Lulzim Bashën dhe për këdo tjetër që mendon si ai se është më mirë një kasolle, që ta kesh të gjithën tënden, sesa një ndërtesë madhështore, ku të kenë pjesë edhe të tjerët. Por besoj, se kjo vlen shumë për çdo anëtar dhe kontributor real të Partisë Demokratike në vite.

Të nderuar anëtarë dhe simpatizantë të Partisë Demokratike,

Çfarëdo që të bëjmë dhe themi sot, në këtë përvjetor, secili prej nesh që kemi pasur një mandat të caktuar politik në vite, jemi borxhli ndaj jush, e para se nuk ju kemi vlerësuar kurrë në përmasat e kontributit tuaj të çmuar. Por mbi të gjitha, për katandisjen e sotme të forcës sonë politike. Natyrisht, jo të gjithë kemi përgjegjësinë e Lulzim Bashës, sepse ajo është individuale dhe po aq e matshme.

Por ajo që ka vlerë sot është e ardhmja jonë, e cila nuk është thjesht perspektiva e një partie politike, por është, në fakt, Shqipëria e nesërme.

Ndaj do të doja të ftoja sot modestisht çdo anëtar dhe votues të Partisë Demokratike, por, pse jo, dhe çdo shqiptar tjetër që beson te vlerat e së djathtës, madje edhe përtej asaj, për një reflektim të thellë.

Bilanci tmerrësisht negativ i Partisë Demokratike në këtë përvjetor nuk duhet të na dekurajojë aspak në për të mos parë dritë në fund të tunelit. E keqja vërtetë ka shkuar larg në këtë vend, por prapë nuk ka vend për pesimizëm. Në ende mund t'ia dalim që ta kthejmë Partinë Demokratike, në kohërat e saj më të mira, dhe kjo jo thjesht si qëllim pushteti, por më shumë si një detyrim ndaj shoqërisë shqiptare, që sot është në udhëkryq.

Por ka vetëm një rrugë që kjo të bëhet e mundur. Që secili prej nesh të reagojë dhe t'i dalë zot asaj. Kjo e përfshin edhe shqetësimin e drejtë të dikujt që secili prej jush duhet të ruajë investimin e vet të gjatë dhe nganjëherë edhe plot sakrificat në Partinë Demokratike.

Por, sipas meje, kjo nuk bëhet duke braktisur politikën prej zhgënjimit, si ata 240 mijë zgjedhës që zgjodhën të mos votonin më 25 qershor dhe, as duke u futur në rresh-tin e atyre që besojnë verbërisht te "fitoret" e Lulzim Bashës.

Aksionet e gjithsecilit bëhen të vlefshme vetëm në rast se ato vlerësohen në bursën e politikës, dhe nuk lihen asnjëherë në mëshirë të vlerësimit personal të një njeriu. Qoftë ky edhe kryetari i partisë, për të mos shkuar më larg, te kunati, vjehëri, grua, vëllai, apo prindi i dikujt me pushtet politik.

Jam shumë i sigurt se sot, nesër, në prill dhe më vonë, do të dëgjojmë fjalime përgjyruese për bashkimin dhe demokracinë e kulluar, që do të vijë bashkë me pranverën në partinë tonë. Për statutin më të mirë në botë, që do të miratohet prej 5 mijë delegatëve, edhe pse në Shqipëri nuk ka ende një sallë që t'i nxërë kaq njerëz.


Do të vijmë prej të njëjtit person, që e shkaktoi problemin dhe traumën, i cili ka prej disa muajsh mbi tavolinën e tij të vetmen alternativë për zgjidhje, platformën për ringritjen e Partisë Demokratike, dhe bën sikur nuk e sheh.

Unë për vete nuk kam asnjë minutë për të humbur që ta dëgjoj, jo me ta besoj atë. Jam i bindur se kështu e mendoni edhe ju.

Sepse që kur është shpikur demokracia e deri më sot ka vetëm një mënyrë për t'i mbajtur njerëzit bashkë në një organizatë politike, përmes votës dhe respektimit të rregullave. Kjo vlen edhe për individë, që nuk janë provuar kurrë si mashtues apo si shkelës të tyre. Përfytyro se çfarë ndodh me të tjerët!

Nder, mirënjohje dhe respekt për secilin prej jush! Urimet më të mira për 27 vjetorin e Partisë Demokratike! Bashkë do t'ia dalim!

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Immanuel filozof.
4. Parashesë për këtej.
8. Argento aktore.
11. Gjysmë erotik.
13. Janë memese pa kufij.
15. Rastet pa set.
16. Në mes të dhomës.
18. Rrapo pa çifte.
19. Gardner aktore.
20. Charlie Mingus.
21. Janë pjesë të antenës.
23. Eshhtë e tregut në kapitalizëm.
24. Eshhtë lojtari underi 21.
26. Janë njëvendëshe në Formula 1.
28. Qarkullon vetëm në shqipëri.
30. Ishin komandantët si Çerçiz Topulli.
32. Kishte 100 porta.
35. Në krye të aktorëve.
36. Gjysma e slitës.

VERTIKAL

1. Një së larti bëhet me stiiin fosbury.
2. Kaçaturian kompozitor.
3. Kush nuk di mbytetë.
5. Inicialet e Harris aktor.
7. Ka satelit Ariel
8. Dy asa.
9. Kështu janë mbrojtjet e palëvizshme.
10. Mund të skadojë.
12. Eshhtë edhe ajo zanore.
14. Ishite futbollit i Holandës.
17. Ishin bakantet.
21. Janë garat me gregarë.
22. Një njëvjeçar.
23. Tekat pa kufij.
25. Një ekip i Kazanit.
27. Fillojnë aksionin.
29. Eshhtë hidrokarbur.
31. Gruaja e Ben Hur.
33. Skuadër greke.
34. Barack në shtëpinë e bardhë.
37. Capirossi i MotoGP.
40. Nuk i tregohen babait.
41. Mund të jete fetar.
42. Jessica aktore.
43. Marsi i akajve.
46. Tri të parat në klasifikim.
47. Gjysmë tatimi.
50. Mbyllin fushata.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Eshhtë hokitari.
8. Loja me full.
13. Kaas këngëtare.
14. Përdoret kundër malaries
15. Këndohet në opera.
16. Pak formalitete.
17. Eshhtë legjienda.
18. Të fundit konak.
19. I mbjell... katastrofa.
24. I bëjnë të luajturit.
25. Fillojnë mpijren.
27. Janë trupa qiellorë.
28. Qendër në kaos.
29. Preferojnë yjet e hënën.
30. Tri të parat në atletikë.
5. Inicialet e Camus.
32. Ente Autonome Tiranë.
33. Një metër në kufij.

VERTIKAL


1. Catherine aktore.
2. Një vijë e lakuar.
3. Tatim pa kufij.
4. Lidhet në... fyt.
5. Inicialet e Camus.
6. Në kokë të xixëllonjës.
7. Fillojnë hapur.
8. Kishin flamur të zi.
9. Ndezur në aparaturë
10. U shkrua nga Kipling.
11. Janë mistere për t'u zgjidhur.
12. Rastet pa set.
14. Ai ekzekutivi tani është bashki.
16. Eshhtë edkumi në palestër.
20. Grandi aktore.
21. Eshhtë gjarpër.
22. Një pëllhurë sintetikë.
23. I bëjnë testet me një set.
24. Një monument... për kujtim.
26. Atdheu i Papa Eojlyla-s.
27. Mund të jenë me katër kohë.
29. Një ushtarak me... numër.
30. Emri i Salacrou.
35. Telefoni në kartëvizitë.
37. Numri i oktetit.
38. Kukulla e Ibsen.
40. Thyhet me dy kafshata.
44. Rajone Autonome Lokale.
46. Ekstre me esktreme.
48. Mbyllin një manastir.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

T	O	K	A	T	L	U	F	R	A	N	Z
A	R	E	S	F	I	M	A	N	A		
L	I	N	V	E	N	T	I	L	A	T	O
L	E	P	E	R	D	I	T	S	H	M	E
J	T	E	R	R	O	R	I	S	T	E	T
A	S	A	M	A	R	A	R	A	R	S	
H	L	O	R	E	N	M	A	R	A	T	
H	A	M	E	S	I	P	A	K	E	T	I
H	R	I	T	H	S	U	R	A	T	N	
T	E	R	O	T	D	E	T	I	T	V	O
T	E	N	I	T	A	K	A	S	A	R	
M	M	E	N	T	E	S	H	T	A	T	E

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	H	L	E	R	K	R	N	O	T	A
I	N	E	S	A	K	O	D	E	N	A	
S	T	R	S	E	N	D	E	R	E	T	
T	E	A	P	E	N	D	E	I	M	I	A
E	N	M	E	N	D	I	M	I	S	E	G
R	A	A	C	E	T	E	V	E	L	O	
I	T	R	I	Z	A	N	A	K	I	N	
O	A	K	A	T	S	A	R	N	A		
Z	A	B	E	M	T	M	E	D	E		
E	R	M	E	G	A	L	T	O	N		
T	O	K	A	G	A	L	N	D	E	R	A
P	A	L	A	D	I	N	E	S	T	O	P

FJALËKRYQI (1)
FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

9	4				2	7		
	8	1		7		2		6
			5	3	8		1	
7			4			9	6	5
	2		8		5		4	
3	5	4			7			1
			2	8	6			
1		7		4		5	8	
		2					9	4

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	4	1	2	8	3	5	7	6
8	5	3	7	6	9	2	4	1
6	7	2	1	5	4	9	8	3
7	8	9	4	3	6	1	2	5
5	1	6	9	7	2	4	3	8
2	3	4	8	1	5	7	6	9
1	9	8	3	2	7	6	5	4
3	2	5	6	4	1	8	9	7
4	6	7	5	9	8	3	1	2

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Lëviz nëpër botë duke festuar, kërcyer, kënduar, si një bletë; shko nga lulla në lule, vetëm duke provuar të gjitha eksperiencat, qiqesh.
- Vdekja do jetë shumë e bukur nëse di të komunikosh me të. Eshhtë një shpërbërje, bie prapë në burimin e qënies për t'u çlodhur e për t'u rinovuar. Do të thotë, të zhdukesh në burimin e ekzistencës dhe të bashkohesh me Zotin - dhe mund të rilindësh prapë, deri sa të bëhesh i Zgjuar.



Thënie të mençura

- "Disa herë, akoma dhe gjërat më të parëndësishme do të mund të ishin gjëra të jashtëzakonshme, nëse do t'i bënim me njerëzit e duhur". Elizabeth Green
- "Të mund të flesh i qetë, të mund të duash dhe të mbash mend se këtu jemi të gjithë kalimtarë". Jorge Luis Borges

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

7	2	13	9	11	1	17	5	2	4	1	3	
18	17	2	5	1	3				3	1	4	6
13		3	8			K	2	11	1	8	1	3
10	1	3	6	12	9	O	5	1	3	13	18	
4	1		1	7	9	N	9	12	6	2		8
6	15		8	9	7	6	I	12	1	3	7	8
2	5	6	2	13	2		2	3	2	2	2	6
12	1	13	1	16	3	3	8	2	3			
2	18	2		6	6	8	6	5	1	3		
13			18	2	13	2	7		2	1	7	
3	1	1		12	2	7	1	3		13	1	3
6		4	5	6	3	2		6	4	1	3	1

K	O	D	I	A	D	P	A	L				
A	R	E	S	T	I	S	M	L	A			
N	A	D	H	E	R	E	T	I	K	E	T	
I	R	M	O	N	I	T	O	R	I			
B	K	A	P	I	T	A	L	I	S	T	E	
A	L	A	P	S	A	T	A	A	T			
L	E	A	E	T	L	M	T	I				
I	S	R	E	I	N	E	T	I	M			
P	I	S	S	O	D	A	M	O				
S	E	K	R	E	T	L	G	O	L			
A	L	E	L	O	N	D	R	A	R	O		
T	E	T	A	B	D	E	R	A	E	G		

- Mos i beso asgjëje, s'ka rëndësi ku e ke dëgjuar ose kush e ka thënë, edhe sikur ta kem thënë unë, vetëm nëse është e pranueshme dhe e kuptueshme për arsyen tënde.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

